

STUDIM - PROJEKTIM  
LAGJIA E ARTISTEVE  
PROJEKT ZBATIM  
“ARABEL - STUDIO” SH.P.K  
“TRANSPORT HIGHWAY CONSULTING”  
“DRICONS”

STUDIM - PROJEKTIM  
LAGJIA E ARTISTEVE  
PROJEKT ZBATIMI  
“ARABEL - STUDIO” SH.P.K  
“TRANSPORT HIGHWAY CONSULTING”  
“DRICONS”



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA TIRANË

## SPECIFIKIME TEKNIKE-INFRASTRUKURA RRUGORE

LAGJIA E ARTISTEVE

### **FAZA V**

#### **Projekti zbatimit**

**Perpunimi dhe paraqitja e planit te zgjidhjes se gatshme per zbatim**

TIRANË 2022

## TE PERGJITSHME

### 1.1 Hyrje

Keto specifikime jane hartuara per ekzekutimin e punimeve per objektin “Lagjia e artistëve”.

Të gjitha materialet dhe elementet e prodhuar ose furnizuar për përfshirjen në punimet e përhershme do të jenë të reja, me cilësi të lartë dhe të punuara me saktësi sipas detajeve teknike dhe specifikimeve teknike. Ato do të blihen vetëm nga furnizuesit e aprovuar, të cilët duhet të jenë në gjendje të demonstrojnë përshtatshmërinë e prodhimeve të tyre duke iu referuar punëve të ngjashme dhe rezultateve të certifikuara të testimi dhe të jenë të përshtatshme për qëllimin për të cilin ato janë të parashikuara, siç thuhet në specifikime. Furnizuesit zakonisht do të kërkohet të certifikohen me një sistem të menaxhimit të cilësisë në përputhje me pjesët përkatëse të ISO 9000.

Materialet dhe elementet e prodhuar duhet të jenë të certifikuara si në përputhje me specifikimet dhe standardet përkatëse kombëtare ose ndërkombëtare të cilat duhet të jenë subjekt i miratimit të mbikqyresit të punimeve. Dëshmia e përputhshmërisë mund të jetë me paraqitjen e certifikimit sipas një skeme pajtueshmërie teknike të aprovuar ose me paraqitjen e testeve të materialeve ose testeve tip në përputhje me standardin përkatës, ose siç është specifikuar ose udhëzuar nga supervizori.

Materialet, produktet, pajisjet, makinerite dhe punimet duhet të jenë në përputhje me standardet dhe rregullat teknike të specifikuara në dokumentacionin e projektit. Nëse nuk përcaktohet asnjë standard, atëherë duhet të zbatohet një EN i përshtatshëm (standard European). Nëse një standard ose rregullore bëhet e pavlefshme gjatë realizimit të projektit, ajo do të zëvendësohet nga një standard ose rregullore e përshtatshme europiane (EN) ose amerikane (ASTM).

Kontraktuesi mund të propozojë zbatimin e rregullave teknike (standardeve) të njohura përgjithësisht të lëshuara nga një organ i huaj standardizimi (të tilla si ISO, EN, DIN, ASTM, etj.), në varësi të shpjegimit me shkrim dhe miratimit të Inxhinierit Mbikëqyrës. Ky ndryshim mund të pranohet nga Inxhinieri Mbikëqyrës nëse miratohet nga Projektuesi. Kontraktorit i kërkohet të tregojë këtë ndryshim në projekt.

Këto specifikime përmbajnë kërkesa teknike për kryerjen e punimeve, metodat për sigurimin e cilësisë dhe vlerësimin e cilësisë, dhe metodat për llogaritjen e punimeve së përfunduar. Specifikimet janë të zbatueshme për punimet e përfshira në vlerësimet e kostove të projektit, por edhe për punët e përcaktuara më pas në vend për të siguruar përfundimin e plotë të punës së specifikuar në kontratë. Në disa projekte, kërkesa të veçanta mund të specifikohen gjithashtu për të marrë parasysh kërkesa të ndryshme shtesë, dmth karakteristikat e veçanta të projektit. Përdorimi i Specifikimeve Teknike është i detyrueshëm janë një pjesë integrale e dokumenteve teknike të kontratës.

### 1.2 Zevendesimet

Zevendesimi i materialeve të specifikuara në Dokumentin e Kontrates do të bëhet vetëm me aprovimin e Mbikqyresit të Punimeve nëse materiali i propozuar për të zëvendësuar është i njëjti ose më mirë se materialet e specifikuara; ose nëse materialet e specifikuara nuk mund të sillen në sheshin e ndertimit në kohë për të përfunduar punimet e Kontrates për shkak të kushteve jashtë kontrollit të Sipërmarresit. Që kjo të merret në konsideratë, kërkesa për zëvendësim do të shoqërohet me një dokument dëshmi të cilësisë, në formën e kuotimit të certifikuar dhe të dates së garancisë të dorëzimit nga furnizuesit e të dy materialeve, si të materialit të specifikuar ashtu edhe të atij që propozohet të ndryshohet.

### 1.3 Dokumentat dhe vizatimet

Sipermarresi do të verifikojë të gjitha dimensionet, sasitë dhe detajet të treguara në Vizatimet, Grafiket, ose të dhëna të tjera dhe Punedhësi nuk do të mbajë përgjegjësi për ndonjë mangësi ose mosperputhje të gjetur në to. Mos zbulimi ose korrigjimi i gabimeve ose mosperputhjeve nuk do të lehtësojë Sipermarresin nga përgjegësia për punime të gabuara. Sipermarresi do të marrë përsipër të gjithë përgjegjësinë në berjen e llogaritjeve të madhësive, llojeve dhe sasive të materialeve dhe pajisjeve të përfshira në punën që duhet bërë sipas Kontrates. Ai nuk do të lejohet të ketë avantazhe nga ndonjë gabim ose mosperputhje, ndërsa një udhëzim i plote do të jepet nga Punedhësi nëse gabime të tilla ose mosperputhje do të zbulohen.

Inxhinieri Mbikëqyrës është personi i autorizuar për të kryer, në emër të Klientit, aktivitete të mbikëqyrjes së ekspertëve gjatë punës ndërtimore, në përputhje me një ligj të përshtatshëm, dhe në përputhje me rregulloret e bazuara në Ligjin e Ndërtimit.

### 1.4 Inxhinieri Mbikqyrës

Gjatë kryerjes së aktiviteteve të tij të mbikëqyrjes së ekspertëve, Inxhinierit Mbikëqyrës i kërkohet:

- kontrolli i punimeve të ndërtimit me raportin dhe projektin përfundimtar;
- mbikëqyrja e punimeve të ndërtimit në mënyrë që të jetë në përputhje, në çdo kohë, me lejen e ndërtimit, Ligjin e Ndërtimit dhe rregulloret e tjera;
- mbikëqyrja e cilësisë së punimeve, materialeve, produkteve dhe pajisjeve, inspektimi i tyre me kërkesat e projektit dhe sigurohimi që ato të mbështeten siç duhet nga testet dhe dokumentet e duhura;
- të organizojë masat që do të merren në rast të mos përmbushjes së kërkesave nga Pika 2 më lart;
- t'i paraqesë klientit informacion në kohë për të gjitha mangësitë ose parregullsitë që ai ka vërejtur gjatë ndërtimit;
- detyrat e mbikëqyrjes së ekspertëve gjatë ndërtimit nuk mund të kryhen nga personi i cili është në të njëjtën kohë Kontraktori;
- për qëllime të inspektimit përfundimtar, përgatit raportin përfundimtar në lidhje me realizimin e projektit me të gjitha provat që konfirmojnë se struktura është realizuar në përputhje me Ligjin e ndërtimit, lejen e vendndodhjes, lejen e ndërtimit, dokumentet e projektimit dhe të gjitha rregullat teknike të zbatueshme;
- përgatit raportin për eliminimin e mangësive të konsiderueshme që janë vërejtur gjatë inspektimit përfundimtar;
- marrin pjesë aktive në përgatitjen e llogarisë përfundimtare.

Inxhinieri Mbikëqyrës gjithashtu do të kryejë detyra të tjera siç përcaktohet në kontratë dhe në këto specifikime, dhe do të mbrojë, në përputhje me praktikën e mira të inxhinierisë dhe funksionimit, kontratën dhe punimet, në dobi dhe në emër të Klientit.

Nëse kryhen disa lloje të punimeve në një projekt, detyrat e mbikëqyrjes së ekspertëve do të kryhen nga disa Inxhinierë Mbikëqyrës, secili i kualifikuar siç duhet në linjën e tij të punëve. Në një rast të tillë, zyra e supervizimit do të emërojë Inxhinierin Kryesor Mbikëqyrës.

Në rast të realizimit të ruajtjes ose punimeve të tjera në një monument të mbrojtur të kulturës, shërbimet e mbikëqyrjes së ekspertëve do të sigurohen në përputhje me një ligj të përshtatshëm.

### **1.5 Kostot e Sipermarresit per mobilizim dhe punime te perkoheshme**

Do te kihet parasysh qe Sipermarresit nuk do t'i behet asnje pagese mbi çmimet njesi te kuotuar per kostot e mobilizimit, d.m.th. per sigurimin e transportit, driten, energjine, veglat dhe pajisjet, ose per furnizimin e godines dhe mirembajtjen e impjanteve te ndertimit, rrugeve te hyrjes, te komoditeteve sanitare, heqjen e mbeturinave, punen, furnizimin me uje, mbrojtjen kundra zjarrit, bangot e punes, rojet, rrjetin telefonik si dhe struktura te tjera te perkoheshme, pajisje dhe materiale, ose per kujdesin mjekesor dhe mbrojtjen e shendetit, ose per patrullat dhe rojet, ose per ndonje sherbim tjetër, lehtesi, gjera, ose materiale te nevojshme ose qe kerkohen per zbatimin e punimeve ne perputhje me ate qe eshte parashikuar ne Kontrate.

### **1.6 Hyrja ne sheshin e ndertimit**

Sipermarresi duhet te organizoje punen per ndertimin, mirembajtjen dhe me pas te spostoje dhe ta rivendose çdo rruge hyrje qe do te duhet ne lidhje me zbatimin e punimeve. Çvendosja do te perfshije pershtatjen e zones me çdo rruge hyrje dhe se paku me shkalle sigurie, qendrushmerie dhe te kullimit te ujrave siperfaqesore te njejte me ate qe ekzistonte perpara se sipermarresi te hynte ne shesh.

### **1.7 Punime prishje, spostime (elektrike, telefonie, ujesjellesi, KUB, KUZ)**

Perpara se te fillojne te gjitha punimet e prishjeve te merren masat e nevojshme per çdo bashkepunim me institucionet perkatese. Asnje nderhyrje ne rrjetet, (telefonie, elektrike, ujesjellesi, kanalizimet, vaditje ) ekzistuese nuk do kryhet pa marre lejet ne institucionet perkatese dhe çdo punim do kryhet nen mbikqyrjen e autoritetve pergjegjese.

### **1.8 Furnizimi me uje**

Uji, qe nevojitet per zbatimin e punimeve, do te merret nga rrjeti kryesor nepermjet nje matesi ne piken me te afert te mundeshme. Sipermarresi do te shtrije rrjetin e vet te perkohshem te tubacioneve. Lidhjet me rrjetin kryesor dhe kostot per kete do te paguhen nga Sipermarresi. Ne rastet kur nuk ka mundesi lidhje me rrjetin kryesor, Sipermarresi duhet te beje vete perpjekjet per furnizimin me uje higjenikisht te paster dhe te pijshem per punetoret dhe punimet.

### **1.9 Furnizimi me energji elektrike**

Sipermarresi do te beje perpjekjet, dhe me shpenzimet e tij per furnizimin me energji elektrike ne kantjer, si me kontraktim me OSSHE-ne , kur lidhjet me rrjetin kryesor lokal jane te mundura, ose duke parashikuar gjeneratorin e vet per te permbushur kerkesat.

### 1.10 Piketimi i punimeve

Sipërmarresi, me shpenzimet e tij duhet të bëjë ndertimin e modinave dhe të piketave siç kërkohej, në përputhje me informacionin bazë të Punedhësit, dhe do të jetë përgjegjës i vetëm për përpikmerinë. I gjithë procesi duhet të jetë nën mbikqyrjen e plotë të supervizorit.

Sipërmarresi do të jetë përgjegjës për të kontrolluar dhe verifikuar informacionin bazë që i është dhënë, dhe në asnjë mënyrë nuk do të lehtësohet nga përgjegjësia e tij nëse një informacion i tillë është i mangët, jo autentik ose jo korrekt. Ai ndërkohe do të jetë subjekti që do të kontrollohet dhe rishikohet nga Punedhësi, dhe në asnjë rast nuk i jepet e drejta të bëjë ndryshime në vizatimet e kontratës, për asnjë lloj kompensimi për korrigjimet e gabimeve ose të mangësive. Sipërmarresi do të furnizojë dhe mirëmbaje me shpenzimet e tij, rrethimin dhe materiale të tjera të tilla dhe të japë asistencë nëpërmjet një stafi të kualifikuar siç mund të kërkohej nga Punedhësi për kontrollin e modinave dhe piketave.

Sipërmarresi do të ruajë të gjitha pikat e akseve, modinat, shenjat e kuotave, të bera ose të vendosura gjatë punës, të mbulojë koston e rivendosjes së tyre nëse ato demtohen dhe të mbulojë të gjitha shpenzimet për ndreqjen e punës së bera jo mirë për shkak të mosmirëmbajtjes ose mbrojtjes ose spostimit pa autorizim të këtyre pikave të vendosura, modinave dhe piketave.

Përpara çdo aktiviteti ndertimor, Sipërmarresi do të ketë linjat e furnizimit me ujë dhe energji elektrike të vendosura në terren, të drejten e kalimit të qartë dhe të sheshuar, gati për fillimin e punimeve. Çdo punë e bera jashtë akseve, kuotave dhe kufijve të treguara në vizatime ose të mosmiratuara nga Punedhësi nuk do të paguhet, dhe Sipërmarresi do të mbulojë me shpenzimet e tij gërmimet shtesë gjithmone nën drejtimin e Mbikqyresit të Punimeve.

### 1.11 Fotografite e sheshit të ndertimit

Sipërmarresi duhet të bëjë fotografi me ngjyra sipas udhëzimeve të Mbikqyresit të Punimeve në vendet e punës për të demonstruar kushtet e sheshit përpara fillimit, progresin gjatë punës së ndertimit dhe mbas përfundimit të punimeve.

### 1.12 Bashkëpunimi në zonë

Ndertimi do të bëhet në zonë të kufizuara. Sipërmarresi duhet të ketë veçanërisht kujdes në:

- a) nevojën për të mirëmbajtur shërbimet ekzistuese dhe mundësitë e kalimit për banorët dhe tregëtarët që janë në zonë, gjatë periudhës së ndertimit.
- b) prezencën e mundshme të kontraktoreve të tjerë në zonë me të cilët do të koordinohet puna

E gjithë puna, do të bëhet në një mënyrë të tillë, që të lejojë hyrjen dhe përballimin e të gjithë pajisjeve të mundshme për ndonjë Kontraktor tjetër dhe punëtorëve të tij, stafin e Punedhësit si edhe të çdo punonjësi që mund të përdoret në zbatim dhe, ose punimet në zonë ose pranë saj, për çdo objekt që ka lidhje me Kontraten ose çdo gjë tjetër.

Ne pregatitjen e programit të tij të punës, Sipermarresi gjatë gjithë kohës do të bëjë llogari të plote dhe do të koeporojë me programin e punës së Kontraktoreve të tjerë, në mënyrë që të shkaktojë një minimum interferencë me ta dhe me publikun.

### **1.13 Mbrojtja e punës dhe e publikut**

Sipermarresi do të marrë masa paraprake për mbrojtjen e punetoreve të punësuar dhe të jetës publike, si edhe të pasurive në dhe rreth sheshit të ndertimit. Masat e sigurimit paraprak të ligjeve të aplikushme, kodeve të ndertesave dhe të ndertimit do të respektohen. Makinerite, pajisjet dhe çdo rrezik do të kqyren ose eliminohen në përputhje me masat paraprake të sigurimit.

Gjatë zbatimit të punimeve Sipermarresi, me shpenzimet e veta, duhet të vendosi dhe të mirëmbajë gjatë natës pengesa të tilla dhe drita të cilat do të parandalojnë në mënyrë efektive aksidentet. Sipermarresi duhet të sigurojë pengesa të pershtateshme, shenja me drite të kuqe “rrezik” ose “kujdes” dhe vrojtues në të gjitha vendet ku punimet mund të shkaktojnë çrregullime të trafikut normal ose që përbejnë në ndonjë mënyrë rrezik për publikun.

### **1.14 Mbrojtja e ambjentit**

Sipermarresi, me shpenzimet e veta, duhet të ndermarre të gjithë veprimet e mundshme për të siguruar që ambjenti lokal i sheshit të ruhet dhe që vijat e ujit, toka dhe ajri (duke përfshirë edhe zhurmat) të jenë të pastra nga ndotja për shkak të punimeve të kryera. Mosplotesimi i kësaj klauzole, në bazë të evidentimit nga Mbikqyri i Punimeve, mund të çojë në nderprerjen e kontratës.

### **1.15 Transporti dhe magazinimi i materialeve**

Transporti i çdo materiali nga Sipermarresi, do të bëhet me makina të pershtateshme, të cilat kur ngarkohen nuk shkaktojnë derdhje dhe të gjithë ngarkesa të jete të siguruar. Ndonjë makine që nuk plotëson këto kërkesë ose ndonjë nga rregullat ose ligjet e qarkullimit do të hiqet nga kantjeri.

Të gjitha materialet që sillen nga Sipermarresi, duhet të stivohen ose të magazinohen në mënyrë të pershtateshme për t'i mbrojtur nga rreshqitjet, demtimet, thyerjet, vjedhjet dhe në dispozicion, për tu kontrolluar nga Mbikqyri i Punimeve në çdo kohë.

### **1.16 Sheshi për magazinim**

Sipermarresi duhet të bëjë me shpenzimet e tij, marrjen me qira ose blerjen e një terreni të mjaftueshëm për ngritjen e magazinave me shpenzimet e tij.

### **1.17 Vizatimet sipas faktit (siç janë zbatuar)**

Sipermarresi duhet të përgatisë vizatimet për të gjitha punimet “siç janë faktikisht zbatuar” në terren. Vizatimet do të bëhen në një standart të ngjashëm me atë të vizatimeve të Kontrates.

Gjate zbatimit të punimeve në kantiere, Sipermarresi do të ruajë të gjithë informacionin e nevojshëm për përgatitjen e “Vizatimeve siç është zbatuar”. Do të shenojë në mënyrë të qartë vizatimet dhe të gjitha dokumentat e tjera të cilat mbulojnë punën e vazhdueshme të perfunduara, material i cili do të jetë i disponueshëm në çdo kohë gjatë zbatimit për Menaxherin e Projektit. Këto vizatime do të azhurnohen në mënyrë të vazhdueshme dhe do t’i dorëzohen Mbikqyresit të Punimeve çdo muaj për aprovim, pasi Punimet të kenë perfunduara, sepse me kopjen e perfundimit. Materiali i kësaj lloji do të dorëzohet në kopje leter.

Vizatimet e riprodhuara do të përfshijnë pozicionin dhe shtrirjen e të gjithë konstruksioneve mbajtëse të lena gjatë germimeve dhe vendosjen e saktë të të gjitha shërbimeve që janë ndeshur gjatë ndërtimit. Sipermarresi gjithashtu duhet të përgatisë seksionet e profilit gjatësor të rishikuar, pajisur me shënimet që tregojnë shtresat e tokës që hasen gjatë të gjitha punimeve të germimit.

Si përfundim, kopjet e riprodhuara të Vizatimeve, “siç është zbatuar” do t’i dorëzohen Mbikqyresit të Punimeve për aprovim. Vizatimet, “siç është zbatuar”, të aprovuara, do të behen prona e Punuesit.

Nuk do të behen pagesa për berjen e Vizatimeve “siç është zbatuar” dhe Manualeve, pasi kostoja e tyre është parashikuar të mbulohet nga shpenzimet administrative të Sipermarresit.

### **1.18 Pastrimi i punës së përfunduar të zonës**

Në përfundim të punës, sa herë që është e aplikueshme Sipermarresi, me shpenzimet e tij, duhet të pastrojë dhe të heqë nga sheshi të gjitha impiantet e ndërtimit, materialet që kanë tepruar, mbeturinat, skeleritë dhe ndërtimet e perkoheshme të çdo lloji dhe të lere sheshin e lirë dhe veprat të pastra dhe në kondita të pranueshme. Pagesa e punës së përfunduar të Kontrates do të mbahet deri sa kjo të realizohet dhe pasi të jepet miratimi nga Mbikqyresit të Punimeve.

### **1.19 Provat dhe testet laboratorike**

Ky seksion përfaqëson procedurat e kryerjes së provave për materialjet, me qëllim që të sigurojë cilësinë dhe qëndrueshmërinë në përputhje me kërkesat e Specifikimeve.

Kontraktori do të kryejë kontrollin dhe sigurimin e cilësisë së materialeve të përdorur dhe ndërtimin saktë të tyre nëpërmjet testeve të kontrollit të cilësisë. Testet do të jenë teste fushore (field tests) dhe teste laboratorike. Të gjitha materialet që do të përdoren do të jenë të certifikuar dhe do shoqërohen me skemat teknike përkatëse dhe me certifikatat e cilësisë. Me poshtë jepet një tabelë me testet kryesore që do të kryhen në shtresat rrugore dhe punimet e betonit.

Unbound Crushed Aggregate Base					
Laboratory Testing	Granulometric composition	ASTM C 136	ARCS 2.2.3.1	One per 3,000 m <sup>3</sup>	Contractor shall propose material but it shall meet the minimum requirements of ARCS 2.2.3.1 Clay content < 3.0% d <sub>10</sub> /d <sub>60</sub> : 8 to 50
	Flakiness	BS 812, Part 105	≤ 35%	once per source; then one per 3,000 m <sup>3</sup>	
	Los Angles Abrasion Value	AASHTO T-96	≤ 30%	once per source; then one per 3,000 m <sup>3</sup>	
	Sodium Sulphate Soundness	AASHTO T-104	Max 9%	once per source; then one per 3,000 m <sup>3</sup>	The test in ARCS 3; 2.2.3.2 is not used as the standard was not informed. It was agreed to use the same test as for the asphalt aggregates.
	Plasticity indices	AASHTO T-90	Non-Plastic	once per source; then one per 3,000 m <sup>3</sup>	
	Aggregate Crushing Value	BS 812; Part 110	Max 30%	2 tests for crushed aggregate; then one per 3,000 m <sup>3</sup>	
	3-point CBR (4 days soaking)	AASHTO T193	Min 100% at in-situ density	2 tests for crushed aggregate; then one per 3,000 m <sup>3</sup>	The Contractor shall insert the minimum strengths based on his actual design, but is shall not be less than 100%
	Maximum density & Optimum moisture content (5-point compaction - Modified Proctor)	AASHTO T180, Method D		2 tests for crushed aggregate; then one per 3,000 m <sup>3</sup>	
Field	Compaction	EN 11272	Min 100% MDD Modified Proctor  Note the increased compaction requirement	Min test per 2,000m <sup>2</sup> per layer; not less than four tests per lot	The layer thickness shall be recorded during the field testing. When two layers of base course is constructed, each layer shall be compacted, tested and reported individually. The Contractor may propose plate bearing testing but shall propose E2 and E2.5 requirements.  ARCS3 only require 95%, insufficient.

Figure 1-Testet qe do te kryhen per shtresat e stabilizantit



Description of Work	Type of Test	Test Procedure/ Standard	Limits	Frequency of Testing	Remarks	
<b>Bituminous Sprays (Prime and Tack Coat)</b>						
Field	Rate of spread	EN 12272-1	Tack Coat 0.3 l/m <sup>2</sup> Prime Coat 1.0 l/m <sup>2</sup> To be confirmed based on trial sections	Minimum 4 trays per test section and test section is weekly		
Emulsion	Binder quality	ASTM D 977 ASTM D 2397	as per standard	Twice per month		
<b>Asphaltic Concrete Base Course/Conglomerate</b>						
Aggregate	Aggregate properties (Grading, relative density, water absorption)	ASTM C 136 AASHTO T-84/AASHTO T-85	Max water absorption: 1.20%	Upon approval and mix design, 5 samples. Then every 20 production days	ARCS 3; 3.3.3.1.3. Table 3-10	
	Aggregate Crushing Value	BS 812; Part 110	Max 26%			
	Los Angeles Abrasion	EN 1097-2	Max 20%			ARCS 3; 3.3.3.1.3. Table 3-10
	Adhesion	AASHTO T-182	Min 95%			
	Sodium Sulphate Soundness	AASHTO T-104	Max 9%			ARCS 3 requires max 5% when using sodium sulphate Na <sub>2</sub> SO <sub>4</sub>
	Flakiness	BS 812, Part 105	max 20%			
	Plasticity Index	AASHTO T-90	Non-Plastic			
	Two/one fractured faces - coarse aggregate	ASTM D5821	100%/100 %	At approval and when needed	All aggregate, including sand, shall be crushed. Non-crushed aggregates will not be accepted.	
Mineral Filler	Filler Properties (Grading, moisture content)	Cement: AASHTO M85 Type I, II or III Hydrated Lime: ASTM C51	Compliance with Standard requirements	Upon approval and mix design, 2 samples. Then every 20 production days	Cement max grade 300	
Bitumen	Penetration	EN 1426 (AASHTO T 49)	Contractor to insert	Every 12,000m <sup>2</sup>	Limits: EN 12591 The bitumen shall be of the same quality as used in the approved asphalt mix designs Requirements in ARCS 3 are NOT in accordance with EN	
	Softening Point	EN 1427 (AASHTO T 53)	Contractor to insert			
	Temperature susceptibility	EN 12595	Contractor to insert			
Asphalt Mix	Composition of the asphaltic concrete mixture	ASTM D6926 ASTM D5581	5 mm or larger ± 6 % Between 2.5 mm and 0.14 mm ±4 % 0.071 mm ± 1.5 % Binder Content ± 0.3 %	1 sample when production is up to 500 tons, 2 samples when the production is more than 500 tons		
	Stability	2* 75 blows (2*50 when less than 1 million ESAL)	Min 8,000 N	Daily	Min 5,500 N when less than 1 million ESAL	
	Flow		2mm to 3.5mm	Daily		

Bitumen content target ±0.3%

	VFA		65% to 75%	Daily	65% to 78% when less than 1 million ESAL
	V <sub>a</sub>		3% to 5%	Daily	
Field	Compaction	Asphalt coring; ø 100mm	Min, Mean Value - 98 % Min, Individual - 96%	Min 1 core per 2,000m <sup>2</sup> per layer; not less than four cores per lot	Core frequency has been increased from one core per 2,500m <sup>2</sup> to 2,000m <sup>2</sup> (as per ARCS 3; 3.3.6.1) Cores shall be taken randomly across the mat, including at longitudinal joints and edges (up to 100mm from an edge)
	Thickness		T <sub>99</sub> : 5%; T <sub>max</sub> : 10%		T <sub>99</sub> is the 90-percentile of minimum four core thicknesses

Figure 2-Testet qe do te kryhen per konglomeratin bituminoz dhe primerin

Description of Work	Type of Test	Test Procedure/ Standard	Frequency of Testing	Units
<b>Asphaltic Concrete Binder Course</b>				
Aggregate	Aggregate properties (Grading, relative density, water absorption)	ASTM C 127 ASTM C 128	Upon approval and mix design, 5 samples. Then every 20 production days	Day
	Aggregate Crushing Value	BS 812; Part 110		Day
	Los Angeles Abrasion	EN 1097-2		Day
	Adhesion	AASHTO T-182		Day
	Sodium Sulphate Soundness	EN 1367-2		Day
	Flakiness	EN 933-3		Day
	Plasticity Index	AASHTO T-90		Day
	Two/one fractured faces - coarse	ASTM D5821	At approval and when needed	
Mineral Filler	Filler Properties (Grading, moisture content)	Cement: AASHTO M85 Type I, II or III Hydrated Lime: ASTM C51	samples. Then every 20 production days	Day
Bitumen	Penetration	EN 1426(AASHTO T 49)	Every 5,000m <sup>2</sup>	
	Softening Point	EN 1427(AASHTO T 53)		
Asphalt Mix	Composition of the asphaltic concrete mixture	ASTM D6926 ASTM D5581 2* 75 blows (2*50 when less than 1 million ESAL)	1 sample when production is up to 500 tons, 2 samples when the production is more than 500 tons	ton
	Stability		Daily	day
	Flow		Daily	day
	Bitumen Content		Daily	day
	VMA		Daily	day
	VFA		Daily	day
	Va		Daily	day
Field	Compaction	Asphalt coring; ø 100mm	Min 1 core per 2,000m <sup>2</sup> per layer; not less than four cores per lot	m <sup>2</sup>
	Thickness			m <sup>2</sup>

**Figure 3-Testet qe do te kryhen per shtresen e Binderit**

Description of Work	Type of Test	Test Procedure/ Standard	Frequency of Testing	Units
<b>Asphaltic Concrete Wearing (Surface) Course</b>				
Aggregate	Aggregate properties (Grading, relat	ASTM C 127 ASTM C 128	Upon approval and mix design, 5 samples. Then every 20 production days	Day
	Aggregate Crushing Value	BS 812; Part 110		Day
	Los Angeles Abrasion	EN 1097-2		Day
	Adhesion	AASHTO T-182		Day
	Sodium Sulphate Soundness	EN 1367-2		Day
	Flakiness	EN 933-3		Day
	Plasticity Index	AASHTO T-90		Day
	Two/one fractured faces - coarse ag	ASTM D5821		Day
	Polishing	BS 812	At approval and when needed	Day
Mineral Filler	Filler Properties (Grading, moisture content)	Cement: AASHTO M85 Type I, II or III Hydrated Lime: ASTM C51	Upon approval and mix design, 5 samples. Then every 20 production	
Bitumen	Penetration	EN 1426(AASHTO T 49)	Every 5,000m <sup>2</sup>	
	Softening Point	EN 1427(AASHTO T 53)		
Asphalt Mix	Composition of the asphaltic concrete mixture	ASTM D6926 ASTM D5581 2* 75 blows (2*50 when less than 1 million ESAL)	1 sample when production is up to 500 tons, 2 samples when the	ton
	Stability		Daily	Day
	Flow		Daily	Day
	Bitumen Content		Daily	Day
	VMA		Daily	Day
	VFA		Daily	Day
	Va		Daily	Day
Field	Compaction	Asphalt coring; ø 100mm	Min 1 core per 2,000m <sup>2</sup> per layer; not less than four cores per lot	m <sup>2</sup>
	Thickness			m <sup>2</sup>
	Surface regularity (roughness)		25m longitudinal and transversal or as agreed	m <sup>2</sup>
	Surface course texture (Sand patch test)	BS 598 Part 105ASTM E965	If and when a surface appear smooth and with poor visual skid resistance	m <sup>2</sup>

**Figure 4-Testet qe do te kryhen per shtresen siperaqsore te asfaltobetonit**

Description of Work	Type of Test	Test Procedure/ Standard	Limits	Frequency of Testing	Remarks	Units
<b>Concrete</b>						
Fresh Concrete	Consistency/ Slump	EN 12350; EN 12390 2; EN 206-1, Table 18	Lower limit: target-20 mm Upper limit: target +30 mm	Each load	Rev. Specificaton, C.2.10.4; ARCS-5; CL5.7	m3
	Sampling of test cubes		1 set of 3 cubes 150x150x150 mm	Every 30 m3, or 1 set per pouring day		m3
	Density; Air Content, Water/Cement ratio; Temperature of concrete	EN 206-1, Table 17 & Table 20		Where required		m3
	Records of place of sampling; Location of structure; Slump; Volume of loads	EN 206-1, Table 20		Daily Records for cast concrete		m3
Hardened Concrete	Density	EN 12390-7; EN 206-1, Table 17	Lower limit: target-30 kg/m <sup>3</sup> Upper limit: no limit	1 set of 3 cubes 150x150x150 mm for Every 30 m3, but at least 1 set per pouring day	Rev. Specificaton, C.2.10.4	m3
	Compressive Strength	EN 12390-3; Rev.Spec., C.2.10.4	Average of three test cubes in the set at age 28 days			m3
Production Control	Summaries of all data for each Class of Concrete	EN 206-1, Tables 17, 18 & 20;				m3
	Statistical calculations for Conformity of Concrete Compressive strength	Rev. Specificaton, C.2.10.4	mean: $\geq f_{ck} + 1.64 \cdot \sigma$ (ref. Remarks) individual: $\geq f_{ck} - 4$		Rev. Specificaton, C.2.10.4 (σ - Standard Deviation of individual results from 4 consecutive sets)	m3

**Figure 5-Testet qe do te kryhen per punimet e betonit**

Teste, skeda teknike dhe certifikata cilesie do te kerkojen per te gjitha materialet qe do te perdoren ne veper per te siguruar nje pune cilesore sipas standarteve dhe kerkesave te kontrates per jetegjatesine e vepres.

Te gjitha provat do te behen ne perputhje me metodat standarte europiane dhe amerikane.

### Testet paraprake

Perpara nisjes se punimeve qe perfshijne perdorimin e materialeve ne sasi me te madhe se:

1.000 m3 per inertet dhe perzierje asfalti.

500 m3 per perzierje betoni.

50 ton per çimento dhe gelqere.

Supervizori, pas ekzaminimit te çertifikatave te cilesise te dhena nga Kontraktori, do te kerkoje teste te metejshme laboratorike te cilat do te kryhen me shpenzimet e Kontraktorit.

Ne rast se rezultatet e ketyre testeve do te ndryshojne nga ato te çertifikatave, do te merren masa per ndryshimet e nevojshme ne cilesi dhe ne sasi per komponente te veçante, dhe nxjerrja e nje çertifikate te cilesise.

### Teste Kontrolli Gjate Ndertimit.

Kontraktori eshte i detyruar te paraqese gjate gjithë kohes dhe periodikisht, per furnizimin me materiale te perorimit te vazhdueeshem, teste dhe analiza te materialeve qe do te perdoren, duke mbuluar te gjitha kostot e mbledhjes dhe dergimit te kampioneve ne laboratorin e kantierit ose laboratore te tjera te autorizuar. Kampionet do te grumbullohen ne marreveshje nga te dyja palet.

Do te konsiderohen si te vlefshme nga te dy palet vetem rezultatet e nxjerra nga labororet e siper permendur. Te gjitha referencat ne lidhje me specifikimet e tanishme do te behen ekskluzivisht vetem per rezultatet e lartpermendura.

---

### **Marrja e Kampioneve edhe Numri i Provave**

Metoda e marrjes se kampioneve do te jete siç eshte specifikuar ne metodat e aplikueshme te marrjes se kampioneve dhe te kryerjes se provave, ose siç udhezohet nga Mbikeqyresit e Punimeve.

Marrja e ndonje kampioni shtese mund te udhezohet nga Mbikeqyresit e Punimeve.

Ene te tilla si çanta, kova e te tjera, do te jepen nga Sipermarresi. Marrja e kampioneve do te kryhet nga Sipermarresi ne vendet dhe periudhat qe udhezon Mbikeqyresit e Punimeve. Marrja, transportimi e sjellja e tyre ne laborator do te behet nga Sipermarresi.

---

### **Kostot e Provave dhe Marrjeve te Kampioneve**

Te gjitha shpenzimet e Kontraktorit ne lidhje me kryerjen e provave, per ato tipe qe ai do te kryeje (perfshire edhe raportimin) do te perfshihen ne perqindjet e tij. Te gjitha shpenzimet e Kontraktorit ne lidhje me marrjen e kampioneve dhe ndihmen ne vendet e marrjes per ate tip provash te ndermarra nga Inxhinieri do te perfshihen ne perqindjen e tij.

---

### **Pajisjet per Kryerjen e Provave**

Pajisjet per provat e meposhtme do te jepen nga Kontraktoret:

- permbajtja e ujit
- densiteti specifik
- densiteti ne gjendje te thate (metoda e zevendesimit me rere)

---

### **Rezultatet e Proves**

Rezultatet e proves se Laboratorit do t'i jepen Inxhinierit ne zyren e tij nga Kontraktori, pa asnje pagese.

Rezultatet e proves te kryera nga Kontraktoret do t'i jepen Inxhinierit per aprovim sa me shpejt te jete e mundur.

---

### **Nderprerja e Punimeve**

Nderprerja e punimeve per arsye te marrjes se kampioneve do te perfshihet ne grafikun e punimeve te Sipermarresit. Nuk do te pranohet asnje ankese nga nderprerja e punimeve, per shkak te marrjes se kampioneve. Provat ne laborator, do te behen ne nje kohe te pershtatshme me metoden e pershkruar.

---

### **Provat e Kryera nga Sipermarresi**

Per arsye krahasimi, Sipermarresi eshte i lire te kryeje vete ndonje prej provave. Rezultatet e provave te tilla do te pranohen vetem kur te kryhen ne nje laborator te aprovuar me shkrim nga Mbikeqyresi i Punimeve. Te gjitha shpenzimet e provave te tilla pavaresisht se nga vijne rezultatet do te mbulohen nga Sipermarresi.

## 1.20 NDERTESAT E KANTIERIT

Në strukturat e kantierit, ndërtesat dhe objektet provisorë duhet të jenë të qëndrueshme, të përshtatshme, dhe vendi përreth tyre duhet të rregullohet dhe pastrohet siç duhet. E gjithë puna e lërjes dhe veshjes duhet të jetë e qëndrueshme, dmth. nuk duhet të demtohet ose çngjyrosset gjatë kohës së ndërtimit.

Lista e bojrave dhe produkteve të veshjes duhet t'i dorëzohet Inxhinierit Mbikëqyrës për aprovim para fillimit të punimeve.

## 1.21 RRUGET E AKSESIT DHE VENDET E PARKIMIT

Rrugët ekzistuese të hyrjes dhe parkingjet duhet të realizohen në përputhje me planet e kantierëve, sipas udhëzimeve të Inxhinierit Mbikëqyrës, ose siç specifikohet në kontratë.

Rrugët e hyrjes dhe parkingjet duhet të mirëmbahen siç duhet dhe rregullisht. Aktivitetet e mirëmbajtjes do të kryhen nga Kontraktori. Kostot e mirëmbajtjes përfshihen në çmimin total të ndërtimit, përveç nëse përcaktohet ndryshe në kontratën e ndërtimit.

## 1.22 PAJISJET E SHERBIMIT - ENERGJIA ELEKTRIKE

Do të përdoret rryma alternative 220/240 V. Duhet furnizim 24 orë në ditë dhe do të jetë i mjaftueshëm për plotësimin e nevojave dhe kërkesave të të gjitha pajisjeve dhe makinerive. Si rregull, lidhjet e energjisë elektrike do të bëhen në rrjetin e jashtëm publik dhe, nëse kjo nuk është e mundur, Kontraktuesi do të furnizojë energji elektrike nga burimet e tij.

Kontraktori është përgjegjës për mirëmbajtjen e të gjithë rrjetit të energjisë elektrike, përfshirë ndër të tjera mirëmbajtjen e gjeneratorëve të energjisë, kutitë e shpërndarjes, çelsat, ventiluesit dhe kondicionerët.

### **Punimet e ujit të pijshëm, shpërndarjes së ujit dhe hidraulikës**

Kontraktori do të mirëmbajë rezervuarin ekzistues qendror të ujit dhe do të sigurojë furnizimin gjatë gjithë ditës me ujë të pijshëm për të gjitha objektet në vend. Kjo gjithashtu përfshin mirëmbajtjen e linjës së shpërndarjes së ujit që rrjedh nga rezervuari qendror në të gjitha pajisjet në vend, si dhe mirëmbajtjen e tubacioneve sanitare, rezervuarëve të ujit të ftohtë në objektet, impiantet, aksesorët, etj.

### **Sistemi I kanalizimit të ujërave të zeza**

Sistemi I kanalizimit të ujërave të zeza, objekte të tilla si gropat septike dhe sistemet e tubacioneve do të mirëmbahen nga Kontraktuesi dhe do të mbahen gjithmonë në gjendje të mirë të riparimit.

## 1.23 PASTRIMI DITOR DHE MBROJTJA

Kontraktori do të sigurojë pastrimin e përditshëm të të gjitha objekteve dhe strukturave në vend.

Kontraktuesi do të organizojë një shërbim roje 24 orë, në përputhje me Ligjin për Ndërtimin.

#### **1.24 MIREMBAJTJA**

Kontraktuesi do të mirëmbajë të gjitha strukturat ekzistuese, ndërtesat dhe objektet. Kontraktori do të sigurojë të gjithë punën e nevojshme, materialet, pjesët e këmbimit dhe elementët zëvendësues për të gjitha objektet dhe pajisjet.

#### **1.25 Llogaritja e volumeve dhe pagesa**

Fabrikimi, furnizimi, ngritja dhe mirëmbajtja e ndërtesave, strukturave, pajisjeve, pajisjeve, automjeteve dhe infrastrukturave siç kërkohet në vend, puna e Menaxherit të Projektit, Inxhinierëve Mbikëqyrës ose Klientit, të gjitha përfshihen në çmimin total të punës ndërtimore dhe nuk do të jetë subjekt i llogaritjes dhe pagesës së veçantë, përveç nëse parashikohet ndryshe në kontratë.

Zëvendësimi i mundshëm i materialeve, përfshirë mobiljet, pajisjet, pajisjet kompjuterike, uji, energjia elektrike, e gjithë fuqia punëtore, mjetet dhe pajisjet, pagesa për institucionet lokale dhe shpenzimet e sipërme dhe të rastësishme, gjithashtu konsiderohen të jenë artikuj të kostos që do të barten nga Kontraktuesi dhe janë të përfshira në çmimin total të punës ndërtimore, përveç nëse parashikohet ndryshe në kontratë.

#### **1.26 ZYRA E MENAXHERIT TE PROJEKTIT DHE INXHINIERIT MBIKQYRES**

Kontraktorit i kërkohet të sigurojë ose ndërtojë një ndërtesë kryesore zyre (një ndërtesë) për Menaxherin e Projektit dhe Inxhinierin Mbikëqyrës. Madhësia dhe vendndodhja do të specifikohen në Projektin e Ngritje se Kantierit.

Si një kërkesë minimale, ndërtesa kryesore e zyrës do të përbëhet nga zyra e Menaxherit të Projektit, një sallë mbledhjes më e madhe dhe një zyrë për Inxhinierin Mbikëqyrës. Ndërtesa duhet të ketë të gjitha pajisjet e nevojshme dhe lidhjet e infrastrukturës të tilla si energjia elektrike, telefoni / faksi, pajisjet e ujit dhe tualetit, rrugëve të afrimit, parkimit, sistemit të kullimit dhe shkarkimit të ujërave të zeza, etj., Në përputhje me listën që do të miratohet nga menaxheri i projektit ose Inxhinier Mbikëqyrës.

Sapo të marrë njoftimin për të vazhduar nga Inxhinieri Mbikëqyrës, Kontraktorit do t'i kërkohet të mirëmbajë dhe mbajë në gjendje të mirë ndërtesën e zyrës kryesore dhe pajisjet e saj, dhe këtë gjatë gjithë kohëzgjatjes së aktiviteteve të mbikëqyrjes së ndërtimit.

Nëse kërkohet nga kontrata, Kontraktuesi do të sigurojë transportin për Menaxherin e Projektit dhe personelin e tij dhe këtë duke u siguruar atyre makina të reja dhe të sigurta gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës. Automjetet duhet të regjistrohen në Republikën e Shqipërisë.

Kontraktori do të sigurojë mirëmbajtjen e rregullt të automjeteve, si dhe për karburantin, vajin dhe pjesët e këmbimit.

Automjetet e caktuara për Menaxherin e Projektit do të përdoren nga ai gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, pas së cilës automjetet do t'i kthehen kontraktorit.

#### **1.27 PAJISJET NE KANTIER PER LABORATORIN, PERSONELIN DHE SUPERVIZORIN**

Objektet brenda vendit për akomodimin e laboratorëve të testimit të auditimit, personeli i Klientit dhe Inxhinierët Mbikëqyrës duhet të zënë një hapësirë optimale, në përputhje me fushën dhe llojin e punës, siç tregohet në vizatimet e kantierit.

Të gjitha ndërtesat dhe objektet duhet të jenë të pajisura siç specifikohet në listën e aprovuar nga Inxhinieri Mbikëqyrës, përveç nëse parashikohet ndryshe në kontratë.

Ndërtesat duhet të kenë të gjithë infrastrukturën e duhur si energji elektrike, lidhje telefonike / faksi, ujë, dush dhe banjë, rrugë hyrëse, parking, sistem kullimi dhe shkarkimi të ujërave të zeza, etj.

## 1.28 PAJISJET E TOPOGRAFISE, LABORATORIT DHE PUNEVE TE KERKUARA

### PAJISJET E TOPOGRAFISE

Kontraktuesi do të paraqesë një listë të pajisjeve të rëlevimit që do të përdoren prej tij në projekt jo më vonë se një muaj pas lëshimit të njoftimit për të vazhduar nga Inxhinieri Mbikëqyrës.

Kontraktuesi do të sigurojë të gjithë punën e nevojshme për përdorimin e tyre dhe për përdorimin e Inxhinierit Mbikëqyrës nese kerkohet.

### PAJISJE LABORATORIKE

Brenda një muaji pasi është lëshuar njoftimi për të vazhduar nga Inxhinieri Mbikëqyrës, dhe pas miratimit të listës së pajisjeve laboratorike për fillimin e punës, Kontraktuesi do të sigurojë pajisje laboratorike për testimin e tij të materialeve, produkteve dhe punëve.

Nëse Kontraktuesi nuk zotëron një laborator të akredituar, ai mund të angazhojë, me shpenzimet e tij, një laborator të përshtatshëm të akredituar, në varësi të aprovimit paraprak të Inxhinierit Mbikëqyrës.

Inxhinieri Mbikëqyrës do të sigurojë të gjitha pajisjet laboratorike që kërkohen për realizimin e testeve të auditimit.

## 1.29 DISPOZITA TE PERGJITHSHME TE PUNES

Gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, Kontraktuesi do të sigurojë punë të përgjithshme, mbi baza të përkohshme ose të përhershme, dhe pa pagesë shtesë, si një ndihmë për Inxhinierin Mbikëqyrës në kryerjen e testeve të auditimit për materiale, produkte dhe punime, dhe në rëlevimin topografik aktivitetet.

## 1.30 SINJALISTIKA E PERKOHESHME

Kontraktorit i kërkohet të marrë masa dhe veprime të plota dhe të mjaftueshme në mënyrë që të sigurojë trafik të sigurt dhe të papenguar në hyrjet e vendit, në vetë vendin, në të gjitha impiantet e përdorura në realizimin e punimeve, në zonën përreth të ndikuar nga trafiku për dhe nga kantieri i ndërtimit, në kryqëzimet me rrugët e tjera dhe në devijimet e bëra për shkak të punës ndërtimore në projekt.

Kontraktorit i kërkohet të vendosë dhe mirëmbajë një numër të përshtatshëm të tabelave të trafikut, me formë të përshtatshme dhe vetitë teknike, si në vendndodhje ashtu edhe në vendet e tjera të kërkuara, në përputhje të plotë me ecurinë e punëve dhe siç kërkohet nga autoritetet kompetente.

Si rregull, automjetet dhe makineritë që hyjnë dhe dalin nga vendi duhet të kryejnë manovra të tilla hyrje / dalje duke drejtuar vetëm përpara.

Kurdoherë që është e nevojshme gjatë realizimit të punëve, Kontraktuesi do të duhet të furnizojë dhe mirëmbajë ndriçimin e përkohshëm të rrugës. Ndriçimi i përkohshëm duhet të sigurojë të njëjtin nivel të dritës si ndriçimi publik që zëvendëson. Ndriçimi i përkohshëm duhet të sigurohet dhe miratohet para heqjes së ndriçimit ekzistues publik.

Shënimi dhe ndriçimi për vetë vendin e ndërtimit, dmth. Për gërmimet dhe ndërprerjet, do të sigurohen me miratimin paraprak të Inxhinierit Mbikëqyrës.

Asnjë llogaritje dhe pagesë e veçantë nuk do të bëhet pasi puna përfshihet në çmimin total të ndërtimit.

### 1.31 KONTROLLI I TRAFIKUT

Në rast se kërkohet një rregullim i veçantë i trafikut, p.sh. në kryqëzim me rrugët e tjera, kur gjysma e rrugës është në ndërtim e sipër, në rast të alternuar të trafikut në një drejtim, etj., Në një pjesë të projektit ose në afrimet e projektit ose në vendndodhje, Kontraktuesi do të sigurojë funksionimin e sigurt të trafikut, duke përfshirë një kontroll të përshtatshëm të trafikut, të gjitha bazuar në aprovimin paraprak të Inxhinierit Mbikëqyrës.

Nëse detyrohet të kufizojë trafikun për shkak të punimeve në projekt, nga Kontraktori kërkohet që të ruajë rrjedhën e sigurt të trafikut në gjerësinë prej të paktën 3 m për trafikun në një drejtim. Me kërkesë të Inxhinierit Mbikëqyrës, ai do të sigurojë sinjalistike të ndriçuara të trafikut (semaforë) për kontrollin e trafikut në pjesë të tilla, si dhe tabela të tjera të përshtatshme të trafikut. Numri, pamja dhe vetitë teknike të tabelave të tilla duhet të jenë në përputhje me kërkesat e lëshuara nga autoritetet kompetente.

Semaforët do të jenë automatike, por gjithashtu mund të operohen manualisht nëse kjo kërkohet ose aprovohet nga Inxhinieri Mbikëqyrës. Kontraktori i kërkohet të marrë masat e duhura për të mundësuar servisin e semaforeve në çdo orë.

Kontraktuesi do t'i paraqesë Inxhinierit Mbikëqyrës për aprovim një njoftim me shkrim për fillimin e planifikuar të trafikut në një drejtim të paktën 14 ditë para fillimit të një trafiku të tillë.

Në rast se një punë do të kryhet në një rrugë publike, Kontraktuesi do të duhet të marrë një aprovim paraprak nga institucionet kompetente dhe, sa herë që kërkohet, do të kërkojë që trafiku të rregullohet nga Ministria e Brendshme. Asnjë llogaritje dhe pagesë e veçantë nuk do të bëhet pasi puna përfshihet në çmimin total të ndërtimit.

### 1.32 MIREMBAJTJA E RRUGEVE EKZISTUESE

#### Përshkrimi i punës

Menjëherë pas vendosjes së tij në vendin e ndërtimit, Kontraktuesi do të bëhet përgjegjës për mirëmbajtjen e rrugëve ekzistuese, trotuareve dhe rrugeve të biçikletave që janë të lidhura me vendin e ndërtimit.

#### Aktivitetet



Para fillimit të punës, nga Kontraktori kërkohet të shqyrtojë gjendjen e të gjitha rrugëve, trotuareve dhe rrugeve të biçikletave që janë të lidhura me vendin e ndërtimit. Rezultatet e një ekzaminimi të tillë duhet t'i vihen në dispozicion Inxhinierit Mbikëqyrës.

Në rast se rrugët e hyrjes janë specifikuar në kontratë, Kontraktuesi nuk do të lejohet të përdorë rrugë të tjera pa miratimin e Inxhinierit Mbikëqyrës.

Kontraktori i kërkohet të mirëmbajë rrugët ekzistuese, trotuaret dhe rrugët e biçikletave që përdoren si qasje në vend ose janë ndikuar negativisht nga puna e ndërtimit në projekt.

Kontraktori i kërkohet të ruajë trafik të sigurt në rrugë të tilla, dhe në këtë drejtim do të bëjë përpjekje të vazhdueshme për të shmangur çdo dëm që mund të rrezikojë në çdo mënyrë jetën e njerëzve, të shkaktojë dëmtime të automjeteve dhe të provokojë përkeqësimin e Karakteristikave kryesore të rrugëve ekzistuese të rrugëve.

Të gjitha rrugët e përdorura nga automjetet në pronësi të Kontraktorit, Nënkontraktuesve dhe furnitorëve duhet të pastrohen çdo ditë, dhe në këtë drejtim duhet të mbahen pa baltë, tokë ose material tjetër të gjeneruar nga punimet e ndërtimit në projekt.

Nëse nuk përcaktohet ndryshe në kontratë, Kontraktuesi do të duhet të marrë, mirëmbajë dhe përdorë të gjitha pajisjet e duhura, përfshirë pastruesit mekanikë të rrugëve, gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, dhe kjo në vendet dhe në mënyrën siç është rënë dakord me autoritetin kompetent rrugor. Kontraktuesi duhet të marrë, mirëmbajë dhe përdorë pajisje larëse me rrota dhe pajisje larëse me presion të lartë, si në vendin e ndërtimit ashtu edhe në vende të tjera, siç kërkohet nga autoriteti kompetent rrugor.

Secila pjesë e rrugës publike e mbyllur për trafik për shkak të punimeve nuk duhet të rihapet në trafik derisa të merren masat e duhura të sigurisë dhe trafikut dhe derisa Inxhinieri Mbikëqyrës të konfirmojë se rruga është në gjendje të përshtatshme për përdorim publik.

Pas përfundimit të punimeve në vendin e ndërtimit, nga Kontraktori do të kërkohet të sjellë të gjitha rrugët, trotuaret dhe rrugët e biçikletave dhe të gjitha pjesët e sistemit të kullimit sipërfaqësor, në gjendje që është të paktën e barabartë me gjendjen që mbizotëron para kryerjes së punimeve.

Kontraktori do të jetë përgjegjës për inspektimin e rregullt të rrugëve të tilla dhe, nëse kërkohet ta bëjë këtë nga Inxhinieri Mbikëqyrës, do të vendosë një shtresë të përkohshme, trashësia e së cilës do të jetë në përputhje me udhëzimet e Inxhinierit Mbikëqyrës.

Kontraktori i kërkohet të sigurojë në çdo kohë një hyrje të papenguar për shërbimet e zjarrfikësve, shërbimet mjekësore dhe shërbime të tjera të ngjashme dhe, në këtë drejtim, do të mbajë një kontakt të duhur me shërbime të tilla.

Kontraktori i kërkohet të lejojë hyrjen në vendin e ndërtimit për çdo përfaqësues të autorizuar të klientit ose supervizorit dhe duhet në këtë drejtim të lejojë kryerjen e punëve urgjente në çdo ndërmarrje ose instalim që ndodhet brenda vendit të ndërtimit.

Kontraktuesi nuk duhet të përdorë të drejtat publike ose private të qasjes për asgjësimin ose magazinimin e instalimeve ose materialeve të tij. Kontraktori i kërkohet të mbajë vazhdimisht në gjendje të pastër, të pranueshme dhe të sigurt pjesët e zonave publike ose private brenda rrugës së drejtë që nuk përdoren përkohësisht për kryerjen e punimeve.

Gjatë kryerjes së punëve, Kontraktuesi duhet të sigurojë që këmbësorët, duke përfshirë personat me aftësi të kufizuara, të jetë i mundësuar një qasje e sigurt në të gjitha te rruget. Asgjë që përmbahet në metodat e ndërtimit ose në programin e punës nuk duhet të parandalojë aksesin e automjeteve.

Të gjitha masat e sigurisë në trafik në lidhje me kryerjen e punëve duhet të jenë plotësisht operative përpara se Kontraktori të lejohet të fillojë çdo punë që prek rrugën publike.

#### **Llogaritja e volumeve dhe pagesa**

Asnjë llogaritje dhe pagesë e veçantë nuk do të bëhet pasi puna përfshihet në çmimin total të ndërtimit.

### **1.33 DEVIJIMI I PERKOHSEM I TRAFIKUT**

#### **Përshkrimi i punës**

Devijimi i përkohshëm i trafikut do të bëhet në pikat ku struktura ose vendi kryqëzon rrugët ekzistuese, kryqëzimet, rruget për këmbësorë ose biçikleta, ose disa pjesë të tyre.

#### **Aktivitetet**

Në rast se struktura ndikon në trafikun në një zonë më të gjerë, ose nëse prek një numër më të madh rrugësh të lidhura reciprokisht, si dhe në rast të rrugëve kryesore ose rrugëve të një shkalle më të lartë, nga Klienti kërkohet që të sigurojë përgatitjen e projektit për rregullimin e përkohshëm të trafikut, dhe për të marrë të gjitha miratimet e nevojshme nga institucionet kompetente.

Në të gjitha rastet e tjera, nga Kontraktori kërkohet të marrë të gjitha miratimet e nevojshme nga institucionet kompetente në lidhje me devijimin e përkohshëm të trafikut në rrugët publike.

Kur projekti bën thirrje për kryqëzim me rrugët ekzistuese të paklasifikuara dhe kryqëzim me rrugët që sigurojnë hyrjen në objektet fqinje, nga Kontraktori kërkohet të zhvillojë zgjidhje alternative, të cilat do t'i nënshtrohen miratimit vetëm të Inxhinierit Mbikëqyrës.

Njoftimi me shkrim dhe zgjidhja e propozuar do t'i paraqiten Inxhinierit Mbikëqyrës për aprovim të paktën 14 ditë përpara.

Kontraktorit i kërkohet të realizojë itineraret (devijimet) që do të përdoren përkohësisht për funksionimin e trafikut në përputhje me standardet e zbatueshme, duke marrë parasysh atë kategori të rrugës. Kontraktorit gjithashtu i kërkohet të sigurojë shpenzimet për funksionimin e sigurt të trafikut gjatë realizimit të punës ndërtimore. Pas përfundimit të punimeve, nga Kontraktori do të kërkohet të heqë rrugë të tillë të përkohshme.

Të gjitha punët dhe aktivitetet duhet të kryhen në përputhje me Ligjin për Ndërtimin, Ligjin për Sigurinë e Trafikut Rrugor, Ligjin për Rrugët Publike, në përputhje me ligjet dhe rregulloret e tjera në fuqi.

#### **Llogaritja e volumeve dhe pagesa**

Asnjë llogaritje dhe pagesë e veçantë nuk do të bëhet pasi puna përfshihet në çmimin total të ndërtimit.

### **1.34 LIDHJA ME RRUGE TE TJERA DHE HYRJE DALJET**

#### **Përshkrimi i punës**

Kontraktorit i kërkohet të sigurojë funksionimin e sigurt të trafikut dhe punon në pikat ku struktura ose vendi kryqëzon rrugët ekzistuese, kryqëzimet ekzistuese, rruget e këmbësorëve dhe rruget e biçikletave, ose ndonjë pjesë të tyre.

#### **Aktivitetet**

Në zonat ku, sipas mendimit të Inxhinierit Mbikëqyrës, devijimi i trafikut është i pamundur ose i panevojshëm, puna do të kryhet njëkohësisht me funksionimin e trafikut në rrugët ekzistuese të kryqëzuara nga sheshi i ndërtimit. Kontraktorit i kërkohet të marrë aprovimet e nevojshme nga autoritetet kompetente dhe të sigurojë funksionimin e sigurt të trafikut dhe sigurinë e personave të punësuar në vendin e ndërtimit.

Zona në të cilën realizohen punimet duhet të ndahet fizikisht nga zona në të cilën operohet trafiku.

Njoftimi me shkrim dhe zgjidhja e propozuar do t'i dorëzohen Inxhinierit Mbikëqyrës të paktën 14 ditë përpara.

#### **Llogaritja e volumeve dhe pagesa**

Asnjë llogaritje dhe pagesë e veçantë nuk do të bëhet pasi puna përfshihet në çmimin total të ndërtimit.

### **1.35 PUNIMET NE GJYSEM TE GJERESISE SE RRUGES**

#### **Përshkrimi i punës**

Puna e mbuluar nga ky seksion i specifikimeve konsiston ne furnizimin e gjithe kantierit, punen, pajisjet, veglat dhe materialet, dhe kryerjen e te gjitha punimeve, ne lidhje me hedhjen, kujdesin, perfundimin e punes se betonit dhe hekurin e armimit ne perputhje rigoroze me kete kapitull te specifikimeve dhe projekt zbatimin. Ne fillim te Kontrates Sipermarresi duhet te paraqese per miratim tek Mbikeqyresi i Punimeve nje njoftim per metodat duke detajuar, ne lidhje me kerkesat e ketyre Specifikimeve, propozimet e tij per organizimin e aktiviteteteve te betonimit ne shesh (terren). Njoftimi i metodave do te perfshije çeshtjet e meposhtme:

Njesia e prodhimit e propozuar

Vendosja dhe shtrirja e paisjeve te prodhimit te betonit

Metodat e propozuara per organizimin e paisjeve te prodhimit te betonit

Proçedurat e kontrollit te cilesise se betonit dhe materialeve te betonit

Transporti dhe hedhja e betonit

Detaje te punes se berjes se kallepeve duke perfshire kohen e heqjes se kallepeve dhe proçedurat per mbeshtetjen e perkohshme te trareve dhe te soletave.

**\*\*Kerkesat per cilesine dhe specifikimet per materialet qe do te perdoren per prodhimin e betoneve do te jene ne perputhe me EN206-1\*\***

**\*\*Kerkesat per rezistencen e betonit te ngurtesuar do te jene ne perputhje me EN 1992-1-1\*\***

### 1.2 Kontrolli i cilesise

Sipermarresi do te punesoje inxhinier te kualifikuar, te specializuar dhe me eksperience, i cili do te jete pergjegjes per kontrollin e cilesise te t`e gjithe betonit. Materialet dhe mjeshteria e perdorur ne punimet e betonit duhet te jete e nje cilesie sa me te larte qe te jete e mundur, prandaj vetem personel me eksperience dhe aftesi te plote ne kete kategori punimesh do te punesohet per punen qe perfshin ky seksion specifikimesh.

### 1.3 Puna pergatitore dhe inspektimi

Perpara se te jete kryer ndonje proçes i pergatitjes se llaçit ose betonit, zona brenda armaturave (ose siperfaqe te tjera sipas zbatimit) duhet te jete pastruar shume mire me uje ose me ajer te komprimuar. Çfaredo qe ka te beje me kete proçes duhet te pergatitet siç eshte specifikuar.

Asnje proçes betonimi nuk duhet te kryhet derisa Mbikeqyresi i Punimeve te kete inspektuar dhe aprovuar (nese eshte e mundur) germimin, masat e marra per mbrojtjen nga kushtet atmosferike, masat per shperndarjen e ujit per freskim dhe staxhionim, armaturat, ndalimin e ujit, fugat ndertimore dhe fiksimin e fundeve dhe masa te tjera, armimin dhe çeshtje te tjera qe duhet te fiksohen, si dhe te gjitha materialet e tjera per betonimin dhe masa te tjera ne pergjithesi. Sipermarresi duhet t`i jape Mbikqyresit te Punimeve njoftime te arsyeshme per te bere te mundur qe ky inspektim te kryhet.

## 1.4 Materialet

### Çimento

Çimento Portland e Zakonshme do te perdoret me BS 12 ose ASTM C-150 Tipi II-te ose Tipi V-te. Kjo do te perdoret aty ku betoni nuk eshte ne kontakt me ujera te zeza, tub gazi ose ujerat nentokesore.

Çimento Portland Sulfate e Rezistueshme do te perdoret me BS 4027. Kjo do te perdoret per strukturat e betoneve duke perfshire pusetat dhe te gjitha perkatesite e tjera ne kontakt me ujerat e zeza, tubin e gazit ose ujerat nentokesore. Çimento duhet te shperndahet ne paketa origjinale te shenuara te pa demtuara direkt nga fabrika dhe duhet te ruhet ne nje depo, dyshemeja e te cilit duhet te jete e ngritur te pakten 150mm nga toka. Nje sasi e mjaftueshme duhet mbajtur rezerve per te siguruar nje furnizim te vazhdueshem ne pune, ne menyre qe te sigurohet qe dergesat e ndryshme jane perdorur ne ate menyre siç jane shperndare. Çimentoja nuk duhet ruajtur ne kantier per me shume se tre muaj pa lejen e Mbikeqyresit te Punimeve. Çdo lloj tjetër çimento, perveç asaj qe eshte e parashikuar per perdorimin ne pune nuk duhet ruajtur ne depo te tilla. E gjithë çimentoja duhet mbajtur e ajrosur mire dhe çdo lloj çimento, e cila ka filluar te ngurtesohet, ose ndryshe e demtuar apo e keqesuar nuk duhet te perdoret. Fletet e analizave te fabrikave duhet te shoqerojne çdo dergese duke vertetuar qe çimentoja, e cila shperndahet ne shesh ka qene e testuar dhe i ka plotesuar kerkesat e permendura me lart. Me te mberritur, çertifikatat e provave te tilla duhen ti kalohen per t'i aprovuar. Mbikeqyresit te Punimeve. Çimentoja e perfituar nga pastrimi i thaseve te çimentos ose nga pastrimi i dyshemese nuk do te perdoret. Kur udhezohet nga Mbikqyresi i Punimeve, çimento e dyshimte duhet te ritestohet per humbjen e fortesise ne ngjeshje.

### Inertet

#### - Te pergjithshme

Me perjashtim te asaj qe eshte modifikuar ketu, inertet (te imta dhe te trasha) per te gjitha tipet e betonit duhet te perdoren duke respektuar STASH-512-78 (Standarti Shqiptar) ose ne perputhje me ASTM C 33 “Inertet e betonit nga burime natyrale”. Ato duhet te jene te forte dhe te qendrueshem dhe nuk duhet te permbajne materiale te demshme qe veprojne kunder fortesise ose qendrueshmerise se betonit ose, ne rast te betonarmese mund te shkaterroje kete perforcim.

Materialet e perdorura si inerte duhet te perftohen nga burime te njohura per te arritur rezultate te kenaqshme per klasa te ndryshme te betonit. Nuk do te lejohet perdorimi i inerteve nga burime, te cilat nuk jane te aprovuara nga Mbikeqyresi i Punimeve.

Inertet e imta

Inertet e imta per kategorite e betonit A, B dhe C (respektivisht M100, M200, M2500) konform STASH 512-78, do te jene prej rere natyrale, gure te shoshitur, ose materiale te tjera inerte me te njejtat karakteristika apo kombinim te tyre. E gjitha kjo duhet te jete pastruar shume mire, pa masa te mpiksura, cifla te buta e te veçanta, vajra distilimi, alkale, lende organike, argjile dhe sasi te substancave te demtuese.

Permbajtja maksimale e lejueshme e lymit dhe substancave te tjera demtuese eshte 5%. Materialet e marra nga gure te papershtashem per inerte te trasha nuk duhet te perdoren si inerte te imta. Inertet e

imta te marra nga guret e shoshitur duhet te jene te mprehte, kubike, te forte, te dendur dhe te durueshem dhe duhet te grumbullohen ne nje platforme per te patur nje mbrojtje te mjaftueshme nga pluhurat dhe perzierjet e tjera.

Shkalla e shperndarjes per inertet e imeta te specifikuara si me lart, duhet te jene brenda kufijve te meposhtem, te percakuara nga Mbikeqyresi i Punimeve.

Masa e Sites	Perqindja qe kalon (peshe e thate)
10.00mm	100
5.00mm	89 ne 100
2.36mm	60 ne 100
1.18mm	30 ne 100
0.60mm (600 um)	15 ne 100
0.30mm (300 um)	5 ne 70
0.15mm (150 um)	0 ne 15

Inertet e imeta per kategorine D te betonit duhet te jene te nje cilesie te mire nga rera e brigjeve. Ajo duhet te jete pastruar nga materialet natyrale e klasifikuar nga me e holla deri tek me e trasha, pa copeza, nga argjila, zgjyra, rera, plehra dhe cifla te tjera. Nuk duhet te permbaje me shume se 10% te materialit me te holle se 0.10mm (100um) te hapesires ne rrjete, jo me shume se 5% te pjeses se mbetur ne 2.36mm site; i gjithë materiali duhet te kaloje neper nje rrjete 10mm.

#### **-Inertet e trasha**

Inertet e trasha per kategorite e betonit A, B dhe C de te perbehen nga materiale guri te thyer apo te nxjerre, ose nje kombinim i tyre, me nje mase jo me shume se 20 mm, dhe do te jene te paster, te forte, te qendrueshem, kubik dhe te formuar mire, pa lende te buta apo te thermueshme, ose copeza te holla te stergjatura, alkale, lende organike ose masa apo substanca te tjera te demshme. Lendet demtuese ne inerte nuk duhet te kalojne me shume se 3 %. Klasifikimi per inertet e trasha te specifikuara sa me siper duhet te jete brenda kufijve te meposhtem:

Masa e sites	Perqindja e kalimit (ne peshe te thate)
mm	100
mm	90 ne 100
mm	35 ne 70
mm	10 ne 40
mm	0 ne 5

Inertet e trasha per kategorine D te betonit duhet te jene tulla te thyera te prodhuara prej tullave te cilesise se pare ose grumbulli i tyre, ose nga tulla te mbipjekura. Nuk do te thyhen per perdorim per inerte te imta as tullat e papjekura apo grumbulli i tyre dhe as ato qe jane bere porosi gjate procesit te



pjekjes. Agregati me tulla te thyera nuk duhet te permbaje gjethe, kashte dhe, rere ose materiale te tjera te huaja dhe ose mbeturina te tjera. Inertet prej tullave te thyera duhet te jene te nje diametri 25-40 mm dhe nuk duhet te permbajne asgje qe te kaloje nepermjet sites 2.36 mm.

### **Raportet e inerteve te trasha dhe te imta**

Raporti me i pershtatshem i volumit te inerteve te trasha ne volumen e inerteve te imta duhet te vendoset nga prova e ngjeshjes se kubikeve te betonit, por Mbikeqyresi i Punimeve mund te urdheroje qe keto raporte te ndryshojne lehtesisht sipas klasifikimit te inerteve ose sipas peshes nese do te jete e nevojshme, ne menyre qe te prodhohen klasifikimet e duhura per perzjerjet e inerteve te trasha dhe te holla.

Sipermarresi duhet te beje disa prova ne kubiket e marre si kampione dhe te shenoje inertet dhe fraksionimin e tyre, perzjerjen e betonit ne fillim te punes dhe kur ka ndonje ndryshim ne inertet e imeta apo te trasha ose ne burimin e tyre te furnizimit. Keta kubike duhet te testohen ne laborator ne kushte te njejta, pervec rasteve te ndryshimeve te vogla ne raportet perkatese te inerteve te imta dhe te trasha (lart apo poshte) nga raporti me i mire i arritur nga analizat e sites. Kubiket duhet te testohen nga 7 deri 28 dite.

Nga rezultatet e ketyre provave (testeve) Mbikeqyresi i Punimeve mund te vendose per raportet e trashesise se inerteve te imta qe duhet te perdoren per çdo perzjerje te mevoneshme gjate zhvillimit te punes ose deri sa te kete ndonje ndryshim ne inerte.

### *Shperndarja*

Ne kantier nuk do te sillen inerte per tu perdorur derisa Mbikeqyresi i Punimeve te kete aprovuar inertet per t'u perdorur dhe masat per larjen, etj.

Me tej nga Sipermarresi do te merren kampione ne çdo 75m<sup>3</sup> nen mbikqyrjen e Mbikqyresit te Punimeve, per çdo tip inerti te shperndare ne kantier (terren) dhe te dorezuar perfaqesuesit te Mbikeqyresit te Punimeve per provat e kontrolleve te zakonshme. Kostoja e te gjitha testeve do te mbulohet nga Sipermarresi.

### *Ruajtja e materialit te betonit*

Çimento dhe inertet duhet te mbrohen ne çdo kohe nga demtuesit dhe ndotjet. Sipermarresi duhet te siguroje nje kontenier apo ndertese per ruajtjen e çimentos ne shesh. Ndertesa ose kontenieri duhet te jete e thate dhe me ventilim te pershtatshem. Nese do te perdoret me shume se nje lloj çimentoje ne punime, kontenieri apo ndertesa duhet te jete e ndare ne nendarje te pershtatshme sipas kerkesave te Mbikeqyresit te Punimeve si dhe duhet ushtruar kujdes i madh qe tipe te ndryshme çimentoje te mos jene ne kontakt me njera tjetren.

Thaset e çimentos nuk duhet te lihen direkt mbi dysheme, por mbi shtresa druri apo pjese te ngritur trotuari per te lejuar keshtu qarkullimin efektiv te ajrit rreth e qark thaseve.

Çimentoja nuk duhet te mbahet ne nje magazine te perkohshme, pervec rasteve kur eshte e nevojshme per organizimin efektiv te perzjeres dhe vetem kur eshte marre aprovimi i meparshem i Mbikeqyresit te Punimeve.

Agregati duhet të ruhet në kantier në hambare ose platforma betoni të padepertueshme të përgatitura posaçërisht, në mënyrë që fraksione të ndryshme inertesh të mbahen të ndara për gjithë kohën në mënyrë që perzierja e tyre të ulët në minimum.

Sipërmarresit mund t'i kërkohej të kryejë në kantier procese shtese dhe/ose larje efektive të inerteve atëherë kur sipas Mbikeqyresit të Punimeve ky veprim është i nevojshëm për të siguruar që të gjitha inertet plotësojnë kërkesat e specifikimeve në kohën kur materialet e betonit janë perzjere. Mbikeqyresi i Punimeve do të aprovojë metodat e përdorura për përgatitjen dhe larjen e inerteve.

#### *Uji për cimento*

Uji i përdorur për beton duhet të jetë i pastër, i freskët dhe pa balte, papasteri organike vegjetale dhe pa kripera dhe substanca të tjera që nderhyjnë ose demtojnë forcën apo durueshmërinë e betonit. Uji duhet të sigurohet mundësisht nga furnizime publike dhe mund të merret nga burime të tjera vetëm nëse aprovohet nga Mbikeqyresi i Punimeve. Nuk duhet të përdoret asnjëherë ujë nga germimet, kullimet sipërfaqësore apo kanalet e vaditjes. Vetëm ujë i aprovuar nga ana cilësore duhet të përdoret për larjen e pastrimin e armaturave, kujdesin e betonit si dhe për qëllime të ngjashme.

## 1.5 Kërkesat për perzierjen e betonit

### Fortesia

Klasifikimet i referohen raporteve të çimentos, inerteve të imta dhe inerteve të trasha. Kërkesat për perzierjen e betonit duhet të konsistojnë në ndarjen proporcionale dhe perzierjen për fortesite e mëposhtme kur behen testet e kubikeve;

### Klasat e rezistencës në shtypje

Betoni i përshkruar në Vizatime, në Raport Strukturor dhe në Preventiv është i emërtuar sipas klasave të rezistencës në përputhje me EN 206-1. Për klasifikimin e betonit sipas klasave të rezistencës përdoret rezistenca karakteristike në shtypje e cilindrave me moshe 28 dite me diametër 150mm dhe lartësi 300mm ( $f_{ck,cyl}$ ) ose kubeve me moshe 28 ditore me brinjë 150mm ( $f_{ck,cube}$ ). Për betonin me peshe normale, klasat standarde të rezistencës janë paraqitur në tabelën e mëposhtme (tabela 7 e EN 206-1).

Klasa e rezistencës në shtypje	Rezistenca karakteristike e cilindrit, $f_{ck,cyl}$ , N/mm <sup>2</sup>	Rezistenca karakteristike e kubit, $f_{ck,cube}$ , N/mm <sup>2</sup>
C8/10	8	10
C12/15	12	15
C16/20	16	20

C20/25	20	25
C25/30	25	30
C30/37	30	37
C35/45	35	45

Tabela 2 - Fragment nga Tabela 7 e EN 206-1:

### Raporti uje-çimento

Raporti uje-çimento është raport i peshës së çimentos në të. Përmbajtja e ujit duhet të jetë efiçase për të prodhuar një përzierje të punueshme të fortësive të specifikuar, por përmbajtja totale e ujit duhet të përcaktohet nga tabela e mëposhtme:

Klasa e betonit	Max. i ujit të lire/raporti çimento
Klasa A&A (C12/15) (s) 1:1, 5:3	0.65
Klasa B&B (C16/20) (s) 1:2:4	0.6
Klasa C&C (C20/25) (s) 1:3:6	0.55
Klasa D&D (C25/30) (s) 1:6:12	0.5

Shenim. (s) = Çimento sulfatë e rezistueshme

### Qendrueshmeria

Raportet e përberësve duhet të jenë të ndryshëm për të siguruar qëndrueshmërinë e dëshiruar të betonit kur provohet (testohet), në përshatje me kërkesat e mëposhtme ose sipas urdherave të Mbikqyresit të Punimeve.

Përdorimet e betonit	Min&Max (mm)
Seksionet normale të forcuara te ngjeshura me vibrime, ngjeshja me dorë e masës së betonit	25 në 75
Seksione prej betonarmeje të renda Te ngjeshura me vibracion, beton i ngjeshur me dorë në pllaka të forcuara normalisht, trare, kollona dhe mure.	50 në 100

Ne te gjitha rastet, raportet e agregatit ne beton duhet te jene te tilla qe te prodhohen perzjerje te cilat do futen neper qoshe edhe cepa te formave si dhe perreth perforcimit pa lejuar ndarjen e materialeve.

## 1.6 Matja e materialeve

Inertet e imeta dhe te trasha do te peshohen ose te maten me kujdes ne pershtatje me kerkesat e Manaxheri te Projektit. Ato nuk do te maten ne asnje rast me lopata apo karroca dore. Çimento do te matet me thase 50 kg dhe masa e perzjerjes do te jete e tille qe grumbulli i materialeve te pershtatet per nje ose me shume thase.

## 1.7 Metodat e perzjerjes

Betoni duhet te perzjehet ne perzjeresa mekanike te miratuar qe me pare. Perzjeresi, hinka dhe pjesa perpunuese e tij duhet te jene te mbrojtura nga shiu dhe era.

Inertet dhe cimento duhet te perzjehen se bashku para se te shtohet uje derisa persjerja te fitoje ngjyren dhe fortesine e duhur. Duhet te largohen papastertirat dhe substancat e tjera te padeshirueshme. Uji nuk duhet te shtohet nga zorra apo rezervuare ne menyre te pakujdesshme. I gjithë betoni duhet te perzihet uniformisht ne fabrika moderne perzjerjeje per prodhimin maximal te betonit te nevojshem per plotesimin e punes brenda kohes se percaktuar pa zvogeluar kohen e nevojshme per perzjerje. Betoni duhet te perzjehet ne perzjeresa betoni per kohezgjatjen e kerkuar per shperndarjen uniforme te perberesve per te prodhuar nje mase homogjene me ngjyre dhe fortesi por jo me pak se 1-1/2 minute. Perzjeresi duhet te perdoret nga punetore te specializuar qe kane eksperience te meparshme ne drejtimin e perdorimit e perzjeresit te betonit.Me mbarimin e kohes se perzjerjes, perzjeresi dhe te gjitha mjetet e perdorura do te pastrohen mire perpara se betoni i mbetur ne to te kete kohe te forcohet.Ne asnje menyre nuk duhet qe betoni te perzjehet me dore pa miratimin e Mbikeqyresit te Punimeve, miratim ky qe do te jepet vetem per sasi te vogla ne kushte te veçanta.

## 1.8 Provat e fortesise gjate punes.

Sipermarresi duhet te siguroje per qellimet e provave nje se 3 kubikesh per çdo strukture betoni, perfshire derdhje betoni nga 1-15 m<sup>3</sup>. Per derdhje betoni me shume se 15 m<sup>3</sup>. Sipermarresi duhet te siguroje te pakten nje set shtese 3 kubikesh per çdo 30 m<sup>3</sup> shtese. Nese mesatarja e proves se fortesise se kampionit per çdo porcion te punes bie poshte minimumit te lejueshem te fortesise se specifikuar, Mbikeqyresi i Punimeve do te udhezaje nje ndryshim ne raportet ose permbajtjen e ujit ne beton, ose te dyja, ne menyre qe Punedhenesi te mos kete shtese kostoje. Sipermarresi duhet te percaktoje te gjitha kampionet qe kane te bejne me raportet e betonimit prej nga ku jane marre. Nese rezultatet e testeve te fortesise mbas kontrollit te specimentit tregojne se betoni i perftuar nuk i ploteson kerkesat e specifiuara ose kur ka prova te tjera qe tregojne se cilesia e betonit eshte nen nivelin e kerkesave te specifiuara, betoni ne vendin, qe perfaqeson kampioni do te refuzohet nga Mbikeqyresi i Punimeve dhe Sipermarresi do ta levize dhe ta rivendose masen e kthyer te betonit mbrapsh me shpenzimet e veta. Sipermarresi do te mbuloje shpenzimet e te gjitha provave qe do te behen ne nje laborator qeeshte aprovuar Punedhenesit.

## 1.9 Transportimi i betonit

Betoni duhet të levizet nga vendi i përgatitjes në vendin e vendosjes përfundimtare sa më shpejt në mënyrë që të pengohet ndarja ose humbja e ndonjë perberesi.

Kur të jete e mundshme, betoni do të derdhet nga perzjerësi direkt në një paisje që do të bëjë transportimin në destinacionin përfundimtar dhe betoni do të shkarkohet në mënyrë aq të mbledhur sa të jete e mundur në vendin përfundimtar për të shmangur shpërndarjen ose derdhjen e tij.

Nëse Sipermarresi propozon të përdorë pompa për transportimin dhe vendosjen e betonit, ai duhet të paraqesë detaje të plota për paisjet dhe tekniken e përdorimit që ai propozon për të përdorur për t'u miratuar tek Mbikeqyesi i Punimeve.

Në rastet kur betoni transportohet me rreshqitje apo me pompa, kantieri që do të përdoret, duhet të projektohet për të siguruar rrjedhjen e vashdueshme dhe të panderprere në rrepi apo gryke (hinke). Fundi i pjerresisë ose i pompës së shpërndarjes duhet të jete i mbushur me ujë para dhe pas çdo periudhe pune dhe duhet të mbahet pastër. Uji i përdorur për këtë qëllim, duhet të largohet (derdhet) nga çdo ambient pune i përhershëm.

## 1.10 Hedhja dhe ngjeshja e betonit

Sipermarresi duhet të ketë aprovimin e Mbikeqyresit të Punimeve për masat e propozuara përpara se të fillojë betonimin.

Të gjitha vendet e hedhjes dhe të ngjeshjes së betonit, duhet të mbahen në mbikeqyrje të vazhdueshme nga pjesëtarët përkatës të ekipit të Sipermarresit.

Sipermarresi duhet të ndjeke nga afër ngjeshjen e betonit, si një punë me rëndësi të madhe, objekt i të cilit do të jete prodhimi i një betoni të papershkueshëm nga uji me një densitet dhe fortesë maksimale.

Pasi të jete perzjerje, betoni duhet të transportohet në vendin e tij të punës sa më shpejt që të jete e mundur, i ngjeshur mirë në vendin rreth perforcimit, i perzjerë siç duhet me lopatë me mjete të përshtatshme çeliku për kallepe duke siguruar një sipërfaqe të mirë dhe beton të dendur, pa vrima, dhe i ngjeshur mirë për të sjellë ujë në sipërfaqe dhe për të ndaluar xhepat e ajrit. Armatura duhet të jete e hapur në mënyrë të tillë që të lejojë daljen e bulezave të ajrit, dhe betoni duhet të vibrohet me çdo kusht me mekanizma vibrues për ta bërë atë të dendur, aty ku është e nevojshme.

Betoni duhet të hidhet sa është i freskët dhe para se të ketë fituar qëndrueshmërinë fillestare, dhe në çdo rast jo më vonë se 30 minuta pas perzjerjes.

Metoda e transportimit të betonit nga perzjerësi në vendin e tij të punës duhet të aprovohet nga Mbikeqyesi i Punimeve. Nuk do të lejohet asnjë metode që nxit ndarjen apo vecimin e pjeseve të trasha dhe të holla, apo që lejojnë derdhjen e betonit lirisht nga një lartësi më e madhe se 1.5m.

Kur hedhja e betonit ndërpritet, betoni nuk duhet në asnjë mënyrë të lejohet të formojë skaje apo ane, por duhet të ndalohet dhe të forcohet mirë në një ndalesë të ndertuar posaçërisht dhe të formuar mirë për të krijuar një bashkim konstruktiv efikas, që është në përgjithsi, në qoshtet e djathta drejt armatimit kryesor. Pozicioni dhe projekti i fugave të tilla, duhet të aprovohen nga Mbikeqyesi i Punimeve.

Menjehere para se te hidhet betoni tjetër, sipërfaqet e të gjitha fugave duhet të kontrollohen, të pastrohen me furçe dhe të lahen me llaç të pastër. Është e keshillueshme që ashpersia e betonit të jete arritur kur ngjyra behet gri dhe të mos lihet derisa të forcohet.

Para se betoni të hidhet në ose kundrejt një germimi, ky germim duhet të jete i forcuar dhe pa uje të rrjedhshëm apo të ndenjtur, vaj dhe lende të demshme. Balta e qullet dhe materialet e tjera dhe në rast germim guresh, copeza dhe thermija do të hiqen. Gropa duhet të jete e qullet por jo e lagur dhe duhet të ndermerren masa paraprake për të parandaluar ujërat nentokesore që të demtojnë betonin e pa hedhur ose të shkaktojnë levizjen e betonit.

Aty ku është e nevojshme apo e kërkuar nga Mbikëqyresi i Punimeve, betoni duhet të vibrohet gjatë hedhjes me vibratore të brendshëm, të afte për të prodhuar vibrime jo më pak se 5000 cikle për minute. Sipërmarresi duhet të tregojë kujdes për të shmangur kontaktin midis vibratorëve dhe perforcimit, dhe të evitohet veçimin e inerteve nga vibrimi i tepert. Vibratorët duhet të vendosen vertikalisht në beton 500 mm larg dhe të terhiqen gradualisht kur flluckat e ajrit nuk dalin më në sipërfaqe. N.q.s, në vazhdim, shtypja është aplikuar jashtë armatures, duhet të kihet kujdes i madh që të shmangët demtimi i betonarmesë.

Kur betoni vendoset në ndalesa horizontale ose të pjerreta të kalimit të ujit, kjo e fundit duhet të zhvendoset duke i lene vendin betonit që duhet të ngjeshet në një nivel pak më të lartë se fundi i ndalesës së ujit para se të leshohet uji për të siguruar ngjeshje të plote të betonit rreth ndalesës së ujit.

### 1.11 Betonim në kohë të nxehtë

Sipërmarresi duhet të tregojë kujdes gjatë motit të nxehtë për të parandaluar çarjen apo plasaritjen e betonit. Aty ku është e realizueshme. Sipërmarresi duhet të marrë masa që betoni të hidhet në mëngjes ose natën vonë.

Sipërmarresi duhet të ketë kujdes të veçantë për kërkesat e specifiuara këtu për kujdesin. Kallepet duhet të mbulohen nga ekspozimi direkt në diell si para vendosjes së betonit, ashtu edhe gjatë hedhjes dhe vendosjes. Sipërmarresi duhet të marrë masa të pershtatshme për të siguruar që armimi dhe hedhja e masës për tu betonuar është mbajtur në temperaturat më të ulëta të zbatueshme.

### 1.12 Kujdesi për betonin

Vetem neqoftese është përcaktuar apo urdheruar ndryshe nga Mbikëqyresi i Punimeve, të gjitha betonët do të ndiqen me kujdes si më poshtë:

Sipërfaqe betoni horizontale: do të mbahet e lagët vazhdimisht për të pakten 7 dite pas hedhjes. Ato do të mbulohen me materiale uje mbajtes si thasë kerpi, pelhure, rere e paster ose rrogos ose metoda të tjera të miratuara nga Mbikëqyresi i Punimeve.

Sipërfaqe vertikale: do të kujdesen fillimisht duke lene armaturat në vend pa levizur, duke varur pelhure ose thasë kerpi mbi sipërfaqen e perfunduar dhe duke e mbajtur vazhdimisht të lagët ose duke e mbuluar me plasmas.

### 1.13 Forcimi i betonit

Me perfundimin e germimit dhe aty ku tregohet ne vizatimet ose urdherohet nga Mbikqyresi i Punimeve, nje shtrese forcuese betoni e kategorise D jo me pak se 75 mm e trashe ose e thelle do te vendoset per te parandaluar shperberjen e mases dhe per te formuar nje siperfaqe te paster pune per strukturen.

### 1.14 Celiku i armimit

Kjo punë konsiston në mobilimin dhe vendosjen e çelikut përforcues. Çeliku përforcues i përdorur për të kryer përforcimin e strukturave në këtë projekt është i tipit B500C me specifikime sipas EN 1992-1-1. Detajet e plota për secilin çelik janë dhënë në kodet përkatëse të cituara më sipër.

Dispozitat e përfshira në këto kërkesa kanë të bëjnë me përforcimin e çelikut për beton, dmth. Çelikon përforcues të perkulur në vend dhe çelikon përforcues të prodhuar në një fabrikë pune çeliku.

Shufrat e armimit duhet të kthehen sipas masave dhe dimensioneve të vizatimeve, dhe në perputhje të plote me rregulloren, e rishikuar se fundi të ASTM, shenimi A-615 me titullin “Specifikimet për shufrat e hekurit për betonarme”. Ato duhet të perkulen në perputhje me vizatimet e ASTM A-305.

Hekuri i armimit duhet të jetë pa njolla, ndryshk, mbeturina të mullijve, bojera, vajra, graso, dherave ngjitese ose ndonjë material tjetër që mund të demtojë lidhjen midis betonit dhe armimit ose që mund të shkaktojë korrozion të armimit ose shperberje të betonit. Çimento për suva nuk duhet të lejohet. As madhesia dhe as gjatesia e shufrave nuk duhet të jenë më pak se madhesia ose gjatesia e treguar në vizatime.

Shufrat duhet të perkulen gjithmone në të ftohtë. Shufrat e perkulura jo siç duhet do të perdoren vetëm nëse mjetet e perdorura për drejtimin dhe riperkuljen të jenë të tilla që të mos demtojë materialin. Asnjë armim nuk do të perkulet në pozita pune pa aprovimin e Mbikqyresit të Punimeve, nëse është ngulur në betonin e forcuar. Rrezja e brendshme e perkuljeve nuk duhet të jetë më e vogël se dyfishi i diametrit të shufrave për hekur të bute dhe trefishi i diametrit të shufrave për hekur shumë elastik.

Armimi duhet të bëhet me shumë kujdes dhe të mbahet nga paisjet e miratuara në pozicionin e paraqitur në skica. Shufrat që janë parashikuar të jenë në kontakt duhet të lidhen së bashku me siguri të lartë në të gjitha pikat e kryqezimit me tel të kalitur hekuri të bute me diametër No.16. Kordonat lidhen dhe të tjeret si këto duhet të lidhen fort me shufrat me të cilat janë parashikuar të jenë në kontakt dhe përveç kësaj duhet të lidhen në mënyrë të sigurtë me tel. Menjehere para betonimit, armimi duhet të kontrollohet për saktësi vendosjeje dhe pastërtie dhe do të korrigjohet nëse është e nevojshme.

Spesoret duhet të jenë prej llaçi me çimento dhe rere 1:2 ose materiale të tjera të miratuara nga Mbikqyresi i Punimeve.

Sipërmarresi duhet të pershtase masa efektive për të siguruar që përforcimi të qendrojë i palevizur gjatë forcimit të masës së hedhur dhe vendosjes së betonit.

Në soletat e dhena me dy ose me shumë shtresa përforcimi, shtresat paralele të hekurit duhet të mbeshteten në pozicion me ndihmën e mbajtësve prej hekuri. Spesoret vendosen në çdo mbajtës për të mbeshtetur shtresat e armimit nga forcimi ose armatura.

Perveç se kur tregohet ndryshe ne skica, gjatesia e nyjeve bashkuese duhet te jete jo me pak se 40 here e diametrit te shufres me diameter me te madh.

Armimet e ndertuara kur shtrohen perbri seksioneve te tjera te armimit ose kur xhuntohen, duhet te kene nje minimum xhuntimi prej 300mm per shufrat kryesore dhe 150 mm per shufrat e terthorta. Perdorimi i mbeturinave te prera nuk do te lejohet.

Perveç se kur eshte specifiuar apo treguar ndryshe ne skica, mbulimi i betonit ne perforcimin me te afert duke perjashtuar suvane ose punime te tjera dekorative dhe forcim betoni, do te jete si me poshte:

Per pune te jashtme dhe per pune ne siperfaqe toke dhe ne struktura ujembajtese -50mm

Per pune te brendeshme ne struktura joujembajtese:

per trare dhe kolona-50mm ne hekurin kryesor dhe ne asnje vend me pak se 40mm ne shufren me afer murit te jashtem

per forcimin e soletave-25mm per te gjitha shufrat ose diametri i shufres me te madhe, ciladoqofte me e madhja.

Prerja, perkulja dhe vendosja e armimit do te jete pjese e punes brenda çmimit njesi te vendosura ne Oferten e tenderit per armimin e hekurit te furnizuar dhe te vene ne pune.

Projektimi i armimit nga puna qe eshte duke u realizuar ose e realizuar tashme, nuk do te kthehet ne pozicionin e sakte vetem ne rast se eshte miratuar nga Mbikeqyresi i Punimeve dhe do te mbrohet nga deformimi ose demtime te tjera. Saldimi i shufrave te perforcuara me perjashtim te rasteve te shufrave te fabrikuara me saldime nuk do te lejohet. Shufrat e perforcuara te ekspozuara per shtesa te ardhshme, do te mbrohen nga korrozioni dhe rreziqe te tjera.

### 1.15 Ndertimi dhe cilesia e armatures

Armatura duhet te jete mjaft rigjide dhe e forte ne menyre qe t'i qendroje forces se betonit dhe te çdo ngarkese konstruktive dhe duhet te jete e formes se kerkuar. Njeri nga te dy materialet mund te perdoret, druri ose metali. Cilido material te jete perdorur, duhet te jete i mberthyer ne menyre gjatesore dhe terthore, i perforcuar dhe gjithashtu per te siguroje rigjeditetin duhet te jete i papershkueshem nga uji ne te gjitha rastet e paparashikuara.

Armatura e mire duhet te perdoret per te prodhuar nje pune perfundimtare me cilesi te larte pavaresisht qe gjurmet e shenjave te kallepit te armimit mbi siperfaqen e betonit do te mbeten. Armatura duhet te jete nga veshje me derrase te thate, ose armature me siperfaqe metalike te cilesise se larte duhet te perdoren. Armatura e cilesise se ulet mund te perdoret per siperfaqe qe duhet te suvatohen ose ato te goposura ne toke, dhe duhet te montohen nga derrasa ne forme pykash me qoshet e lemuara dhe te sigurta ose nga armatura çeliku te aprovuara.

Pjesa e brendshme e te gjithe armaturave (perjashto ato per punimet qe do te mbarohen me suvatim) duhet te lyhen me vaj liri, nafte bruto, ose sapun çdo here qe ato te fiksohen. Vaji duhet te aplikohet perpara se te jete vendosur perforcimi dhe nuk duhet lejuar qe lysterja te preke perforcimin. Vajosja etj, behen qe te parandaloje ngjitjen e betonit tek armatura .

Armatura duhet te goditet pa tronditur, vibruar ose demtuar betonin. Armatura qe do te riperdoret duhet te riparohet dhe pastrohset perpara se te rivendoset. Siperfaqet e brendshme te gjithe armaturave duhet te pastrohen komplet perpara vendosjes se betonit.



Kur armatura eshte prej lende drusore, siperfaqja e brendshme duhet te laget pikerisht perpara se te hidhet betoni per te shmangur keshtu absorbimin e lageshtires nga betoni.

Megjithate per ndonje armature momentale ose te propozuar duhet te merret miratimi i Mbikeqyresit te Punimeve, dhe Sipermarresi duhet te mbaje pergjegjesi te plote per kapacitetin e tij dhe per permbushjen e kesaj klauzole si dhe per ndonje konseguence te dukshme te nje pune te parakohshme ose te demshme.

Ai duhet te heqe dhe rivendose ndonje ngritje te manget ose derdhje te betonit per te cilen armatura ka defekte ne zbatim te kesaj klauzole, ne nje mase te tille siç ndoshta kerkohet nga Mbikeqyresi i Punimeve.

Pasi te vendoset ne pozicion armatura duhet te mbrohet kundrejt te gjitha demtimeve dhe efekteve te motit dhe ndryshimeve te temperatures. Neqoftese kjo eshte gjetur si e pazbatueshme per vendosjen e menjehereshme te betonit, armatura duhet te inspektohet perpara se betoni te hidhet per t'u siguruar qe bashkimet jane te puthitura, qe forma eshte sipas modelit dhe qe te gjitha papastertite jane rihequr perfshire ndonje veprim te ujit nga lageshtira e permendur me siper

Vetem lidhjet dhe shtrengimet etj. te aprovuara nga Mbikeqyresi i Punimeve duhet te perdoren. Terheqjet, konet, pajisjet larese ose te tjera mekanizma te cilat lene vrime ose depresione ne siperfaqen e betonit me diametra me te medha se 20 mm nuk do te lihen brenda formave.

### 1.16 Heqja e armatures

Armatura nuk duhet te levizet derisa betoni te arrije fortesine e duhur per te siguruar nje qendrueshmeri te struktures dhe per te mbajtur ngarkesen ne keputje dhe çdo ngarkese konstruktive qe mund te veproje ne te. Betoni duhet te jete mjaft i forte dhe te parandalohet demtimi i siperfaqeve nepermjet perdorjes me kujdes te veglave ne heqjen e formave.

Armatura duhet te hiqet vetem me lejen e Mbikeqyresit te Punimeve dhe puna e dukshme pas marrjes te nje lejeje te tille duhet te kryhet nen supervizionin personal te nje tekniku ndertimi kompetent. Kujdes i madh duhet te ushtrohet gjate levizjes se armatures per te shmangur tronditjet ose ne te kundert shtypjen ne beton.

Ne rastin kur Mbikeqyresi i Punimeve e konsideron qe Sipermarresi duhet te vonoje heqjen e armatures ose per shkak te kohes ose per ndonje arsye tjeter ai mund te urdheroje Sipermarresin qe te vonoje te tilla levizje dhe Sipermarresi nuk duhet te ankohet per vonesa ne konseguence te kesaj.

Pavaresisht nga kjo, ndonje njoftim i lejuar ose aprovim i dhene nga Mbikeqyresi i Punimeve, Sipermarresi duhet te jete pergjegjes per ndonje demtim per punen dhe çdo demtim per rrjedhim shkaktuar nga levizja ose qe rezulton nga levizja e armatures.

Tabela meposhtme eshte dhene si nje guide per Sipermarresin dhe nuk ka rruge qe çliron Sipermarresin nga detyrimet ketu:

Tipi i Armatures	Betoni
Soleta dhe traret ne ane te mureve	1 Dite

dhe kollonat e pangarkuara

Mbeshtetjet e soletave dhe trareve 7 Dite

te lena qellimisht ne vend

Levizja e qellimshme e mbeshtetseve 14 Dite

te soletave dhe trareve (temperatura e ambientit duhet te jete 25 grade celsius)

### 1.17 Betoni i parapergatitur

Perjashto rastin kur specifikohet ndryshe ketu njesite e betonit te parapergatitur duhet te derdhen ne tipin e aprovuar te çdo kallepi me nje numer individual ose shkronje per qellime identifikimi. Numri i shkronjes duhet te jete ose i stampuar ose e futur ne kallop ne menyre qe çdo njesi e betonuar ne nje kallop te posaçem do te deshmoje identifikimin e kallopit. Ne vazhdim data e betonimit te produktit duhet gjithashtu te gervishtet ose lyhet me boje mbi modelin. Pozicioni i shenjes se identifikimit te kallopit dhe dates duhet te jene ne faqen e cila nuk do te ekspozohet ne punen e perfunduar dhe duhet te aprovohet nga Mbikeqyesi i Punimeve perpara se betonimi te filloje.

Betoni per njesine e parafabrikuar duhet te testohet siç specifikohet ketu dhe duhet te vendoset dhe kompaktohet nga menytrat e aprovuara nga Mbikeqyesi i Punimeve.

Njesite e betonit te parafabrikuar nuk duhet te levizen ose transportohen nga vendi i betonimit derisa te kete kaluar nje periudhe prej 28 ditesh nga data e betonimit. Klauzolat ketu referuar betonit, hekurit te armuar dhe armatures duhet zbatuar njesoj edhe per betonin e parapergatitur.

### 1.18 Mbulimi i çmimit njesi per betonet

Çmimi njesi per nje meter kub beton i derdhur mbulon furnizimin e inerteve, çimentos dhe ujit dhe perzjerjen, hedhjen dhe ngjeshjen ne çdo seksion ose trashesi, kujdesin, provat dhe te gjitha aktivitetet e tjera qe pershkruhen me siper te cilat jane domosdoshmerisht te nevojshme per ekzekutimin e punimeve.

Perveç sa me siper, formimi i bashkimeve siç tregohen ne vizatimet ose siç instruktohen nga M.P., mbushja e bashkimeve me material izolues, vedosja e armimit ku te jete e nevojshme, armaturat dhe fuqia punetore jane perfshire ne çmimin njesi te betoneve.

Vetem kosto e transportimit te inerteve, çimentos hekurit nuk perfshihen ne çmimin njesi te betonit, por ne çmimin njesi te transportit.

**Matjet:** Matja e volumit te betonit te derdhur do te bazohet ne permasat e marra nga vizatimet qe lidhen me kete punim.

Çdo volum betoni pertej limiteve te treguara ne vizatime nuk do te paguhet nese M.P. nuk ka instruktuar ndryshe paraprakisht me shkrim.

## CELIKU PER ARMIM

### 1.1 Pershkrimi

Kjo pune konsiston ne pajisjen dhe vendosjen e çelikut perforcues (armues). Celiku i perdorur per te realizuar armimin e strukturave ne kete projekt eshte i tipit B500 C me specifikime sipas EN 1992-1-1.

### 1.2 Listat e porosise

Ne listat e porosise se çelikut perforcues, te perdoren te njejtat shenja te shufres perkatese per etiketimin siç tregohet ne planimetri. Te dorezohen listat e porosise dhe diagramet e perkuljes per miratim. Miratimi nuk lehteson kontraktuesin nga pergjegjesia per saktesine e listave dhe diagrameve.

Te mos porositet materiali derisa e pranohen listat dhe diagramet. Te mos prodhohet perforcimi vertikal ne kolona, mure, skele dhe ne boshte derisa te vendosen lartesine e themelit ne terren.

### 1.3 Identifikimi

Te transportohet perforcimi i shufres ne pakot standarde, te etiketuara dhe te vulosura sipas Manualit *CRSI te Praktikes Standarde*.

### 1.4 Perkulja

Te prodhohen shufrat perforcuese sipas ACI SP 66. Te ftohet perkulja e shufrave perforcuese qe kerkojne perkuljen. Te kufizohet lartesia e pergjithshme ose te bjere toleranca e perkuljes se shufrave te kapriates se kuvertes ne + 0 mm ose - 6 mm. Te mos perkulen shufrat pjeserisht te ngulitura ne beton, perveç siç tregohet ne planimetri ose siç lejohet ndryshe.

Te sigurohen çengela standarde qe perputhen me ACI SP 66.

### 1.5 Mbrojtja e materialit

Te ruhet çeliku perforcues mbi toke ne platforma, karabina, ose ne mbeshtetje te tjera. Te mbrohet nga demtimet fizike, ndryshkja dhe perkeqesimi i siperfaqeve te tjera.

Te perdoret çeliku perforcues vetem kur siperfaqja eshte e paster dhe dimensionet minimale, zona e seksionit kryq dhe vetite e terheqjes, perputhen me kerkesat fizike per madhesine dhe klasen e specifikuar te çelikut.

Te mos perdoret çeliku perforcues qe eshte plasaritur, laminuar ose eshte i mbuluar me papasterti, ndrysh, boje, graso, vaj ose materiale te tjera te demshme.

## 1.6 Çeliku perforcues i veshur me epoks

Te mbeshteten shufrat e veshura ne zonat e kontaktit te lidhura. Te mbushen grupet e lidhura. Te ngrihen me nje mbeshtetje te forte. Te parandalohet gerryerja shufer me shufer. Te mos leshohen ose terhiqen tufat.

Para vendosjes, te kontrollohen shufrat per demtim e veshjes. Te zevendesohen dhe te mos perdoren shufrat me nje siperfaqe totale te demtuar ne çdo gjatesi prej 12-inç (300 mm) qe tejkalon 5 % te siperfaqes se asaj gjatesie te shufres.

Te pastrohen veshjet e tjera te demtuara duke hequr ndotesit siperfaqesore dhe shtresen e demtuar. Te ashpersohet zona rreth demtimit dhe te hiqet ndryshku permes pastrimit me rryme ajri ose pastrimit me veglat me fuqi. Te perdoret nje material riparues i kualifikuar sipas AASHTO M 284 per riparimin e defekteve ne veshje qe jane te dukshme me sy te lire. Te mbivendoset materiali riparues mbi veshjen origjinale per 50 mm ose siç rekomandohet nga prodhuesi. Te sigurohet nje trashesi minimale e nje shtrese te thateprej 200 mikrometer ne zonat e riparuar.

Te merren hapat e nevojshem per te minimizuar demtimin e veshjes se shufrave te instaluar. Te pastrohet dhe te riparohet demtimi i veshjeve te verejtura pas instalimit siç eshte pershkruar me siper. Te trajtohen me perpikmeri shufrat sipas rekomandimeve te prodhuesit te rreshires dhe para se te ndodhe oksidimi i demshem.

Te vishen bashkimet mekanike pas montimit te bashkimit sipas AASHTO M 284 per riparimin e veshjeve me epoks te demtuara.

## 1.7 Vendosja dhe fiksimi

Te vendosen, fiksohen dhe te mbeshteten shufrat sipas Manualit te Praktikes Standarde te CRSI-se. Te vishen karriget, telat e lidhjes dhe pajisjet e tjera qe perdoren per te mbeshtetur, pozicionuar ose perforcuar perforcimin e veshur me epoks me nje material joperçues.

Te perdoren blloqe betoni te parapergatitur ose mbeshtetjet metalike. Te bashkangjiten mbeshtetjet e bllokut te betonit ne shufren e mbeshtur me tela te hedhur ne qender te secilit bllok. Te perdoren mbeshtetjet metalike te klases 1 (plastike e mbrojtur) ose klases 2, Lloji B (çeliku i pandryshkshem i mbrojtur) ne kontakt me siperfaqet e ekspozuara te betonit. Te perdoret çelik i pandryshkshem sipas ASTM A493, tip 430.

Te ndahen mbeshtetjet e shufrave te pllakes jo me shume se 1200 mm larg ne menyre trasversale ose gjatesore. Te mos perdoren mbeshtetjet e shufrave, drejtpersedrejti ose terthorazi, per te mbeshtetur pistat per karrocet e betonit ose per ngarkesa te tjera te ndertimit. Te zevendesohen mbeshtetjet e demtuara.

Te vendosen shufrat brenda 38 milimetrave te vendit te projektit. Te mos grumbullohen variacione ndarjesh. Te mos lejohet qe mesatarja e çdo dy hapesirave ngjitur te kaloje hapesiren e kerkuar. Te vendoset çeliku perforcues ne pllakat e dyshemese brenda 6 milimetrave te vendit te projektit vertikal. Duke perdorur nje shabllon, te kontrollohet mbulesa e paster mbi çelikun perforcues te dyshemese perpara se te vendoset betoni ne dysheme.

Te sigurohen 50 milimetra te mbuleses se paster per perforcim. Toleranca ne mbulimin minimal te betonit eshte minus 10 milimetra. Per siperfaqet e betonit te derdhura kundrejt tokes, te sigurohet nje minimum prej 75 mm te mbuleses se paster mbi perforcim.

Te mos vendoset beton ne asnje element deri sa te miratohet vendosja e çelikut perforcues.

## 1.8 Lidhjet

Te mos lejohen pa miratim lidhjet, perveç atyre te treguara ne projekt. Te sigurohet gjatesia e mbeshtetjes se treguar ne projekt. Te lidhen shufrat e perforcimit vetem kur tregohet ne projekt ose ne vizatimet e pranuar.

Te krijohen lidhjet e mbeshtetura duke vendosur shufrat perforcuese ne kontakt dhe te lidhen se bashku ne menyre qe tte ruhet rradhitja dhe pozicioni i shufrave.

Nese lejohet saldimi i çelikut perforcues, te perdoren saldatorët me çertifikime aktuale dhe te behen saldimet ne perputhje me Kodin Strukturor te Saldimit AWS - çeliku perforcues, D 1.4. Te mos saldohet çeliku perforcues nese perberja kimike e çelikut tejkalon perqindjet ne tabelen meposhte:

Chemical Composition	Percent
Carbon (C)	0.30
Manganese (MA)	1.50
Carbon Equivalent (C.E.)	0.55

*Tabela 3 - Perberesit e celikut per armim*

Bashkuesit mekanike mund te perdoren ne vend te saldimit nese miratohet. Te perdoren bashkuesit me nje rezistence qe eshte te pakten 125 % e rezistences se kerkuar te krijuar te çelikut perforcues. Te mos tejkalojet shiriti total i shufres perforcuese prej 0.25 milimetra brenda mbeshtjelleses se bashkimit kur ngarkohet ne tension deri ne 207 megapaskal dhe çlirohet ne 20 megapaskal per madhesine e shufrave deri ne nr. 43, te matura plotesisht mes pikave te mases se mbeshtjelleses se bashkimit.

Nese struktura e telave te salduar transportohet ne rrotulla, te drejtohen ne tabake te sheshte perpara vendosjes. Te bashkohen tabaket e rrjetes ose perforcimi i qilimit me shufra duke e mbivendosur jo me pak se 1 gjeresi rrjete plus 50 mm. Te mberthehen mire ne fund dhe skajet.

## 1.9 Pranimi

Çeliku perforcues dhe materiali epoks i veshjes do te vleresohen sipas nenseksioneve specifikimeve perkatese. Te sigurohet nje certifikate prodhimi me çdo dergese te çelikut perforcues. Vendorsja e çelikut perforcues do te vleresohet sipas specifikimeve perkatese.

## 1.10 Pagesa

Sasite e pranuar do te paguhen me çmimin e kontrates per njesi matese per artikujt me pagese te listuara ne listen e ofertes. Pagesa do te jete kompensim i plote per punen e pershkruar ne kete Seksion.


## DRENAZHET

### 1.1 Tubat HDPE te brinjezuar

Tubat e valëzuar me dy mure HDPE kanë një mur të brendshëm me sipërfaqe të lëmuar të rrethuar nga një mur i jashtëm i brinjezuar (me ngjyrë të zezë). Muri i jashtëm i valëzuar siguron forcë optimale nën ngarkimin në shtypje që kanë shtresat dhe trafiku. Ngjyra e verdhë e ndritshme e tubit të brendshëm gjithashtu përmirëson dukshmërinë në inspektimin me kamer, duke siguruar kushte optimale për testimin e kolaudimit.

#### Materiali dhe permasat

Parametri	Njesia	Vlera	Standarti
Dendesia	g/cm <sup>3</sup>	0.95 – 0.96	ISO1183
Rezistenca	Mpa	22-27	ISO1183
Moduli i elasticitetit	Mpa	>900	ISO527-2/1B/50,TS1398



DN/OD	ID	H	e <sub>5</sub>	e <sub>4</sub>	P	L1	L2
DN300 SN8	275	20	1.9	3.8	34.5	26	8.5
DN400 SN8	348	26	2.2	4.9	40.6	30.1	10.5
DN500 SN8	432	34	2.3	5.2	52	39	13
DN630 SN8	550	42	2.7	5.4	66	54	12
DN800 SN8	693	53.5	3	5.6	75	61	14
DN1000 SN8	860	70	3.3	7.6	105	86	19

### Bashkimet e Tubave


Për lidhje, fundi i tubit (mashkull) dhe pjesa e brendshme e bashkuesit (femra) duhet të pastrohen dhe pastaj guarnicioni duhet të vendoset në fund të tubit dhe pastaj të lubrifikohet me sapun ose materiale lubrifikuese. Pas kesaj lidhni fundin e tubit dhe shtyjeni tubin në pjesen e gotes. Duhet pasur kujdes që të sigurohet që guarnicioni të mos rrotullohet në tub, pasi nuk do të izoloje sic duhet bashkimin. Për të siguruar izolimin e duhur, duhet pasur kujdes që të pastroni guarnicionin dhe goten. Në mungesë të kujdesit të duhur, forma e valëzuar e tubit do të tërheqë materialet e kanalit te germuar në gote.

1. Pastroni sipërfaqen e tubacionit
2. Vendosni guarnicionin (unazen prej gome)
3. Vendosni lubrifikant
4. Bashkoni tubacionet
5. Shtyni tubacionin ne pozicion

### Mbushja e trasese pas vendosjes se tubit

- Mbushja e sipërme: Material i germuar me pare
- Mbushja mbi shtratin e tubacionit: Material pa gure te medhenj, zakonisht rere e trashe
- Mbushja e shtratit te tubacionit: Rere
- Ho: Distanca midis sipërfaqes se tokes dhe pjeses se sipërme te shtratit
- b: Gjerësia e kanalit (mm).
- Y: Lartësia e mbushjes se shtratit (mm).
- DN: Diametri i tubacionit (mm).
- Ho duhet te jete minimalisht 50 cm.





### Magazinimi dhe menaxhimi i tubacioneve te brinjezuar HDPE

Sheshi i magazinimit duhet të jetë e rrafshët. Terreni mund të jetë artificial ose i mbuluar me asfalt, rërë ose bar. Vini re se tubat janë bërë nga polietileni me densitet të lartë dhe prania e gurëve të mprehtë nën tuba do të shkaktojë vrima ose deformim të tubave në atë pikë. Përveç kësaj, depozitimi i tubave në zona të thyera do të shkaktojë deformim të tubave në pika të ndryshme. Këshillohet të vendosni tre paleta plastike nën tuba dhe të shmangni kontaktin e drejtpërdrejtë midis tubave dhe tokës.

Ato duhet të vendosen nën hije për t'u mbajtur larg rrezeve të diellit. Në përgjithësi, është më mirë të mbash tubat në hapësirë të mbuluar për t'i mbrojtur ata nga rrezet e diellit, dhe nëse i mban në hapësirë të hapur, tubat duhet të mbuloen me mbulesa anti-UV.

Nëse temperatura është më shumë se 25 ° C, tubat do të bymehen. Prandaj, në rastet kur temperatura e ajrit është më shumë se 25 ° C ose koha e magazinimit është më e gjatë se 24 orë, ka nevojë për kujdes shtesë në ruajtjen dhe mbajtjen e tubave në kushte më të mira sipas standarteve te rekomanduara.

Në vendosjen e tubave në trase, është e nevojshme t'i levizni ato duke përdorur pajisje të përshtatshme me ngadale dhe jo duke i hethur me vrazhdesi brenda kanalit. Sigurohuni që tubi të mos bjerë në buzë kur mbani brenda kanalit, sepse pesha e tubit shkakton deformim në buzë dhe e bën të vështirë lidhjen e tubave.

## 1.2 Tubat dhe Rakorderite PVC


### Materiali dhe permasat

PVC-U (Polyvinylchloride, i paplastifikuar)

Tubat: DIN EN 13476-2, rakorderites: DIN EN 1401

Diametrat nominale DN/OD

110, 125, 200, 250



DN/OD	s(mm)	D(mm)	t(mm)
110 SN8	3.2	127	66
200 SN8	5.9	225	106
250 SN8	7.3	287	128

### Instalimi

DIN EN 1610, DIN EN 476, DIN 1986-100

### Izolimi

Guarnicion SBR i fabrikes sipas DIN 681 per te gjitha tubacionet dhe rakorderite.

### Magazinimi dhe menaxhimi

Tubave duhet t'u jepet mbështetja e duhur në çdo kohë. Tubat duhet të grumbullohen në shtresa me bazat e vendosura në skajet e kunderta të pargut të tubave dhe me gotat të dalja jashtë mbështetjeve.

Mbështetësit horizontale me gjerësi rreth 75 mm duhet të jenë të vendosur jo më shumë se 1.5 m nga qendra në qendër nën tuba për të siguruar mbështetje të barabartë.

Mbështetësit anësorë vertikalë duhet të sigurohen gjithashtu në intervale prej 3 m përgjatë pargjeve të tubave.

Për ruajtje afatgjatë (më shumë se 3 muaj) lartësia maksimale e pargut nuk duhet të kalojë 1.5 m. Tubat më të rëndë duhet të jenë në pjesën e poshtme.

Nëse planifikohet të ruhen tubat në rrezet e diellit për një periudhë më të gjatë se një vit, atëherë tubat duhet të mbulojnë me material të tillë si pelhure (cope) hessian, të vendosur në mënyrë që të mos kufizojnë qarkullimin e ajrit në tuba i cili ka një efekt ftohës. Mbulesa të tilla si plastika e zezë nuk duhet të përdoren pasi këto mund të rrisin shumë temperaturat brenda pargut.

Tubat nuk duhet të ruhen afër burimeve të nxehtësisë ose objekteve të nxehta, p.sh., ngrohësve, kaldajave linjave të avullit ose shkarkimit të motorit, ose kundër gardheve metalikë reflektues që mund të përqendrojnë nxehtësinë.

Tubat nuk duhet të hidhen nga kamionët ose të zvarriten mbi sipërfaqe të ashpra. Tubacionet plastike bëhen më të ndjeshëm ndaj dëmtimeve në një mot shumë të ftohtë, kështu që duhet të tregohet kujdes shtesë kur temperatura është e ulët.

Meqenëse fortësia e çdo njeje tubi varet nga gjendja e gotes dhe fundit të tubacionit, duhet të tregohet kujdes i veçantë për të mos lejuar që ata të bien në kontakt me skaje të mprehta ose sipërfaqe të forta.

### 1.3 Specifikime të tjera për tubat

Tubat duhet të vendosen në një shtrat rëre pa gurë në përputhje me rekomandimet e prodhimit. Të gjitha mbeturinat e argjilës dhe baltes 30 cm nën themelin e tubave duhet të zëvendësohen.

Rëra jo kohezive mesatare dhe e trashë duhet të vendoset në të gjitha anët me një lartësi minimale prej 100 mm. Diametri duhet të jetë nga deri në 4 mm. Lakorja e gradimit duhet të jetë në përputhje me EN 1610.

Kanalet duhet të gërmohen në mënyrë që të instalohen tubat në thellësinë e kërkuar.

Pozicionet e të gjitha tubave duhet të vëzhgohen, nivelohen dhe shënohen menjëherë pas vendosjes.

Një shirit paralajmërues nëntokësor duhet të vendoset 30 deri 50 cm mbi të gjitha tubat.

### 1.4 Pusetat beton arme

Pusetat duhet të jenë të papërshkueshme nga uji për çfarëdo lloj forme ndërtimi që do të zgjidhet.

Betoni duhet të jetë C 30/37 me një përqindje të armaturës sipas llogaritjes strukturore.

Pusetat duhet të bazohen në një shtresë betoni të dobët C 12/15 me një trashësi minimale 10 cm.

Pusetat jo standarde duhet të jenë të pajisura me prej gize, të veshura me polietileni, të paktën 15 mm të trasha, jo më pak se 400 mm në gjerësi, dhe të vendosura 300 mm midis njera tjetres.

Lartësia (h) e pusetes varet nga niveli i tubave në hyrje / dalje sipas vizatimeve. Numri dhe pozicioni i tubave hyrës / dalës është dhënë gjithashtu në vizatime.

Tubat duhet të lidhen në mënyrë të papërshkueshme papërshkueshëm nga uji me pusetat.

Kapaku i pusetave duhet të jetë së paku me një diametër të hapur 60.0 cm.

Kapakët duhet të jenë me ajrosje dhe klasa e ngarkesës C250 sipas EN 124

Korniza dhe zgara duhet të jenë prej gize dhe të klasës së ngarkesës C250 sipas EN 124.

Zgara duhet të jetë me një model "të sigurt për biçikletat".

Zgara duhet të jete e lemuar në skajet për të parandaluar dëmtimin e gomave.

## 1.5 Tombinot Rrethore

Kjo lloj pune konsiston ne ndertimin dhe riparimin e tombinove dhe te tubave te kullimit te ujrave ne perputhje me gradat dhe dimensionet e tregura ne vizatimet ose te kerkuara nga Mbikeqyresit e Punimeve.

Materiali, Tubat

Tubat duhet te jene sipas kerkesave te standarteve kombetare ose nese s’ka, ato te ASHTO M86 ose M200.

Çimentoja, rera dhe uji duhet te jene ne perputhje me kerkesat e specifikuara me siperMe perjashtim te rastit kur lejohet nga Mbikeqyresit e Punimeve, Sipermarresi nuk duhet te porosise apo te sjelle tubat per çdo lloj pune derisa nje liste korrekte e madhesive dhe gjatesise jane aprovuar nga Mbikeqyresit e Punimeve.

Mbikëqyresit e Punimeve rezervon te drejten te inspektoje dhe nalizojë tubat mbas dorezimit per punime. Defekte te demshme te zbuluara mbas pranimit te tubave dhe para instalimit te tyre do te behen shkak per refuzim.

Materiali, Rera

Me qellim qe te realizohet nje shtrat solid, rera do te perdoret si mbushje granulare.

Rera e kerkuar do te kete nje kurbe granulare si:

10mm	100%
5mm	60-100%
1mm	40-90%
0.3mm	15-50%
0.075mm	2-15%

## 1.6 Ndertimi

**Germimi**

Kanali duhet te germohet ne thellesine dhe graden e dhene nga Mbikeqyresit e Punimeve. Nje shtrat me mbushje granulare prej 100 mm trashesi (rere) do te shperndahet dhe ngjeshet siç kerkohet nga Mbikeqyresit e Punimeve ne jo me pak se 95% Proktor, normal.

**Shtresezimi**

Tubi duhet te mbeshtet fort ne shtrat me kambanen siper dhe ekstremet te futura plotesisht ne kambanat ngjitur.

Hapja-kambane qe mbetet do te mbyllet me llaç per te mos rrjedhur ujrat dhe per te sigurur centrimin e tubave.

### **Mbulimi**

Mbasi tubi eshte vendosur dhe kontrollar nga Mbikeqyresit e Punimeve, rera do te merret per shtratin ne nivel jo me te ulet se rrezja qe formon 30 grade me diametrin horizontal te tubit.

Mbi kete nivel materiale te zakonshme per ndertim rruge mund te perdoren ne perputhje me thellesine aktuale nen siperfaqen perfundimtare.

### **Betonimi**

Betonimi i tombinove rrethore prej betoni do te realizohet per pjesen e ulet te tubit duke perdorur forma te thjeshta. Per pjesen e siperme do te perdoren forma speciale me leshim te shpejte. Gjithashtu mund te perdoren per betonim edhe forma pneumatike. Kur perdoren tuba çeliku per te cilat kerkesat e mesiperme jane aplikuar gjithashtu, ato duhet te jene nga nje fabrike e specializuar me nje diameter uniform dhe me trashesi ne perputhje me udhezimet e Inxhinierit. Ato duhen trajtuar dhe punimi duhet te jete perfekt, pa plasaritje me forme te persosur ne ekstremitete, per te siguruar nje lidhje te pakalueshme nga uji. Normalisht tubat do te instalohen ne vije te drejte dhe ne nivelin e percaktuar dhe mbi nje jastek betoni te varfer me trashesine e percaktuar nga Inxhinieri. Ato gjithashtu do te rrethohen me llaç betoni sipas perpjestimeve te kerkuara dhe konfigurimin e paraqitur ne vizatimet e projektit, pas nje ngjitjeje perfekte te fugave me llaç çimento.

## PUNIMET E KANALIZIMEVE TE UJERAVE TE BARDHA

### 1.1 Te Pergjithshme

Largimi u ujrave sipërfaqësor (shiut) nga trupi i rruges do të realizohet nepermjet nje rrjeti tubash dhe pusetash deri ne shkarkime ne kanalet e drenazhit pergjate rruges ose ne kanale kullimi ekzistues. Tubat qe do te perdoren do te jene HDPE te brinjezuar me diametra te ndryshem sipas projektit. Pusetat do te jene puseta betoni me kapak gize te plote ose ne forme zgare. Detajet dhe permasat e tuabacioneve dhe pusetave jepen ne fletet perkatese te vizatimit

### 1.2 Materiali

Tubat PE-HD me mure dopio te brinjezuar nga ana e jashtme dhe te sheshte nga ana e brendshme jane sipas EN 13476-1, Tubat do te prodhohen me material PE 80/100 ( $E > 1000 \text{ N/mm}^2$ ).

Klasa e fortesise se unazave do te jete minimum SN 8, aplikim i ngarkese te vazhdueshme per 24 ore sipas DIN EN ISO 9969. Megjithate prodhuesi i tubave do te siguroje llogaritjet strukturore qe do ti nenshtrohen aprovimit te Inxhinierit. Tubat qe do te perdoren do te jene me ngjyre te zeze nga jashte dhe me te verdhe nga brenda.

Prodhimi i tubave do te kontrollohet nga nje laborator. Certifikata e prodhimit duhet te mbuloje testet e kerkuara nga EN 13476-1. Certifikatat e prodhimit te tubave te furnizuara do ti nenshtrohen aprovimit nga Inxhinieri. Zonat ku do te behen bashkimet duhet te jene te pastra dhe te thata. Bashkuesit do te jene sipas EN 13476. Ato do te lejojne futjen e te pakten 2-3 unazave ne anen tjetere. Bashkuesit do te futen duke perdorur nivelues ose duke i shtyre pergjate aksit te tubit. Perdorimi i cekiceve apo pajisjeve te njejta nuk lejojet.

### 1.3 Shtrimi ne kanal i tubacioneve

Ne pergjithesi, tubacionet shtrohen ne kanale, ne varesi te kushteve klimatike dhe te tokes ne nje thellesi e cila jepet ne projekt (Ne profilin gjatesor dhe terthor)

Karakteristikat gjeologjike te tokes dhe ngarkesa e trafikut ndikojne ne dimensioned e kanalit te tubit dhe ndikojne gjithashtu ne kapacitetin e ngarkeses qe mban tubi vete.

Gjeresia e tabanit te kanalit, kushtezohet nga diametri i jashtem i tubacionit si dhe nga domosdoshmeria e krijimit te nje hapësire pune te nevojshme (hapësira minimale e punes). Duke ju permbajtur te dhenave te siperpermendura te thellesise h dhe gjeresise b, fundi i gropes duhet te krijojte kushtet optimale, qe linja te mbeshetet ne te gjithe gjatesine e saj

Tabani i kanalit nuk duhet te jete i shkriftezuar. Nese ky taban eshte i shkriftezuar, atehere duhet qe perpara vendosjes, ai te sheshohet.

Ne zonat shkembore duhet qe fundi i kanalizimit te ngrihet te pakten 0.15 m dhe sipërfaqja te mbulohet me nje shtrese granili te ngjeshur ose betoni te varfer.

Thellesia minimale e shtrimit zakonisht diktohet nga intersektimet me tubacionet komunale ekzistuese (te ujit te rrjetit Elektrik, telefonik, te ujrave te shiut etj). Ne rruget me trafik te rende nuk rekomandohet

qe tubat te shtrohen me mbulim me te vogel se 0.7 m mbi kreun e tubit. Ne raste kur kjo shtrese rezulton domosdomosdoshmerisht me e vogel mund te propozohet nje veshje me beton. Thellesia e lejuar e hapjes se seksionit te kanalit jepet ne projekt.

Duhet bere kujdes qe fundi i kanalit ku do te shtrohen tubat te jete i rrafshet, pa gure dhe mjaft i forte. Ne qofte se ne germimin me eskavator kjo nuk sigurohet, atehere 20 cm-at e fundit duhen germuar me krah.

Kerkesat e me poshtme jane baze dhe duhen marre parasysh ne shtrimin e tubave PE ne perputhje me standartet;

- perdorimi i nje stafi te specializuar
- pajisja e mjaftueshme me mjete adekuate shtresuese
- mbikqyrje e vazhdueshme
- perpilimi i dokumentacionit teknik/azhornimi

Keto jane kerkesa baze qe tubacioni i instaluar te funksionoj ne menyre perfekte per aq kohe sa eshte parashikuar.

Duhet te tregohet kujdes gjate dorezimit, transportit dhe shtrimit te tubave dhe aksesoreve te tyre per ti mbrojtur nga thyerjet dhe demtime te tjera te tubave. Tubat do te dorezohen ne menyre te tille qe te mos kene demtime tek fundet e makinave. Tubat e demtuara qe nuk mund te riparohen sipas kenaqesise se Inxhineirit do te zevendesohen me shpenzimet e Kontraktorit. Mjetet e perdoruara per transportin e tubave duhet te jene te pajisura me pjese mbrojtese per levizjen e tubave apo demtimin e tyre apo veshjes se tyre. Tubat duhet te sigurohen shume mire ne mjet per te ndenjur stabel dhe te sigurt. Te gjitha pjeset e mjetit, kabllot, shtrenguesit qe jane ne kontakt me tubat do te jene te veshur. Ngarkimi do te behet me vinc apo mjete te tjera te pertatshme duke perdorur rreshqitese apo mjete te aprovuara me pare me qellim qete sigurohet ulje e bute dhe me kujdes e cdo tubi. Tubat nuk duhet te jene te gripuara. Tubat nuk duhet te hidhen mbi toke ose mbi tuba te tjere. Kur ngritja apo ulja e tubave behet me vinc apo rreshqites, cdo tub duhet te mbahet nen kontroll kur bie per ta mbrojtur nga goditjet me pajisjet apo objekte te tjera qe demtojne tubin ose veshjen e tij. Tubat nuk duhet te levizen me rrotullim apo rreshqitje mbi toke. Por te ngrihen dhe te vendosen me kujdes ne pozicionin e ri. Cdo tub i vendosur mbi toke duhet te jete i bllokuar per tu mbrojtur nga rrotullimi. Valvolat dhe hidrantet do te mbahen dhe magazinohen perpara instalimit ne nje menyre te aprovuar nga Inxhinieri. Tubat do te jene te lidhur nga anet e kanalit kundrejt pilave te materialeve te germuar dhe vendit ne toke pergjate kanalit ne menyre qe te mos interferoj me progresin normal te puneve. Kontraktori do te siguroje qe tubat te mos bllokohen apo interferojne trafikun normal dhe aktivitetet normale si dhe te gjejne aprovimin e autoriteteve te rrugeve ne kuptimin qe tubat mund te zene pak vend shume afer pergjate rruges.

#### **1.4 Mjetet shtruese te tubacionit dhe perdorimi i sakte i tyre**

Kontraktori duhet te jete i paisur me mjetet e nevojshme per transportin, shtrimin, bashkimin dhe provat e nevojshme.

## 1.5 Instruksionet e montimit

Hapat qe duhet te aplikohen ne montimin e tubacioneve duhet te jene ne perputhje me instruksionin qe jep prodhuesi.

Kujdes I vecante duhet treguar ne lidhjen e tubacioneve me konstruksionin e pusetes me ane te vendosjes se nje waterstopi ne forme lente me ekspansion te larte ne kontaktin tub beton. Ky waterstop vendoset me mes te trashesise se murit te pusetes.

## 1.6 Testi Hidraulik

Ky test kryhet per tubacionet pjese pjese nga puseta ne pusete dhe per vete pusetat. Testi per tubacionet realizohet duke mbyllur me tapa hyrjen dhe daljen e tubit nga puseta ne pusete, mbushet me uje duke ushtruar nje presion prej 0.5 bar. Koha e mbajtjes nen presion minimum 30 minuta, gjate se ciles presioni duhet te mbetet constant me nje ulje te vogel per shkak te fleksibilitetit te tubacionit gje qe kerkon plotesimin me nje sasi te caktuar uji.

Ne rastet kur presioni bie do te thote se tubacioni ka rrjedhje dhe duhet te zbrazet, te identifikohet dhe te riparohet defekti. Me tej prova perseritet.

Testi per pusetat behet duke mbyllur me tapa tubacionin nga jashte ted y pusetave dhe sistemi mbushet me uje. Kjo gjendje mbahet mbi 45 minuta dhe prova konsiderohet e pranuar nese niveli I ujit ne puseta nuk bie mbi 5%.

## 1.7 Mbajtja, ruajtja dhe transportimi i tubave ne kantier

Tubat do te mbahen me kujdes gjate gjithe kohes se prodhimit, transportimit ne vendin e punes dhe instalimit. Çdo tub do te inspektohet ne menyre te kujdesshme sipas standarteve te kerkesave te specifikimit gjate dorezimit dhe perpara se te shtrohen.

Asnje tub i krisur, i thyer apo me difekt nuk do te perdoret ne veper. Demtimi i pjeses fundore te tubave qe sipas Mbikqyresit te Punimeve mund te shkaktoje lidhje difektoze, do te jete shkak i mjaftueshem per te hequr tubat e demtuar.

Tubat do te pastrohen plotesisht nga mbeturinat ne brendesi te tyre perpara se te instalohen dhe do te mbahen te paster ne pergjegjesine e Sipermarresit deri ne marrjen e dorezimit te punimeve. Te gjitha kontaktet siperfaqesore te bashkimevedo te mbahen te pastra deri sa te kete perfunduar bashkimi, Do te merren masa per ndalimin e futjes se materialeve te huaja ne brendesi te tubave gjate instalimit. Ne tuba nuk do te vendosen, mbetje, vegla pune, rroba ose materiale te tjera.

## 1.8 Germimi dhe mbushja e kanaleve

Germimi dhe mbushja e kanalit do te behen sic jane specifikuar ne seksionin (Punime Dheu) te ketyre specifikimeve teknike konform vizatimeve dhe shenimeve perkatese teknike te dhena ne fletet e vizatimeve.



Kujdes duhet treguar per mbushjet me material para dhe pas vendosjes se tubave. Dherat e parashikuar ne projekt mbi tub duhet te vendosen me shtresa jo me te madha se 30cm dhe te ngjishem me tokmak dore elektrik deri ne arritjen e vleres 95% te proctor.

## 1.9 Ndertimi i pusetave

Kontraktori do te ndertoje puseten ne pozicionet dhe dimensionet e treguara ne projektin e Kontrates, ose sic udhezohet nga Mbikqyresi i Punimeve.

Pusetat do te lejojne hyrje per te bere inspektimin dhe pastrimin e kanaleve dhe do te jene vendosur ne pika ku ka ndryshim te drejtimeve, ndryshime te madhesise se tubave, ndryshime te pernjehereshme te pjerresise dhe ne pikat ku jane parashikuar zgarat ujembledhese te ujerave te bardha.

Muret e pusetave do te ndertohen me beton dhe beton te armuar te klases sic eshte shkruar ne fletet e vizatimeve.

Gjate gjithë gjatesise se pusetes do te ndertohet nje kanal sipas aksit te tubacionit te kanalizimit per te percjelle ujerat nga nje tubacion kanalizimi tek tjetri pa nderprerje te prurjes.

Pasi hapet gropa e pusetes, toka duhet te pergatitet ne menyre qe te siguroje themele te pershtateshme. Per kete arsye toka poshte bazamentit te pusetes do te kompaktesohet. N.q.se toka ekzistuese nuk siguron nje bazament te pershtatshem atehere do te perdoret zhavorr dhe/ose beton C6/10.

Zona perreth pusetes nuk mund te mbushet menjehere pasi puna per mbushjen duhet te behet kur suvaja te jete perfunduar. Nqs puseta eshte ndertuar ne nje rruge te pambaruar korniza e hekurit dhe kapaku mbullues nuk duhet te vendosen ne pusete, ndersa nje pllake çeliku vendoset siper pusetes derisa rruga te perfundoje.

Zgarat do te vendosen ne nivelin dhe pjerresine perfundimtare te siperfaqes se rruges dhe te kunetes.

Kujdes I vecante duhet treguar ne lidhjen e tubacioneve me konstruksionin e pusetes me ane te vendosjes se nje waterstopi ne forme lente me ekspansion te larte ne kontaktin tub beton. Ky waterstop vendoset me mes te trashesise se murit te pusetes para betonimit te saj.

### 1.10 Zgarat ujembledhese

**Zgara mbi pusete** do te kete permasa ne plan 40 me 60cm. Materiali – Gize qe ploteson normen EN 124, hapsirat garantojne minimum 30 % te siperfaqes ne plan dhe duhet te perballojne nje ngarkese prej 250 KN. Gjersia minamale e hapesirave duhet te jete mbi 18mm dhe gjatesia nen 170mm

### 1.11 Derdhjet e ujerave

Vendndodhja dhe kuota e shkarkimit te ujerave do te jete siç tregohet ne vizatimet perkatese ose siç udhezohet nga Mbikqyresi i Punimeve.

### 1.12 Pershkrimi i çmimit njesi te tubave per kanalizimet

Kostoja e germimit, mbulimit dhe transportit te tubave jane perfshire ne pershkrimin e çmimeve njesi qe lidhen me keto punime.

Furnizim i tubacioneve te te gjitha diametrave, mbajtja, shtrirja, furnizimi i te gjitha materialeve te nevojshme, veglave, paisjeve te kerkuara per shtrimin e tubave, fuqia punetore, pershtatesit, bashkuesit, izoluesit, prova e tubave, sigurimi dhe instalimi i shiritave me ngjyre, sheshimi i siperfaqes, hekuri dhe armimi i tubave dhe te gjitha aktiviteteteve siç pershkruhen me siper jane perfshire ne çmimin njesi per nje meter tubacion kanalizimesh.

Matja: Linja e qendres se tubave brinjezuar do te matet ne meter linear nga faqja e brendeshme e pusetes ne faqen e brendeshme te pusetes pasuese pergjate aksit te tubit.

### 1.13 Pershkrimi i çmimit njesi per pusetat

Koston e germimeve, mbulimit, dhe transportit te inerteve, çimentos dhe hekurit e armimit, jane mbuluar ne çmimet qe lidhen me keto zera punimesh, prandaj, nuk perfshihen ne çmimin njesi per pusetat. Çmimi njesi per pusetat perfshin furnizimin e çimentos, inerteve, ujit, armimit shtratimit, aramturat, forcimi i bazamentit te pusetes, lidhja e tubacionit pjeset lidhese per lidhjen me hyrjet ne rruge, suvatimi i bashkueseve me llaç çimento, perzierja dhe hedhja e betonit, bankinat, furnizimi dhe instalimi i mbulesave te pusetave dhe sheshimi i siperfaqes perreth, ngritja e materialeve .

## PUNIMET PER RRJETIN E FURNIZIMIT ME UJE

### 1.1 Te pergjithshme

Gjate punimeve te zbatimit per ndertimin e rruges do te preket (prishet) rrjeti i furnizimit me uje te disa zonave te banuara pergjate gjurmes se rruges. Te gjithë tubat dhe lidhjet qe do te demtohen gjate punimeve do te ribehen duke e lene rrjetin e furnizimit me uje ne gjendjen e meparshme. Tubat dhe rakorderite qe do te perdoren do te jene tuba PE sipas standarteve europiane EN12201-1 dhe EN12201-2. Ne baze te planit te rrjetit ekzistues te ujesjellesit te vene ne dispozicion nga bashkia Tirane ku do evidentohen te gjithë tubat qe preken nga ndertimi i rruges. Tipat e tubave qe preken jane HDPE, PE dhe tuba Celiku.

Tubat do te furnizohen ne komplet se bashku me bashkuesit dhe shtesa te tjera te nevojshme.

Kanalet e tubacioneve, shtratimi dhe mbulimi jane pershkruar ne kapitujt e tjere.

Perveçse modifikuar ose shtuar si ketu, te gjitha tubat Polietilenit do te plotesojne standartet kombetare dhe nderkombetare.

Çdo tub duhet te kete te shenuar ne te ne menyre permanente te dhenat me poshte:

Daten e prodhimit.

Emrin e prodhuesit.

Shenimi duhet te jete i trupezuar ne tub ose i shkruar me boje rezistente ndaj ujit.

### 1.2 Shtrimi ne kanal

Ne pergjithesi, tubacionet e Polietilenit shtrohen ne kanale, ne varesi te kushteve klimatike dhe te tokes ne nje thellesi e cila jepet ne projekt (ne profilin gjatesor dhe terthor).

Karakteristikat gjellogjike te tokes dhe ngarkesa e trafikut ndikojne ne dimensionet e kanalit te tubit dhe ndikojne gjithashtu ne kapacitetin e ngarkeses qe mban tubi.

Gjeresia e tabanit te kanalit, kushtezohet nga diametri i jashtem i tubacionit si dhe nga domosdoshmeria e krijimit te nje hapësire pune te dystuar (hapësira minimale e punes). Duke ju permbajtur te dhenave te siperpermendura te gjatesise dhe gjeresise, fundi duhet te krijojë kushtet optimale, qe linja te mbivendoset ne te gjithë gjatesine e saj. Mbishtresezimet duhet te ndahen mundesisht ne menyre te barabarte, duke eliminuar keshtu presionin e ushtruar prej tyre.

Tabani i kanalit nuk duhet te jete i shkriftezuar. Nese ky taban eshte i shkriftezuar, atehere duhet qe perpara vendosjes, ai te dystohet, shtypet ose te mbulohet me nje shtrese te posaçme. Edhe siperfaqet e shkriftezuar, por jo te forta duhet te ngjeshen.

Neqoftese kemi te bejme me siperfaqe shkembore ose gurore duhet qe fundi i kanalizimit te ngrihet te pakten 0.15 m dhe siperfaqja te mbulohet me nje shtrese pa gure rere (shih Projektin). Kesaj mund ti shtrohet rere, zhavor i imet ose toke e paster dhe masa e krijuar ngjeshet.

Thellesia minimale e shtrimit zakonisht diktohet nga intersektimet me tubacionet komunale ekzistuese (te ujit, te rrjetit Elektrik, telefonik, te ujrave te shiut etj). Ne rruget me trafik te rende nuk rekomandohet qe tubat te shtrohen me mbulim me te vogel se 1.0 m. Ne raste te tilla mund te propozohet nje veshje me beton.

Thellesia e lejuar e hapjes se seksionit te kanalit jepet ne projekt.

Duhet bere kujdes qe fundi i kanalit ku do te shtrohen tubat te jete i rrafshet, pa gure dhe mjaft i forte. Ne qofte se ne germimin me eskavator kjo nuk sigurohet, atehere 20 cm-at e fundit duhen germuar me krah.

Kerkesat e meposhtme jane baze dhe duhen marre parasysh nese duam te shtrijme tubat polieteleni ne perputhje me standartet;

- perdorimi i nje stafi te specializuar
- Pajisja e mjaftueshme me mjete, shtruese
- mbikqyrje e vazhdueshme
- pranim i rregullt deri ne testin e perfundimtar
- perpilimi i dokumentacionit teknik/azhurnimi

Vetem nese ka perputhje me keto kerkesa baze, tubacioni i instaluar do te funksionoje ne menyre perfekte, per aq kohe sa eshte parashikuar.

### 1.3 Mjete prerës

Per prerjen e tubave prej Polietileni disqe abrazive prerës jane pare si me te pershtatshmit.

Prerës me gur zmeril dhe flete sharre mund te perdoren.

### 1.4 Instruksionet e montimit

Hapat qe duhen bere perpara montimit:

Futni gominen brenda ne gote ne menyre te tille, qe pjesa e forte e gomines te qendroje e mbeshtetur ne menyre te qendrueshme. Shtypeni gominen mire derisa te bindeni qe eshte pershtatur plotesisht.

Vendosja e gomines mund te lehtesohet nepermjet shtypjes se saj ne dy pika dhe duke e shtypur me pas ne te dy anet. Kufiri i brendshem mbrojtës nuk duhet te dale nga pjesa mbrojtëse e gotes.

Kujdes ne transportimin dhe levizjen e tubave, sepse mund te shkaktohen plasaritje te padukshme.

Tubat prodhohen ne gjatesi 6.0 m (mund te behen edhe porosi te veçanta). Mund te priten kudo, midis bordurave, me sharra te zakonshme druri (dore ose mekanike, por jo me sharre zinxhir). Buza e prerjes pastrohët me lime druri ose vegla te tjera ferruese.

Shtrimi fillon nga pika me e ulet. Kupa eshte mire te vihet ne drejtimin ngjites (Siper). Buza e tubit dhe kupes duhen pastruar me kujdes. Mbas kesaj guarnicioni special gome vendoset ne thellimin e dyte

midis bordurave (numeruar nga buza e gypit). Duhet kontrolluar qe guarnicioni te kete zene vend mire ne thellim dhe te mos jete perdedhur.

Mbas kesaj siperfaqja e brendeshme e kupes lyhet me sapun, ose me lendet e tjera te zakonshme, mandej tubi shtyhet brenda kupes me veglat e zakonshme, derisa te takoje. Nuk duhet terhequr mbrapsht fundi i tubit.

### Testi Paraprak

Ky test kryhet para testit kryesor. Qellimi i testit paraprak, eshte te ndaloje ndonje ndryshim ne volumin brenda linjes, qe mund te shkaktohet nga presioni i brendshem, koha dhe temperatura, keshtu qe keto lexime qe do te merren menjehere ne testin kryesor pasues do te jape prova te qarta mbi saktesine e testit te seksionit.

Mbas uljes se presionit dhe aty ku eshte e nevojshme zbraza e tubacionit, eliminoni rrjedhjet ne lidhjet dhe korrigjoni ndryshimet ne pozicione.

Presioni i proves deri ne 10 Atm:	1.5 x 10
Presioni i proves mbi 10 Atm:	10 + 5 bar
Kohezgjatja e proves se presionit:	te pakten 12 ore

### Testi (prova) kryesore

Kjo prove ndjek menjehere proven paraprake.

Presioni proves deri:	1.5 x 10
Presioni i proves mbi 10 Atm:	10 + 5 bar
Kohezgjatja e proves:	per DN deri 150, 3 ore nga DN 200, 6 ore

## 1.5 Mbajtja dhe transportimi i tubave ne zone

Tubat e polietilenit do te mbahen me kujdes gjate gjithë kohes se prodhimit, transportimit ne vendin e punes dhe instalimit. Çdo tub do te inspektohet ne menyre te kujdesshme sipas standarteve te kerkesave te specifikimit gjate dorezimit dhe perpara se te shtrihen. Asnje tub i krisur, i thyer apo me difekt nuk do te perdoret ne veper. Demtimi i pjeses fundore te tubave qe sipas Mbikeqyresit te Punimeve mund te shkaktoje lidhje difektoze, do te jete shkak i mjaftueshem per te hequr tubat e demtuar.

Tubat do te pastrohen plotesisht nga mbeturinat me brendesi perpara se te instalohen dhe do te mbahen te paster ne pergjegjesine e Sipermarresit deri ne marrjen ne dorezim te punimeve. Te gjitha kontaktet siperfaqesore te bashkimeve do te mbahen te pastra deri sa te kete perfunduar bashkimi. Do te merren masa per ndalimin e futjes se materialeve te huaja ne brendesi te tubave gjate instalimit. Ne tuba nuk do te vendosen, mbetje, vegla pune, rroba ose materiale te tjera.

## 1.6 Germimi dhe mbushja

Germimi dhe mbushja e instalimeve të ujesjellesit do të jenë siç janë specifikuar në Kapitullin 2 (Germimet) dhe Kapitullin 3 (Mbushjet dhe Mbulimet) të ketyre specifikimeve teknike.

## 1.7 Ndertimi i pusetave

Sipërmarresit do të ndërtojnë pusetat në pozicionet dhe dimensionet e treguara në projektin e Kontrates, ose siç udhëzohet nga Mbiqyrtuesi i Punimeve.

Pusetat do të lejojnë hyrje për të bërë inspektimin dhe pastrimin e kanaleve dhe do të jenë vendosur në pika ku ka ndryshim të drejtimit, ndryshime të madhësisë së tubave, ndryshime të përnjehershme të përrësive.

Muret e pusetave do të ndërtohen me beton të markës M 200, siç tregohet në vizatimet.

Pasi hapet gropa e pusetes, toka duhet të përgatitet në mënyrë që të sigurojë themele të përshtatshme. Për këtë arsye toka pashe bazamentit të pusetes do të kompaktësohet. N.q.s toka ekzistuese nuk siguron një bazament të përshtatshëm atëherë do të përdoret zhavorr dhe/ose beton M – 100.

N.q.s puseta është ndërtuar në një rrugë të pambaruar korniza e hekurit dhe kapaku mbulues nuk vendosen në pusete, ndërsa një pllakë çeliku vendoset sipër pusetes derisa rruga të asfaltohet.

Kapakët e pusetave në rrugë do të jenë prej gize. Kapakët dhe kornizat do të parashikohen sipas hapësirës drite të pusetes siç është treguar në vizatime.

Kapakët do të vendosen në nivelin dhe përrësive përfundimtare të sipërfaqes së rrugës, në rruget me asfalt, 20 mm më lart në rruget e shtruara me makadam dhe 50 mm më lart në rruget e pashtuara. Në sipërfaqet e hapura dhe fushat kapaku do të jetë 500 mm mbi zonën rrethuese, ose siç përcaktohet nga vizatimet ose udhëzimet e Mbiqyrtuesit të Punimeve.

## 1.8 Përshkrimi i çmimit njësi të tubave për ujesjellesin

Kosto e germimit, mbulimit dhe transportit të tubave janë përfshirë në përshkrimin e çmimeve njësi që lidhen me këto punime.

Furnizimi i tubacioneve të të gjitha diametrave, mbajtja, shtrirja, furnizimi i të gjitha materialeve të nevojshme, veglave, pajisjeve të kerkuara për shtrimin e tubave, fuqia punëtore, përshtatësit, bashkuesit, izoluesit, prova e tubave, sigurimi dhe instalimi i shiritave me ngjyrë, sheshimi i sipërfaqes, hekuri dhe armimi i tubave dhe të gjitha aktivitetet siç përshkruhen me sipër janë përfshirë në çmimin njësi për një meter tubacion.

Matja: Linja e qendrës së tubave PE do të matet në meter linear nga faqja e brendshme e pusetes në faqen e brendshme të pusetes pasuese përgjatë aksit të tubit.

## 1.9 Çmimi njesi per pusetat

Koston e germimeve, mbulimit, dhe transportit te inerteve, çimentos dhe hekurit e armimit, jane mbuluar ne çmimet qe lidhen me keto zera punimesh, prandaj, nuk perfshihen ne çmimin njesi per pusetat.

Çmimi njesi per pusetat perfshin furnizimin e çimentos, inerteve, ujit, armimit te shtratit, aramaturat, forcimi i bazamentit te pusetes, lidhja e tubacionit pjeset lidhese per lidhjen me hyrjet ne rruge, perzierja dhe hedhja e betonit, furnizimi dhe instalimi i mbulesave te pusetave dhe sheshimi i siperfaqes perreth, ngritja e materialeve duke perfshire, por jo kufizuar furnizimin e te gjitha materialeve, paisjeve, veglave dhe fuqise punetore, si dhe, ngarkimin, transportin dhe shkarkimin e mbulesave te pusetave.

Matja: Matjet do te bazohen ne numrin e pusetave te ndertuara. Thellesia eshte distanca vertikale ndermjet nivelit te tokes dhe kuotes se projektit.

## 1.10Pershkrimi i çmimit njesi per pusetat

### Prodhimi

Polietilenet jane prodhuar nga proçese te ndryshme dhe jane miksuar (bashkuar) me antloksidante, pigmente dhe stabilizatore LW per te bere te mundur qe materiali te jete i qendrueshem per perdorim ne industrine e ujit. Krahas faktoreve te tjere, nivelet dhe sasite e molekulave te perdorura mund te rezultojne ne qendrueshmerine e disa cilesive baze, si p.sh, koeficienti i ferkimit, densiteti, rezistenca e ferkimit etj,

Perberja e rezultuar, normalisht shperndahet ne prodhim: ne formen e granuliteve dhe tubat PE prodhohen nga nje proçes shkrires (ekstuziv) .

Gjate proçesit te prodhimit tubi duhet te markohet (kodohet) me produktin perkates dhe procesin informativ perafersisht ne intervale 1 m per çdo gjatesi te tubit.

Marketimet duhet te shkruhen mbi tub sipas ngjyrave te meposhtme:

PE 80	SDR 1.1	BLU E ERRET
	SDR 17.6	E KUQE
PE 100	SDR 11	I ZI
	SDR 17.6	I KUQ
	SDR 26	I VERDHE
	SDR 33	PORTOKALLI

---

## Kontrolli I Cilesise Se Prodhimit

Prodhimi i tubave PE eshte nje proces i vazhdueshem, nevojat e te cilit kushtezojne dhe perfeksionojne kontrollin, si te materialeve, ashtu edhe te fabrikimit te tyre per te arritur cilesine e kerkuar. Nje shkalle e kontrollit cilesor e testeve te pershkruara sipas standarteve perkatese, duhet te zbatohet brenda qellimit te nje sistemi te sigurimit cilesor ne perputhje me standartet e kerkuara.

### 1.11 Normalisht, Keto Proçedura Kontrolli Perfshijne:

Testimin e cilesive te materialeve per prodhim, si p.sh perberja baze,

Kontrollin mbi uniformitetin dhe qendrueshmerine e granuliteve,

Kontrollin e parametrave te prodhimit ne lidhje me Temperatures, presionin, shkallen e qarkullimit, shpejtesine e terheqjes dhe kapacitetin e energjise.

Inspektimi vizual i tubave, per te kontrolluar pamjen e pergjithshme, perputhjen dimensionale dhe ndonje tregues shtese ose gabime te bera gjate prodhimit te tubave dhe lidhjet e tyre tek fundet.

Testime afatshkurtra te prodhimit, per te identifikuar ndonje devijim gjate procesit te fabrikimit gjate prodhimit.

Testimet esenciale afatshkurtra te kontrolleve cilesore perfshijne si me poshte:

- Kushtet e pamjes dhe te siperfaqes
- Dimensionet
- Stabilitetin termik
- Gjatesine ne thyerje
- Presionin hidrostatik deri ne 80° C
- Testin e shkurter te trysnise.
- Efektin ne cilesine e ujit
- Rezistencen ndaj motit
- Testim afatgjate te presionit hidrostatik
- Rezistence ndaj çarjeve te kryera nga ushtrimi i forcave
- Fuqia e tensionit, te tubit dhe lidhjeve ne skaje.

---

## Saldimet E Tubave Te Polietilenit

Keto specifikime jepen per te studiuar lidhjet e mundeshme qe perdoren ne tubacionet PE qe perfshijne bashkimin me shkrirje, elektrofuzionin dhe bashkimet mekanike.



---

### Llojet E Bashkimeve

Avantazhet e sistemeve per te integruar dhe rezistente ndaj ngarkesave zakonisht arrihen duke bere bashkime ekonomike duke perdorur teknikat e bashkimit me fuzion. Bashkimi e buzeve aplikohet zakonisht megjithese elektrofuzioni mund te preferohet aty ku bashkimi me shkrirje eshte jopraktik per shkak te mungeses se hapesires.

Procedura e sakte per te bashkuar materiale jo te njejta per mure me trashesi te njejte. Vetem materiale te ngjashme dhe me trashesi muri te perafert duhet te bashkohen ne shkrirje. Duhet te shikohen udhezimet para se te provohet bashkimi i materialeve me shkalle te ndryshme trysnie ose me diameter te ndryshem.

---

### Trajnim Per Bashkimin Me Fuzion

Megjithese parimet e bashkimit me fuzion jane relativisht te thjeshta duhet treguar kujdes ne praktike per te ruajtur integritetin e sistemit PE me ane te udhezimeve te duhura dhe duke monitoruar rrjetin.

Rekomandohet fuqishem qe te behet trajnim ne nivelin e punetoreve dhe te supervizoreve te punimeve duke perdorur ose kurset e ofruara nga investitori ose duke bere trajnime nga kompania te ndjekur nga disa praktika ne rrjet nen vezhgimin e specialitetit.

Trajnimi i saldimit me shkrirje dhe eletrofuzion ka tre elemente kryesore:

- Lidhjen e sistemeve te tubacioneve MDPE me metoden e fuzionit
- Bashkimin e sistemeve te tubacioneve MDPE me lidhje fuzioni
- Mbjajtjen e nje mjedisi te sigurte pune dhe e higjenes ne sistemet e ujit

---

### Pajisjet Dhe Makinerite E Fuzionit

Pajisjet dhe makinerite e fuzionit mund te blihen ose te merren nga disa agjensi. Zakonisht bihet dakord me pronaret per kontrata periodike te mirembajtjes dhe sherbimet plus qe mund te ofroje kompania duhet te merren parasysh para blerjes. Te gjitha prodhuesit me reputacion ofrojne literature te kuptueshme dhe te mjaftueshme mbi produktet dhe perdorimin e tyre te cilat duhet te studiohen para se pajisja te vihete ne perdorim.

Disa pika kyçe qe duhet te fiksohen per perdorimin dhe mirembajtjen e ketyre pajisjeve pershkruhen si me poshte vijon:

Siperfaqet e nxehta qe do te saldohen duhet te jene te pastra qe te sigurojne nje pershkushmeri te mire te nxehtesise dhe per ti paraprire ndotjes se siperfaqes se saldimit. Çdo papasterti ne siperfaqe duhet te hiqet me kujdes kur pjata eshte e ftohte duke perdorur nje shpatull druri te bute ose/dhe nje pllake etermiti e zhytur me pare ne nje solvent te pershtatshme si izo-propanol, teknikat e mbrojtjes dhe rinovimit jane te gatshme nga furnizuesit. Eshte esenciale kontrolli i pavarur i nxehtesise ne siperfaqe.

Pajisje lemuese kerkohen per te pergatitur siperfaqet e bashkimit te tubave para nxehtesise se tyre dhe keto jane nje pjese perberese te makinave te bashkimit me shkrirje. Skajet e prera duhet te mbahen te pastra dhe ne gjendje te mprehte.

Shumica e pajisjeve te fuzionit perbehen nga alumini per shkak te karateristikave te tija te mira te sjelljes ndaj nxehtesise. Sidoqofte alumini eshte nje material relativisht i bute dhe peson lehte demtime nga

impaktet. Pjatat e nxehta duhet te vendosen ne cilindra te paster kur nuk perdoren. Zhvillimet me te fundit te makinave automatike per bashkim me shkrirje dhe pjata te nxehta qe mund te terhiqen lehte, mund te ulin rrezikun e ndotjes se siperfaqeve te pjatave te nxehta. Makinat e fuzionit duhet te jene te afta per te zbatuar nje presion fuzioni te kontrollueshem ne siperfaqen e bashkimit por njekohesisht te jene te afta per te ushtruar forca te medha terheqese per t'u perballur me instalimin e vargjeve te gjata te tubacioneve. Cilindrat shtytes me perpikmeri te larte dhe kontrollues te energjise bejne te mundur nje pune te paster dhe ndihmese per parandalimin e shtrimit te keq. Nje rul transmetues frekuent mbi vargun e tubave ul forcat per terheqje dhe paraprin zjarrit dhe gervishtje te panevojshme te tubave. Kjo eshte veçanerisht e rendesishme kur perdoren metodat e shkrirjes me trysni te dyfishte.

---

### **Bashkimi Me Fuzion**

Proçedurat e rekomanduara per bashkimin me fuzion si per PE 80 ashtu edhe per PE 100 detajohen ne fuzionin me shkrirjen, elektrofuzionin, bashkimin mekanik, bashkimin me kllapa dhe xokol se bashku me nevojat per trajnim, mirembajtje, sherbim dhe kalibrim.

Ne terma te pergjithshme ne menyre qe te behen bashkime te mira duke perdorur tekniken e akopjimit me fuzion ne rrjet eshte e nevojshme te respektohen kerkesa te proçedures se bashkimit duke pasur parasysh perpunimin e skajit te tubit si edhe kontrollin e temperatures dhe trysnise.

---

### **Fuzioni Me Shkrirje**

Tubat dhe akopjimet mund te lidhen me fuzion me shkrirje duke perdorur nje pllake qe nxehet me energji elektrike. Fuzioni me shkrirje eshte i pershtatshem per tuba bashkues dhe akopjimet ne permasa me te medha se 63 mm. Sidoqofte per te siguruar saldime te besueshme vetem tubat dhe akopjuesit me permasa te njeta ne shkalle SDR dhe te tipit polietilen mund te bashkohen duke perdorur kete teknike per shembull nje tub SDR 250 mm nuk duhet te bashkohet me nje akopjues SDR 17.6.

Kushtet e bashkimit me fuzion me shkrirje te rekomanduara per te bashkuar tubat PE 100 dhe PE 80 jepen ne patenten e aparatit te saldimit.

---

### **Elektrofuzioni**

Manikotat me elektrofuzion kane disa priza qe permbajne tela nxehes elektrike te cilat kur lidhen me tensionin puthisin manikoten ne tub pa pasur nevojën e pajisjeve te tjera nxehese. Eshte esenciale qe punetoret te kujdesen veçanerisht per te siguruar proçedurat e saldimit te respektohen rigorozisht dhe ne veçanti qe:

-Skajet e tubave te jene te lemuar ashtu si duhet.

-Te gjitha pjeset e bashkimit te jene mbajtur paster dhe te thata para bashkimit duke ditur qe ndonje papasterti mund te çojë ne deshtim. Pastrues te lagur me izopropanol mund te perdoren per te zhvendosur papastertite pas lemimit.

- Kllapat jane perdorur saktesisht per te siguruar qe bashkimi mos te levize gjate ciklit te nxehtjes dhe ftohjes.

- Mbulesa gjate saldimit perdoren per te siguruar qe pluhuri ose shiu nuk ndotin bashkimin dhe per te minimizuar efektet e lageshtise se eres.

## PUNIMET E SHTRESAVE

### 1.1 Shtresa baze me stabilizant pa lidhes (te stabilizuara mekanikisht)

#### Përshkrimi

Ndërtimi i bazave të pastabilizuara (të stabilizuara mekanikisht) përfshin furnizimin dhe vendosjen në vëndin e përcaktuar në projekt të përzierjeve të granuluara të materialeve inerte që nevojiten për bazat e pastabilizuara. Këto lloj punimesh duhet të kryhen në kushte kur temperatura e ajrit është mbi 2°C dhe pa rreshje.

#### Materialet Bazë

Materialet bazë për bazat e pastabilizuara (BP) janë agregatët e prodhuar prej materialit të granular të gurëve të thyer, zhavorrit të thyer ose përzierjeve të kokrrizave të thyera. Përzierjet e materialit të granular përmbajnë kokrriza që janë prodhuar nga thyerja e gurëve artificialë ose zhavorrit. Në këtë volum termat e përdorur për përzierjet e materialit të granular janë përcaktuar në Tabelën meposhte:

Klasifikimi i madhësisë, mm	Emërtimi i agregatit	Emërtimi i përzierjeve të granuluara të materialeve inerte
> 256	Gur	Gur
64–256	Gur natyror i rrumbullakët	Gur natyror
32–64	Zhavorr shumë i trashë	

16–32	Zhavorr i trashë	Zhavorr
8–16	Zhavorr mesatar	
4–8	Zhavorr i imët	
2–4	Zhavorr shume i imët	
1–2	Rërë shumë e trashë	Rërë
½–1	Rërë e trashë	
¼–½	Rërë mesatare	
125–250 µm	Rërë e imët	
62.5–125 µm	Rërë shumë e imët	

Table 4 - Klasifikimi i materialit (fraksioneve) bazë

## Cilësia e Materialeve

### ***Granulometria ([përbërja granulometrike) e përzierjeve të kokrrizave të gurit***

Përzierjet e granuluara të materialeve inerte natyror ose atij të thyer dhe përzierjet e granuluara prej kokrrizash mikse (të gurit) duhet të formohen prej materialeve të granular të zavorrit dhe gurit të thyer, zavorrit dhe çakullit, rërës dhe materialit mbushës, në mënyrë të tillë që të sigurohet formimi i përzierjes siç kërkohet në Figurat meposhte.




Figure 6 - Granulometria për përzierjet e granuluara të kokrrizave të gurit




Figure 7 - Formimi granulometrik i zonës kufitare të materialit të granular prej guri 0/20 mm për bazat e pastabilizuara




Figure 8 - Formimi granulometrik i zonës kufitare të materialit të granular prej guri 0/31.5 mm për bazat e pastabilizuara




Figure 9 - Formimi granulometrik i zonës kufitare të materialit të granular prej guri 0/40-50 mm për bazat e pastabilizuara

Formimi i përzierjeve të granuluara të materialeve inerte për bazat e pastabilizuara (BP) varet nga ngarkesa e trafikut të pritshëm të përcaktuar në projekt. Nëse trafiku i pritshëm nuk është përcaktuar në projekt, atëherë për konstruksionet e rrugëve duhet të përdoren përzierjet e formuara prej grimcash të ashpra për ngarkesë të rëndë trafiku. Në këtë rast, duhet patur parasysh që trashësia e shtresës duhet të jetë të paktën 2,5 herë sa diametri i kokrrizës më të madhe të përzierjes. Kontraktori mund të përdorë për bazat e pastabilizuara (BP) një përzierje të granular të materialit inerte që është e kompozuar ndryshe, nëse kjo përzierje i koresponдон kushteve të përcaktuara të përdorimit të miratuara nga një institut i autorizuar (i tillë si Instituti i Ndërtimit [IN]) ose një laborator tjetër i çertifikuar dhe, përdorimi i së cilës lejohet nga Inxhinjeri Mbikqyrës. Përzierja e granular e kokrrizave të gurit për BP mund të përmbajë sasinë e mëposhtme të materialit inerte deri në madhësinë 0.063 mm:

-në ngarkesat e depozituara, jo më shumë se 5% (m/m);

-pas vendosjes në BP, jo më shumë se 8-10 % (m/m).

Përmbajtja në përzierje e materialit inerte mbi 0.02 mm nuk duhet të jetë më e madhe se 3 % (m/m). Masa e granulometrisë jouniforme  $U = d_{60}/d_{10}$  duhet të jetë e barabartë për përzierjet e:

-granuluara të kokrrizave natyrore: 15 deri 100;

-granuluara të kokrrizave të thyera mikse: 8 deri 50.

Sasia korresponduese e rërës, e përcaktuar për përzierjet e granuluara të materialit inerte me madhësi prej 4 mm, për bazat e pastabilizuar të rrugëve duhet të jetë:

-të paktën 60 %, për ngarkesë trafiku të rëndë ose shumë të rëndë ;

-te pakten 50 %, për ngarkesë trafiku mesatar ose të lehtë.

---

### Karakteristikat mekanike

Forca në shtypje e materialit inerte në një përzierje duhet te jete të paktën 100 MN/m<sup>2</sup>.

Rezistenca e materialit inerte ndaj thyerjes, e përcaktuar sipas metodes së ‘Los Angeles’, për

BP të rrugëve lejohet deri në madhësinë:

-jo me shume se 30%, për ngarkesë trafiku shumë të rëndë ose të rëndë;

-jo me shume se 35%, për ngarkesë trafiku mesatar ose të lehtë.

Rezistenca e materialit inerte ndaj ngrirjes, e përcaktuar për kokrrizat e granuluara me madhësi mbi 4 mm nëpërmjet 5 cikleve të testit të kristalizimit (me natrium sulfati), e shprehur në përqindje të kokrrizave të humbura nga kampioni origjinal, lejohet deri në masën 5% (m/m).

Sasia e kokrrizave në një përzierje të granular, forma e të cilave nuk plotëson kushtin  $l:d \leq 3:1$ , nuk lejohet të jetë më shumë se 20%.

Përdorimi i shtesave organike në përzierjet e granuluara të materialit inert lejohet deri në atë masë që solucion 3% i alkalit të natriumit të ngjyroset më së shumti deri në ngjyrën e verdhë të errët.

Një përzierje me material të granular prej materialit inert për bazat e pastabilizuara (BP) nuk duhet të përmbajë shtesa të dëmshme. Përzierjet prej materiali të granular mund të përmbajnë kokrriza guri të dekompozuar ose të dobëta vetëm në sasi të tillë, e cila lejon që tërësia e këtyre kokrrizave të përputhet me kërkesat e përshkuara.

Aftësia mbajtëse e kokrrizave të gurit, e percaktuar në laborator sipas metodës “Californian Bearing Method (CBR)”, duhet të jetë në sasi:

-të paktën 50—60%, për përzierjet e granuluara të materialit inert dhe përzierjet e granuluara prej kokrrizash mikse, të cilat përmbajnë më pak se 50 % material të thyer (të granular);

-të paktën 80%, për përzierjet e granuluara të materialit inert dhe përzierjet e granuluara prej kokrrizash mikse, të cilat përmbajnë më shumë se 50 % material të thyer (të granular).

Çdo përzierje me material të granular të materialit inert, që parashikohet të përdoret në bazat e pastabilizuara (BP), duhet të kontrollohet përpara fillimit të punimeve me anën e testimit të tre mostrave në përputhje me kërkesat e këtyre kushteve teknike. Nëse prodhimi i përzierjes është testuar në mënyrë të rregullt nga një institut i autorizuar, i tillë si IN ose ndonjë laborator i çertifikuar, dhe kur nga rezultatet përkatëse ka rezultuar një cilësi e përshtatshme e përzierjes së kokrrizave të gurit, atëherë përpara fillimit të punimeve mjafton të kontrollohet vetëm një mostër.

---

## Metoda e Zbatimit

### **Sigurimi i përzierjeve të materialit inert**

Kantjeri i prodhimit të përzierjeve të materialit të granular prej materialit inert për bazat e pastabilizuara (BP) duhet të raportohet (nga Kontraktori) tek Inxhinjeri Mbikqyrës në një kohë të arsyeshme përpara fillimit të procesit të sigurimit (blerjes) të materialit. Kontraktori duhet gjithashtu të paraqesë dëshmi mbi cilësinë e përzierjeve në përputhje me këto specifikime dhe të marrë miratimin e Inxhinjerit Mbikqyrës për përdorimin e tyre. Dëshmitë mbi cilësinë e përzierjeve të materialit të granular prej materialit inert nuk duhet të jenë më të vjetra se një vit. Karrierat e nxjerrjes së gurit për përzierjet e granuluara dhe guroret duhet paraprakisht të pastrohen në mënyrën e duhur.

### **Testet Provë**

Testet provë (në një sipërfaqe testimi të percaktuar nga Inxhinjeri Mbikqyrës dhe sipas udhëzimeve të Tij) që kryhen përpara fillimit të punimeve duhet të tregojnë:

-formimin e përzierjeve me material të granular të kokrrizave prej guri (në përputhje me këto rregulla teknike) me anën e një ose të dy mostrave; dhe



-cilësitë mekanike (në përputhje me këto rregulla teknike) me anën e një ose të dy mostrave, për të garantuar që cilësitë karakteristike të përzierjeve të përgatitura përputhen me cilësitë e përcaktuara me anën e tre kontrolleve të mostrave të marra përpara fillimit të punimeve, dhe pastaj të masë:

-densitetin e shtresës së ndërtuar (në përputhje me këto rregulla teknike) me anën e të paktën 15 matjeve të densitetit (ngjeshmërisë) dhe përmbajtjes së lagështisë tek përzierjet me material të granular prej kokrrizave të gurit;

-kapacitetin mbajtës të shtresës së ndërtuar (në përputhje me këto rregulla teknike) me anën e të paktën 3 matjeve të modulit të deformacionit;

-kuotën dhe lartësinë e formimit të shtresës së ndërtuar (në përputhje me këto rregulla teknike) me anën e të paktën 5 matjeve.

Proçesi, lloji i agentëve për ngjeshje dhe efekti i përgjithshëm i tyre duhet të përcaktohen përpara fillimit të punimeve për çdo lloj karakteristik të përzierjes me material të granular prej kokrrizave të gurit. Për këtë qëllim, efekti i agentëve ngjeshës duhet të matet pas çdo kalimi në të paktën tre vënde të një seksioni provë. Pas përfundimit të ngjeshjes së formacionit të bazave të pastabilizuara (BP), shkalla e ngjeshmërisë dhe lagështia e përzierjes së ndërtuar (vendosur në vepër) me material të granular prej materialit inert duhet të matet të paktën në 10 vënde të ndryshme.

---

### **Përgatitja e formacionit të nën-bazës**

Formacioni i nën-bazës duhet të përgatitet sipas specifikimeve të këtyre kushteve teknike përpara fillimit të shpërndarjes tek BP të përzierjes së materialit të granular prej kokrrizave të gurit. Ndërtimi i BP mund të fillojë vetëm atëherë kur Inxhinjeri Mbikqyrës ka marrë në dorëzim shtresën e nën-bazës sipas specifikimeve të këtyre kushteve teknike. Deri në fillimin e punimeve të superstrukturës Kontraktori është i detyruar t'a mirembajë shtresën e nën-bazës në gjëndjen kur ajo është marrë në dorëzim. Të gjitha dëmtimet e saj duhet të riparohen brënda një kohe të arsyeshme dhe një evidencë e tyre duhet të paraqitet tek Inxhinjeri Mbikqyrës.

---

### **Depozitimi i përzierjeve të materialit inert**

Nëse përpara shpërndarjes në BP Kontraktori do të depozitojë përkohësisht përzierjet me material të granular të kokrrizave të gurit, atëherë është e nevojshme që vendi i tyre i depozitimit të përgatitet paraprakisht në mënyrën e duhur.

#### *Transporti i përzierjeve të materialit inerte*

Përzierjet e materialit të granular të materialit inerte për BP mund të transportohen në formacionin e nën-bazës, së përgatitur në mënyrën e duhur, vetëm kur kjo gjë do të lejohet nga Inxhinjeri Mbikqyrës. Ne përgjithësi, transporti nuk duhet të kryhet mbi sipërfaqen e formacionit të nën-bazës së përgatitur

më parë ose të marrë në dorëzim, por mbi një shtresë të sapo shpërndarë prej përzierjesh të granuluara të kokrrizave të gurit. Automjetet e ngarkuara me material duhet t'a shkarkojnë atë duke e derdhur (zbrasur) anash ose mbrapa. Nëse, për arsye të shpërndarjes ose vendosjes mekanike, materiali i përzierjes që transportohet është i vendosur pjesërisht mbi sipërfaqen e formacionin të nën-bazës, atëhere metoda e transportit duhet të miratohet nga Inxhinjeri Mbikqyrës. Për transportin e përzierjeve me material të granular prej kokrrizave të gurit duhet të përdoret një automjet i pajisur në mënyrë të përshtatshme. Për shpërndarjen e materialit duhet të përdoren pajisje, të cilat arrijnë përhapjen e kërkuar të tij. Trashësia e shpërndarë e përzierjes së materialit të granular prej kokrrizave të gurit duhet të përputhet me trashësinë e kërkuar të shtresës së ngjeshur të përzierjes së materialit të granular prej materialit inerte të përcaktuar në projekt. Në rast se është parashikuar vendosja e një numri shtresash prej përzierjesh të granuluara të materialit inerte, atëhere çdo shtresë e veçantë e tyre duhet të formohet dhe ngjeshet në mënyrë të përshtatshme përpara transportimit të përzierjes për fillimin e shtresës pasardhëse.

Nëqoftëse përzierjet me material të granular të materialit inerte janë shpërndarë mbi shtresa të pangjeshura, atëhere është e nevojshme që automjetet të lëvizin gjatë transportit në mënyrë të barabartë mbi të gjithë gjerësinë e materialit të përzierjes të shpërndarë. Automjetet që i kanë gomat ose pjesën e poshtme të karrocërisë të papastrat nuk lejohet të lëvizin mbi përzierjen e materialit të granular të materialit inerte për bazamente të pastabilizuar që sapo është shpërndarë ose ngjeshur.

#### **Shpërndarja e përzierjeve të materialit inerte**

Shpërndarja në BP e përzierjes së materialit të granular prej materialit inerte duhet në përgjithësi të bëhet në mënyrë mekanike. Shpërndarja me dorë lejohet vetëm në ato zona që nuk mund të arrihen nga mjetet dhe ku shpërndarja me dorë është e lejuar nga Inxhinjeri Mbikqyrës. Përzierjet e materialit të granular prej materialit inerte për BP duhet përgjithësisht të transportohen me një përmbajtje të përshtatshme në kantjerin e ndërtimit. Çdo korrigjim i përmbajtjes së dobët të një përzierjeje të përgatitur në kantjerin e ndërtimit ose në pikën e shpërndarjes do të lejohet nga Inxhinjeri Mbikqyrës mbi bazën e rezultateve përkatëse të testeve provë. Sasitë e nevojshme të ujit për sigurimin e lagështisë optimale për ngjeshjen e përzierjes së materialit të granular prej materialit inerte duhet zakonisht të shpërndahen në mënyrë të barabartë mbi këtë përzierje që në kantjerin e përgatitjes së kësaj përzierjeje. Nëse uji duhet të shtohet në përzierje tek zona e shpërndarjes së saj, atëhere ky ujë duhet të vendoset me spërkatje në atë mënyrë që të parandalohet shpëlarja e kokrrizave të imta. Gjatë ngjeshjes, përmbajtja e lagështisë së përzierjeve me material të granular mund të shmanget nga përmbajtja optimale e lagështisë me  $\pm 2\%$ . Në mënyrë që përzierja e materialit të granular të qëndrojë në mënyrë sa më uniforme, sigurimi i kësaj përmbajtjeje të lagështisë është veçanërisht i rëndësishëm në rast se kjo përzierje do të shpërndahet me grejder.

Shpërndarja e përzierjes së materialit të granular për BP duhet të bëhet me makineri të përshtatshme: zakonisht me një finitriçe dhe, me miratimin e Inxhinjerit Mbikqyrës, mund të bëhet gjithashtu edhe me një grejder ose në raste të veçanta (të jashtëzakonshme) me një buldozer.

Zakonisht, shpërndarja duhet të realizohet në të njëjtën ditë që bëhet dhe spërkatja me ujë. Përzierja uniforme e materialit të granular të kokrrizave të gurit, e niveluar sipas profilit të kërkuar në projekt, duhet të ngjeshet me makineri të përshtatshme për të gjithë gjerësinë e shtresës. Në mënyrë që të arrihet një ngjeshje korrekte dhe kapaciteti i ngarkimit për të gjithë gjerësinë e projektuar të karrexhatës, nëse nuk është parashikuar ndryshe në projekt, gjerësia e vendosjes së materialit deri në arritjen e trashësinë së projektuar të shtresës duhet të rritet me 10 cm. Shtresat duhet të ngjeshen duke filluar nga shtresa me e ulët në drejtim të shtresës së sipërme. Numri i kalimeve të mjeteve të përshtatshëm për ngjeshje, të përcaktuara nga testet provë, duhet të kontrollohet nëpërmjet testeve rutinë mbi densitetin dhe ngjeshmërinë e shtresës së ndërtuar nga përzierje materiali të granular të kokrrizave të gurit.

Të gjitha parregullsitë e shfaqura gjatë ngjeshjes duhet të korrigjohen në përputhje me kërkesat e Inxhinjerit Mbikqyrës. Të gjitha zonat e paarrtshme prej makinerive duhet të ngjeshen deri në shkallën e projektuar të ngjeshmërisë me anën e pajisjeve të tjera, të cilat duhet të miratohen nga Inxhinjeri Mbikqyrës, i cili gjithashtu përcakton dhe kushtet në të cilat duhet të përdoren këto pajisje. Përveç ngjeshmërisë, përpara ngjeshjes perfundimtare duhet të përcaktohet edhe aftësia mbajtëse e BP-ve të ndërtuara. Nëse nuk janë arritur vlerat e kërkuara sipas projektit, atëherë Kontraktori duhet të sigurojë që cilësia e BP të ndërtuara të arrihet me anën e masave shtesë.

---

## **Cilësia e Zbatimit**

### **Të përgjithshme**

Përpara fillimi të punës së makinerive dhe pajisjeve, prej të cilave do të varet cilësia e zbatimit të punimeve, duhet të kontrollohet aftësia e tyre për sigurimin e cilësisë së punimeve në përputhje me kërkesat e këtyre kushteve teknike. Të gjitha pajisjet dhe makineritë duhet të testohen dhe të plotësojnë kërkesat e projektit në lidhje me kapacitetin e tyre.

### **Ngjeshmëria**

Ngjeshmëria e përzierjeve prej materialit të granular të materialit inerte të vendosur në BP, e përcaktuar me anën e Metodës së Proktorit të Modifikuar, duhet të ketë një vlerë mesatare prej 95%. Vlera kufitare me e ulët e ngjeshmërisë nuk duhet të jetë më e vogël se 3% e vlerës së saj mesatare. Dëndësia e përzierjes së vendosur (në vepër) duhet zakonisht të përcaktohet me anën e metodës matëse të mos-shkatërrimit duke përdorur për këtë qëllim prova izotropike (densimetria bërthamore).

---

## **Aftësia mbajtëse**

Aftësia mbajtëse e BP e përcaktuar me anën e modulit të deformacionit  $E_{v2}$  dhe raportit i moduleve të deformacionit  $E_{v2}/E_{v1}$ , të përcaktuar sipas standarteve EN (CNR 146) me një pllakë me diametër 300 mm, duhet të përputhet me kërkesat e dhëna në Tabelen 2.2:

Ngarkesa e trafikut				
Lloji i përzierjes së materialit të granular prej materialit inerte	Shumë e rëndë ose e rëndë		E mesme ose e lehtë	
	Vlera e kërkuar, në N/mm <sup>2</sup>			
	$E_{v2}$	$E_{v2}/E_{v1}$	$E_{v2}$	$E_{v2}/E_{v1}$
Natyror	$\geq 80$	$\leq 1,5$	$\geq 60$	$\leq 1,5$
I thyer ose miks	$\geq 120$	$\leq 1,5$	$\geq 80$	$\leq 1,5$

Figure 10 - Kërkesat mbi aftësinë mbajtëse të BP

Raporti i moduleve të deformacionit  $E_{v2}/E_{v1}$  nuk është i rëndësishëm për vlerësimin e aftësisë mbajtëse të përzierjeve të pastabilizuara prej materialit të granular të materialit inerte nëse vlera e modulit të deformacionit  $E_{v1}$  është më e madhe se 80 % e  $E_{v2}$  së kërkuar. Vlera kufitare më e ulët e modulit të deformacionit mund të jetë deri 20 % më e vogël se vlera e kërkuar në Tabelën 2.2. Kur Kontraktori nuk arrin raportin e kërkuar të moduleve të deformacionit  $E_{v2}/E_{v1}$ , atëhere punimet e mëtejshme duhet të përcaktohen nga Inxhinjeri Mbikqyrës.

#### **Nivelimi, lartësia, pjerrësia**

Parregullsitë prej planit të rrafshët të BP përcaktohen me anën e shmangieve të matura poshtë një shufre të drejtë me gjatësi 4 m, të vendosur në çdo drejtim të mundshëm me aksin e rrugës. Sipërfaqja e formimit të BP lejohet të shmanget prej rrafshit të shufrës së drejtë për jo më shumë se 20 mm (vlera e sipërme kufitare). Nëqoftese numri i këtyre shmangieve do të rritet, atëhere Inxhinjeri Mbikqyrës duhet të përcaktojë metodën e korigjimit të tyre. Lartësia e pikave të veçanta të matjes mbi sipërfaqen e formimit të BP duhet të përcaktohet me anë të nivelës. Sipërfaqja e formimit të BP në çdo pikë të mundshme të saj mund të shmanget nga lartësia e projektuar për jo më shumë se +10 mm ose -15 mm (vlera e sipërme kufitare).

Pjerrësitë e sipërfaqes së formimit të BP duhet të përputhen me pjerrësinë e profilit tërthor dhe atij gjatësor të karrexhatës sipas projektit. Shmangiet e lejuara përcaktohen me anën e parregullsitë të lejuara prej planit të rrafshët si dhe të shmangieve prej lartësisë së formimit të BP, por këto shmangie nuk duhet të jenë më të mëdha se  $\pm 0.4\%$  e vlerës absolute të pjerrësisë (vlera ekstreme kufitare).

### **Kontrolli i Cilësisë së Zbatimit**

#### **Testet rutinë**

Inxhinjeri Mbikqyrës vendos për sasinë e testeve rutinë që nevojiten gjatë shpërndarjes në BP të përzierjeve të materialit të granular të materialit inerte mbi bazë të rezultateve të testeve teknologjike provë.

Numri minimal i testeve rutinë për përzierjet e materialit të granular të materialit inerte, të cilat duhet të kryhen nga Kontraktori, përfshijne testet për:

- granulometrinë e përzjerjes së materialit të granular të materialit inerte çdo 5,000 m<sup>3</sup>
- forcën e gurit në shtypje çdo 10,000 m<sup>3</sup> - rezistencën e kokrrizave në thyerje çdo 5,000 m<sup>3</sup> - rezistencën e kokrrizave kunder ngrirjes çdo 5,000 m<sup>3</sup> - formën e kokrrizave çdo 10,000 m<sup>3</sup> - përmbajtjen e shtesave organike çdo 10,000 m<sup>3</sup>
- aftësinë mbajtëse të përzjerjes së materialit të granular të materialit inerte çdo 1,500 m<sup>2</sup>
  - përmbajtjen normale të lagështisë dhe dendësinë e përzjerjes së materialit të granular prej

materialit inerte me Metoden e Proktorit të Modifikuar çdo 5,000 m<sup>3</sup>

Numri minimal i testeve rutinë gjatë shpërndarjes në BP të përzjerjes me material të granular të materialit inerte përfshin matjet mbi:

- përmbajtjen e lagështisë dhe dendësinë e përzjerjes - aftësinë mbajtëse – modulin e deformacionit - kuotën dhe lartësinë e formimit të shtresës

çdo 1,000-1,500 m<sup>2</sup>

çdo 500-1,000 m<sup>2</sup>

çdo 10-20 ml

Sasia e testeve minimale rutinë do të shtohet për rastet kur Inxhinjeri Mbikqyrës vëren se testet rutinë paraqesin shmangie të mëdha të rezultateve nga testet provë. Në rast të rezultateve të njëjta mundet gjithashtu që Inxhinjeri Mbikqyrës të zvogëlojë sasinë e testeve minimale rutinë. Cilësia e BP të ndërtuara mundet të përcaktohet me anën e metodave të tjera të konfirmuara nëse për këtë gjë jep gjithashtu miratimin e tij Inxhinjeri Mbikqyrës. Në të tilla raste, matjet për cilësinë e ndërtimit si dhe mënyra dhe sasia e testeve që duhen kryer duhet të përcaktohen gjithashtu në marrëveshje me Inxhinjerin Mbikqyrës.

### **Testet e kontrollit**

Nëqoftëse nuk është përcaktuar ndryshe, sasia e testeve të kontrollit që kryhen nga Punëdhënësi (Klienti) duhet të jetë në raport 1:4 me testet rutinë. Vendet e marrjes së mostrave të përzjerjeve prej materiali të granular të materialit inerte dhe vendet e matjes për kryerjen e matjeve rutinë dhe atyre të kontrollit mbi cilësinë e zbatimit të BP do të përcaktohen nga Inxhinjeri Mbikqyrës me anën e metodës së përzgjedhjes së rastësishme.

---

## **Matja dhe Marrja në Dorëzim e Punimeve**

### **Matja e punimeve**

Punimet e zbatuara maten në përputhje me këto rregulla teknike dhe përllogariten në metra katrorë (m<sup>2</sup>). Të gjitha sasi të maten sipas sasive dhe llojit të punimit të zbatuar në kuadër të volumeve të projektit.

### ***Marrja ne dorëzim e punimeve***

Bazat e ndërtuar të pastabilizuar (BP) do të merren në dorëzim nga Inxhinjeri Mbikqyrës në përputhje dhe sipas kërkesave mbi cilësinë të këtyre kushteve teknike. Të gjitha difektet e vërejtura në lidhje me këto kërkesa duhet të riparohen nga Kontraktori përpara vazhdimin të punimeve. Të gjitha shpenzimet për riparimin e defekteve janë në ngarkim të Kontraktorit, duke përfshirë shpenzimet për të gjitha matjet dhe testet të cilat kanë provuar cilësinë e dobët të punimeve të zbatuara si dhe testet e domosdoshme për përcaktimin e cilësisë së punimeve edhe njëherë pas kryerjes së riparimeve përkatëse. Kontraktori nuk ka të drejtë për asnjë lloj pagese për të gjitha ato punime, të cilat nuk përputhen me cilësinë e kërkuar sipas këtyre kushteve teknike dhe që Kontraktori nuk i ka riparuar sipas udhëzimeve të Inxhinjerit Mbikqyrës. Punëdhënësi (Klienti), në të tilla raste, ka të drejtë të zgjasë për të paktën 5 (pesë) vjet kushtet e garancisë për të gjitha ato punime që varen prej punimeve të riparuar.

---

## **Llogaritja e Kostos**

### ***Të përgjithshme***

Punimet e zbatuara do të llogariten në përputhje me këto rregulla teknike dhe sipas çmimit njësi të kontratës. Çmimi njësi i kontratës duhet të përfshijë të gjitha shërbimet e domosdoshme për zbatimin e plotë të punimeve. Kontraktori nuk ka të drejtë për asnjë pagese shtesë.

### ***Zbritjet si rezultat i cilësisë së dobët***

#### ***Përzjerjet e materialit inerte***

Nuk lejohen të bëhen zbritje të kostos, kjo për arsye të kushteve të vendosura mbi cilësinë respektive të përzjerjes prej materiali të granular për BP. Nëse Kontraktori vendos në BP një përzjerje që nuk përputhet me kërkesat e këtyre kushteve teknike, atëherë metoda e përlllogaritjes së kostos do të përcaktohet nga Inxhinjeri Mbikqyrës.

#### ***Cilësia e zbatimit***

Siç përcaktohen në këto rregulla teknike, vlerat më të ulta kufitare mbi dëndësinë, aftësinë mbajtëse si dhe nivelimin dhe lartësinë do të korrespondojnë me 100% të çmimit njësi të ofertës.

Nuk do të ketë zbritje të kostos në lidhje me cilësinë e punimeve të kryera për arsye të kushteve që kërkojnë sigurimin e vlerave më të ulta kufitare. Nëse Kontraktori nuk siguron cilësinë e kërkuar të zbatimit në përputhje me këto rregulla teknike, atëherë metoda e përlllogaritjes së kostos do të përcaktohet nga Inxhinjeri Mbikqyrës.

## 1.2 Shtrimi me pllaka guri

### Te pergjithshme

Rruget do te shtrohen me pllaka guri 8cm, llac cemento per fiksimin e pllakave 4cm, solete betoni e armuar 10cm dhe shtrese stabilizanti per profilim rruge 15-20cm. Trotualet dhe sheshet do te shtrohen me pllaka guri 6cm, llac cemento 4cm per fiksimin e pllakave dhe profilim me stabilizant 15-20cm si ne figure:




Figura 1– Paketa e shtresave te rruges, trotuaraeve dhe shesheve

Ne te gjitha rastet do te behet karikimi dhe ngjeshja e shtreses ekzistuese te nen-bazes (shtresa ekzistuese) dhe mbi te do te aplikohen shtresat e treguara mesiper.

### Karakteristikat e gurit natyror te shtrimit dhe bordurave

Pllakat dhe blloqet e gurit natyror, duhet te jene ne perputhje me sandardin dhe normat e EN 1341: 2000 “per pllaka prej guri natyror per shtresa te jashtme”

Shtrimi i shesheve dhe rruges do te behet me teksutre dhe kompozim sipas projektit arkitektonik.

Guret qe do perdoren per shtrim, duhet te jene te prere me sharre sipas dimensioneve te dhena ne projekt dhe sipas konfigurimit te propozua. Siperfaqja e siperme e gurit duhet te jete e gdhendur dhe e skalitur me dore me ane te mjeshtrave artizanale te zones.

Guret per shtrim duhet te permbushin kerkesat dhe karakteristikat fiziko-mekanike si me poshte:

- Rezistenca ne shtypje para cikleve te ngrirje/shkrirjes: Minimumi 85 Mpa, si mesatarja e testimeve te mostres per njesi me pak se 80 MPa.
- Rezistenca ne shtypje pas 14 cikleve ngrirje/shkrirje: minimumi 80 MPa, si mesatarja e testimeve te mostres per njesi me pak se 75 MPa.

- *Absorbimi i ujit: maksimumi 4% i mesatares e mostres per njesi. Jo me te madhe se 6%.*
- *Rezistenca ngrirje / shkrije: Njesite nuk duhet te kene thyerje dhe nuk duhet te kene humbje me teper se maskimumi 1% te peshes se thate per çdo shtrese perkatese qe i nenshtrohet 50 cikleve te ngrirjes dhe shkrijes.*
- *Trashesia e blloqeve prej guri nuk duhet te jete me pak se 150 mm per shtrimin e rruges dhe 60mm per shtrimin e trotuarit.*
- *Toleranca e permasave: ndrysheshmeria ne permasimin e dimensioneve te pllakave te gurit nuk duhet te kaloje me teper se 1.5 mm ne gjatesi dhe 3mm ne gjeresi ne raport me dimensionet standarde te pllakave.*



*Figura 2– Shembull pllakash guri per shtrim kalldremit*

### 1.3 Llaç çimentoje për shtrim

Një shtresë llaç çimento për shtratin duhet të vendoset sipër sipërfaqes së përgatitur me një trashësi minimale prej 40 mm në mënyrë që të sigurojë nivelimin e duhur në trotuar pas vendosjes së shtrimit segmental të elementeve.

### 1.4 Metoda e shtrimit segmental të pllakave të gurit.

Modeli për shtrimin segmental me gure, do bëhet në përputhje me detajet e dhëna në projekt dhe në përputhje me udhëzimet e mbikeqyresit të punimeve. Si fillim duhen shtruar blloqet e plota dhe të pademtuar, dhe pastaj shtrimi vijon me copat e vogla mbushëse.



Copat e vogla mbushese duhet te jene te sharruara ose te prera me kujdes ne menyre qe te pershtaten sa me mire me hapesine qe mbushin. Ne rastet kur ka hapesira apo boshlleqe me pak se 20% te permaseve te nje blloku te plote, ato mund te mbushen me beton 25 MPa.

Fugat ndermjet blloqeve duhet te jete ndermjet 4 dhe 8 mm. Faqet e siperme te blloqeve duhet te jete te rrafsheta.

Pasi behet shtrimi i blloqeve ne rastin e shtrimit ne rruge dhe ne trotuare, behet dhe ngjeshja e tyre me makineri dore ne menyre qe te arrihet nje kompaktesim sa me i mire i shtreses. Pasi behet ngjeshja e pershkruar me siper, mbi shtresen e kompakesuar hidhet nje shtrese rere e imet e cila shperndahet me fshese derisa te mbushen te gjitha boshlleqet dhe fugat ndermjet pllakave te shtruara te gurit.

Çdo teprice rere do te hiqet dhe pastrohhet dhe me pas trotuari duhet t'i nenshtrohet dy fazave te tjera ngjeshese me makineri ngjeshese (kompaktor), i cili duhet te punoje ne nje frekuence prej 65 - 100 Hz me amplitude te ulet. Siperfaqja e ushtrimit te ngjeshjes (pjata) do te jete 0,2 - 0,4 m<sup>2</sup> dhe do te zhvilloje nje force centrifugale prej 7 - 16 kN. Ne çdo zone ku mbushesi i fugave (rera) eshte nen siperfaqen e shtrimit, duhet bere perhapja dhe fshirja me aplikimin e metejshem me rere te thate para se te hiqet sasia e rererave te teperta.

## 1.5 Bordurat dhe kunetat e Gurit

Bordurat e gurit duhet te plotesojne standardet EN 1343:2000 “bordura prej guri natyror per shtrime te jashtme”.

Bordurat e gurit qe do perdoren per trotuaret, duhet te jene te prera me sharre sipas dimensioneve te dhena ne projekt.

*Bordurat e gurit duhet te permbushin kerkesat dhe karakteristikat fiziko-mekanike si me poshte vijon:*

- *Rezistenca ne shtypje para cikleve te ngrirje/ shkrirjes: Minimumi 85 Mpa, si mesatarja e testimeve te mostres per njesi me pak se 80 MPa.*
- *Rezistenca ne shtypje pas 14 cikleve ngrirje/ shkrirje: minimumi 80 MPa, si mesatarja e testimeve te mostres per njesi me pak se 75 MPa.*
- *Absorbimi i ujit: maksimumi 4% i mesatares e mostres per njesi Jo me te madhe se 6%.*
- *Rezistenca ngrirje / shkrije: Njesite nuk duhet te kene thyerje dhe nuk duhet te kene humbje me teper se maskimumi 1% te peshes se thate per çdo shtrese perkatese qe i nenshtrohet 50 cikleve te ngrirjes dhe shkrirjes.*



Figura 3 - Shembull bordurash guri te prera me sharre

### ➤ Instalimi

Bloqet e bordurave duhet të instalohen para hedhjes së dyshemeve të trotuareve. Një kanal duhet hapur në terren me dimensionet e kerkuara. Kanali duhet të jetë të pakten 10 cm më i gjërë se blloqet, në të dy anët. Blloqet vendosen persiper betonit gjysëm të thatë të derdhur përgjatë kanalit. Beton duhet të derdhet me pas në të dy anët në mënyrë që të fiksohen bordurat.

Përgjatë pjesëve të drejta guret e bordurave ose të kunetave vendosen me ndihmën e një fijeje drejtuese. Toleranca e linjës aktuale (sipas faktit) në krahasim me vijën ideale (siç tregohet në projekt), duhet të jetë jo më shumë se 1 cm. Devijimi maksimal të bordurës së gurit në krahasim me linjën aktuale duhet të jetë jo më shumë se 0.5 cm. Parregullsitë (shtremberimet) nuk mund të jetë më të mëdha se 4 mm.

Bordurat e tranzitit për lejimin e kalimtareve që janë vendosur midis bordurave të llojeve të ndryshme dhe me lartësi të ndryshme duhet të jenë të pjerreta, d.m.th. lartësia e bordurës në lidhje me rrugën ose me pjesën e kullimit rritet apo zvogëlohet gradualisht drejt bordurave të tranzitit. Bordurat e të gjitha llojeve gjithmone duhet të vendosen mbi një themel dhe duhet të mbështeten me beton të varfer në anën e pasme.

Fugat e nryjeve janë të vendosura vertikalisht dhe në kënd të drejtë me aksin e rrugës. Guret e bordurave vendosen direkt pranë njeri-tjetrit dhe fugat e tyre nuk mbushen me llaç. Bordurat duhet të kenë fuga jo më të gjera se 6 mm.

Fugat midis pjesëve të ulluqeve të bordurave të kullimit, si edhe të gjitha fugat midis bordurave të kullimit duhet të jenë të mbushura me llaç ose me mbushes plastik.

Llaçi duhet të jetë i përbërë nga rere, çimento dhe / ose gelqere, perzierje uji, dhe mundësisht një përberje që vonon stazhionimin ose një agjent që çon në rritjen e porozitetit brenda betonit.

Sasia e çimentos ose gelqerës duhet të jetë të pakten 450 kg / m<sup>3</sup> rere.

Gjatesia e bordurave që duhet të sharohen për tu adoptuar sipas vendit duhet të jetë të pakten 0.5 m.

### ➤ Menyra e matjes dhe pageses

Pagesa për punën e përcaktuar në këtë seksion të Specifikimeve teknike për një shtresë të segmentale shtrimitin bllok gur do të bëhet për meter katror të shtrimit të rrugës apo trotuarit sipas llojit të shtrimit, në përputhje me zërat e preventivit të kontratës, shtresën e gurit përfshirë llaç çimento për shtrimitin me pllakë guri dhe shtresën e reres në rastin e shtrimit të rrugës.

Pagesa për zërat në fjale përfshin furnizimin e materialeve, ngarkimin, transportimin, nivelimin, shtresën llaç çimento (për trotuarin tipi 1), shtresën e reres, sigurimin e këndeve dhe buzeve të trotuarit, vendosjen e blloqeve të gurit, duke përfshirë prerjen axhustimin, mbushjen e fugave, ngjeshjen, mbushjen dhe largimin e materialeve të panevojshme jashtë kantierit (në vend depozitimit të miratuar) në përputhje me Planin e Menaxhimit Mjedisor.

## BORDURAT E BETONIT DHE ELEMENTËT ANËSORË

### 1.1 Të Përgjithshme

Bordurat dhe Elementët Anësore të karrexhatës (BEA) janë elementë gjatësorë që vendosen për stabilizimin dhe kufizimin e anëve të jashtme të korsive të trafikut. Ato duhet të ndërtohen në përmasat e përcaktuara në projekt dhe në përputhje me këto rregulla teknike.

### 1.2 Përshkrimi

Bordurat dhe elementët anësore të karrexhatës përfshijnë gjerësitë shtesë (bankinat), bordurat, kufizimet dhe shinat mbrojtëse.

Ndërtimi i Bordurave dhe Elementëve Anësore të karrexhatës (BEA) përfshin:

- furnizimin e elementëve të parafabrikuar të përshtatshëm dhe vendosjen e tyre (në vepër), ose
- furnizimin e të gjithë materialeve bazë të nevojshëm, prodhimin e tyre dhe vendosjen në BEA, në vëndin e përcaktuar në projekt.

Këtu përfshihen gjithashtu të gjitha punimet për përgatitjen e bazamentit për BEA, realizimin e fugave, mbrojtjen e nevojshme të sipërfaqes si dhe të gjitha punimet e tjera që kanë lidhje me përforcimin e këtyre elementëve. Këto punime duhet të zbatohet në kohë pa rreshje dhe kur temperatura e bazës (pa erë) është 5—25°C. Gjatë vendosjes duhet të merren masa të veçanta kur vlerat e temperaturës janë përkohësisht më të ulta ose më të larta. Elementët anësore janë të nevojshëm për mbrojtjen e anëve të rrugës dhe rritjen e sigurisë së trafikut për të gjitha llojet e rrugëve. Tipet e elementëve anësorë përcaktohet zakonisht në projekt. Nëse nuk janë përcaktuar aty (në projekt), atëhere ato duhet të specifikohen nga Inxhinjeri Mbikqyrës.

### 1.3 Materialet Bazë

Materialet bazë që përdoren për prodhimin e përzierjeve të betonit dhe ndërtimin e BEA janë dhënë në këto rregulla teknike. Materialet bazë që përdoren për prodhimin e përzierjeve të asfaltbetonit për prodhimin e bordurave janë përcaktuar në këto rregulla teknike. Bordurat e gurit dhe blloqet e vegjël (kubet) që përdoren për kufizimet anësore mund të prodhohen prej gurëve silikatë ose karbonatë.

## 1.4 Cilësia e Materialeve

### Të Përgjithshme

Cilësia e materialit për përzierjet e betonit dhe të gjitha materialet e tjera të nevojshme për ndërtimin e BEA është e përcaktuar në këto rregulla teknike. Cilësia e materialeve për përzierjet e asfaltobetonit është gjithashtu e përcaktuar në këto rregulla teknike.

Granulometria e përzierjeve të gurit gjatë prodhimit mund të shmanget nga kufinj të granulometrisë deri në 3%. Përzierjet e materialeve inert duhet të përmbajnë vetëm kokrriza të thyera. Në raste të veçanta, lejohet përdorimi i rërës natyrore 0/20 mm, por vetëm në raport 1:1 me rërën e thyer. Për përgatitjen e përzierjeve të asfaltobetonit për bordura duhet të përdoret BIT 60.

Shmangiet e lejuara të përmasave të bordurave të gurit janë:

-për gjerësinë,  $\pm 3$  mm;

-për lartësinë,  $\pm 10$  mm.

Shmangiet e lejuara të përmasave për blloqet e vegjël prej guri lejohet deri në 10% të përmasave të përcaktuara.

### Bordurat prej Betoni të Parafabrikuar

Testimi dhe vlerësimi i cilësisë së bordurave prej betoni të parafabrikuar duhet të kryhet në përputhje me kërkesat e përcaktuara në standartet europiane EN 13369 dhe EN 13225.

### Testimi Provë, i Miratuar

Testimi provë duhet të kryhet përpara fillimit të prodhimit të rregullt të bordurave prej betoni të parafabrikuar si dhe, gjithashtu, pas çdo ndryshimi të përzierjes së projektuar dhe/ose procesit teknologjik gjatë prodhimit të rregullt.

Kryerja e testimit realizohet tek bordurat që janë 28 ditë të vjetra, prej mostrave të prera nga pjesa ballore ose e sipërme e sipërfaqes së rrafshët të bordurës. Një bordurë konsiderohet e përshtatshme nëse pas 25 cikleve të ngrirjes dhe shkrirjes do të plotësojë kriteret që vijojnë:

-humbja e masës  $< 0.200$  mg/mm<sup>2</sup>;

-thellësia e dëmtimit  $< 1$  mm.

Për çdo tre mostra kryhet një testim, ku sipërfaqja individuale e mostrave nuk duhet të jetë më e vogël se 100 cm<sup>2</sup>.

### Kontrolli i Prodhimit Rutinë

Respektohen të gjitha dispozitat në fuqi me përjashtim të:

- mos-testimit të rezistencës në shtypje të betonit për bordurat prej betoni;
- mos-kontrollit të rezistencës sipërfaqësore;
- rezistenca ndaj ngrirjes kontrollohet me anë të marrjes së mostrave të betonit, në kuadrin e kontrollit të rregullt të cilësisë së betonit në fabrikë;
- rezistenca ndaj ngrirjes në prani të kripës (për shkrirje) kontrollohet në mostrat e nxjerra prej bordurave.

Kontrolli kryhet në pjesën ballore të pjerrët ose sipërfaqen e sipërme të rrafshët të bordurës për betonin 28 ditë të vjetër.

Një bordurë konsiderohet e përshtatshme nëse pas 25 cikleve të ngrirjes dhe shkrirjes do të plotësojë kriteret që vijojnë:

- humbja e masës nuk është më e madhe se 0.250 mg/mm<sup>2</sup>;
- thellësia e dëmtimit nuk është më e madhe se 2.0 mm.

Procedura mund të vazhdojë deri në 50 cikle në rastin kur humbja e masës pas 25 cikleve është më e madhe se 0.250 mg/mm<sup>2</sup> por më e vogël se 0.350 mg/mm<sup>2</sup>. Bordura konsiderohet rezistente ndaj ngrirjes kur totali i humbjeve pas 50 cikleve ngrirje-shkrirje, të kryera në prani të kripës, nuk tejkalon 0.500 mg/mm<sup>2</sup> dhe thellësia e dëmtimit nuk tejkalon 2.5 mm.

Gjatë testimit mostra duhet të mbulohet me mbulesë plastike për të parandaluar avullimin e ujit dhe për të ruajtur (mbajtur) një përqëndrim të njëjtë të solucionit të kripës.

## 1.5 Metoda e Zbatimit

### Sigurimi i Materialit

Gjatë sigurimit (blerjes) së materialeve për bordurat duhet të plotësohen kërkesat e këtyre kushteve teknike.

### Përgatitja e Bazës

Si bazë për gjerësinë shtesë (bankinat) prej betoni mund të shërbejë:

- sipërfaqja e formimit të një baze të pastabilizuar, e përgatitur në përputhje me këto rregulla teknike; dhe

-sipërfaqja e formimit të një nën-baze të stabilizuar, e përgatitur në përputhje me këto rregulla teknike.

Kontraktori mund të fillojë ndërtimin e BEA vetëm pasi Inxhinjeri Mbikqyrës të ketë marrë në dorëzim sipërfaqen e formimit të bazës në përputhje me kërkesat e përcaktuara. Deri në momentin e fillimit të ndërtimit të bordurave, Kontraktori është i detyruar t'a mirëmbajë sipërfaqen e formimit të bazës në kushte të njëjta me ato të marrjes së saj në dorëzim. Të gjitha dëmtimet duhet të riparohen në mënyrën e duhur dhe dëshmitë përkatëse për këtë duhet të paraqitet tek Inxhinjeri Mbikqyrës.

---

### **Depozitimi i Përzierjeve të Kokrrizave të Gurit, Lidhësve dhe Elementëve të Parafabrikuar**

Për depozitimin e përzierjeve të kokrrizave të gurit, lidhësve dhe elementëve të parafabrikuar, që janë parashikuar për t'u vendosur tek bordurat, duhet të plotësohen kërkesat e këtyre kushteve teknike.

---

### **Prodhimi i Masave dhe Përzierjeve**

#### ***Prodhimi i masës së betonit***

Për prodhimin e të gjitha llojeve të masave të betonit për bordura duhet të plotësohen kërkesat e këtyre kushteve teknike.

#### ***Prodhimi i llaçit të Çimentos***

Për prodhimin e llaçit të çimentos për mbushjen e fugave të bordurave dhe kufizuesve (të karrexhatës) duhet të plotësohen kërkesat e përmendura në këto rregulla teknike.

#### ***Prodhimi i përzierjeve bituminoze***

Për prodhimin e përzierjeve bituminoze për bordura duhet të plotësohen kërkesat e këtyre kushteve teknike.

#### ***Transportimi i masave dhe përzierjeve***

Gjatë transportimit të masave të betonit si dhe përzierjeve të llaçit të çimentos dhe atyre bituminoze duhet të plotësohen kërkesat e këtyre kushteve teknike.

---

### **Ndërtimi**

#### ***Vendosja e masës së betonit***

Vendosja e masave të betonit në vëndet e përcaktuara për ndërtimin e BEA, si dhe të elementëve të parafabrikuar për BEA, është e përcaktuar në këto rregulla teknike.

#### ***Vendosja e përzierjeve bituminoze***

Përveç kërkesave për vendosjen e përzierjeve bituminoze, të përcaktuara në këto rregulla teknike, gjatë vendosjes së bordurave prej asfaltbetoni duhet gjithashtu të konsiderohen kërkesat që vijojnë:

për vendosjen e bordurave prej përzierjesh bituminoze duhet të përdoren makineri të përshtatshme, të cilat sigurojnë formën e kërkuar të bordurave (zakonisht në formë trapezoidale me anët e sipërme të rrumbullakosura);

temperatura e bazës (e cila duhet të jetë paraprakisht e spërkatur) dhe e ajrit duhet të jetë të paktën 10 °C;

-shmangiet më të mëdha të temperaturës së përzierjes bituminoze gjatë vendosjes (në vepër) prej temperaturës optimale të vendosjes, e cila është përcaktuar mbi bazën e prodhimit dhe vendosjes provë, lejohet të jetë  $\pm 10$  °C;

-ana e jashtme e bordurës prej asfaltobetoni duhet të jetë e spostuar për të paktën 5 cm nga ana e jashtme e shtresës së bazës të formuar prej përzierjesh bituminoze;

-bordura mund të digjet (nxehet) vetëm pasi përzierja bituminoze të jetë ftohur deri në temperaturën e ambientit.

### ***Vendosja e bordurave dhe kufizuesve (anësorë)***

Bordurat dhe kufizuesit e parafabrikuar ose prej guri duhet zakonisht të vendosen mbi një bazament të përgatitur në mënyrën e duhur, të realizuar me beton të freskët (Class 15/20) në përputhje me projektin.

Trashësia e shtresës mbështetëse mund të jetë:

- poshtë bordurave, të paktën 15 cm; dhe
- poshtë kufizuesve, të paktën 10 cm.

Distanca ndërmjet bordurave ose kufizuesve anësorë duhet të jetë 10-15 mm. Vënd-bashkimet (fugat) midis tyre duhet të mbushen në anën ballore dhe të sipërme me llaç-çimento deri në një thellësi prej të paktën 30 mm, ndërsa pjesët e mbetura të fugave mund të mbushen me një rërë të përshtatshme. Sipërfaqja e fugave me llaç-çimento duhet të realizohet në formën e duhur. Në raste të veçanta, bordurat dhe kufizuesit mund të vendosen gjithashtu mbi një shtresë baze të pastabilizuar. Kjo gjë duhet të përcaktohet nga Inxhinjeri Mbikqyrës.

## **1.6 Mbrojtja e Betonit**

Mbrojtja e duhur e betonit, që nevojitet gjatë përgatitjes së elementëve të parafabrikuar dhe vendosjes në ShS, është e përshkruar në këto rregulla teknike.

### **Ndërtimi i Fugave**

Të gjithë punimet e nevojshme në lidhje me ndërtimin e fugave të ShS janë të përmëndura në këto rregulla teknike.

## Betoni

Kushtet në lidhje me cilësinë e betonit për bordura janë përcaktuar në këto rregulla teknike. Përveç këtyre kërkesave, duhet të merret gjithashtu në konsideratë se shtresa mbrojtëse prej betoni, që vendoset mbi shufrat e çelikut të barrierave mbrojtëse të përforcuara, duhet të jetë të paktën 4 cm e trashë. Nëse në projekt nuk janë përcaktuar kërkesat në lidhje me cilësinë e betonit për BEA individuale (të veçanta), atëherë përcaktimi i tyre do të bëhet nga Inxhinjeri Mbikqyrës mbi bazën e punimeve të ngjashme të përmendura në këto rregulla teknike.

### 1.7 Kontrolli i Cilësisë së Zbatimit

#### Testet Rutinë

Numri i testeve rutinë gjatë ndërtimit të bordurave do të përcaktohet nga Inxhinjeri Mbikqyrës mbi bazën e rezultateve të testeve provë.

Testet rutinë minimale, të cilat duhet të kryejë Kontraktori, përfshijnë:

-për gjerësitë shtesë (bankinat), sasi të përkatëse të të gjitha testeve të përmendura në këto rregulla teknike;

-për bordurat dhe blloqet e vegjël (kubet) të parafabrikuar ose prej guri që përdoren si kufizues anësorë (të karrexhatës), të gjitha testet e dhëna në këto rregulla teknike, në raport: 400 m<sup>2</sup> = 100 ml;

-për bordurat prej përzierjesh bituminoze të realizuara me trarë nivelues, të gjitha testet përkatëse të përmendura në këto rregulla teknike, në raport: 2,000 m<sup>2</sup> = 100 ml;

-për bordurat prej asfaltobetoni, të gjitha testet e përmendura në këto rregulla teknike;

-për barrierat (shinat) mbrojtëse, të gjitha testet përkatëse të përmendura në këto rregulla teknike, në raport: 4,000 m<sup>2</sup> = 100 ml.

Inxhinjeri Mbikqyrës mund të rrisë numrin e testeve rutinë minimale në rast se zbulon shmangie më të mëdha të rezultateve të testeve rutinë prej atyre të testeve provë. Inxhinjeri Mbikqyrës mund gjithashtu të zvogëlojë numrin e testeve rutinë në rast të rezultateve të njëjta. Në marrëveshje me Inxhinjerin Mbikqyrës, cilësia e BEA të vendosura (në vepër) mund gjithashtu të përcaktohet dhe me anën e ndonjë metode tjetër të njohur. Në këto raste, matjet e cilësisë së vendosjes (në vepër) si dhe metoda dhe sasia e testeve duhet gjithashtu të theksohet dhe marrë miratimin e Inxhinjerit Mbikqyrës.



---

## Testet e Kontrollit

Numri i testeve të kontrollit, të cilat kryhen nga Punëdhënësi (Klienti), në rast se nuk është përcaktuar ndryshe, duhet të jetë në raport 1:4 me testet rutinë. Vëndet për marrjen e mostrave dhe kryerjen e matjeve rutinë dhe të kontrollit të cilësisë së zbatimit të BEA do të përcaktohen nga Inxhinjeri Mbikqyrës me anë të metodës së seleksionimit të rastësishëm statistikor.

## 1.8 Matjet dhe Marrja në Dorëzim e Punimeve

---

### Matja e Punimeve

Punimet e zbatuara maten në përputhje me këto rregulla teknike dhe llogariten në metër katror ( $m^2$ ). Të gjitha sasi të do të maten në përputhje me tipin dhe sasinë e punimeve e kryera në kuadër të volumeve të projektit.

---

### Marrja në Dorëzim e Punimeve

BEA e ndërtuar do të merret në dorëzim nga Inxhinjeri Mbikqyrës mbi bazën e kërkesave të cilësisë së këtyre kushteve teknike dhe në përputhje me këto rregulla teknike. Të gjithë mangësitë (defektet) e zbuluara në lidhje me këto kërkesa duhet të riparohen nga Kontraktori përpara vazhdimit të mëtejshëm të punimeve, në rast të kundërt do të zbritet kostoja e punimeve të zbatuara me cilësi të dobët.

Të gjitha shpenzimet për riparimin e defekteve janë në ngarkim të Kontraktorit, përfshirë shpenzimet për të gjitha matjet dhe testet që dëshmuar cilësinë e dobët të punimeve të zbatuara dhe, kur është e nevojshme, shpenzimet për matjet dhe testet e reja që kërkohen për përcaktimin e cilësisë së punimeve pas përfundimit të riparimeve përkatëse. Kontraktori nuk ka të drejtë për asnjë lloj pagese për të gjitha punimet, që nuk përputhen me cilësinë e kërkuar sipas këtyre kushteve teknike (që tejkalojnë vlerat kufitare ose vlerat kufitare ekstreme), dhe të cilat Kontraktori nuk i ka riparuar sipas udhëzimeve të Inxhinjerit Mbikqyrës. Në të tilla raste, Punëdhënësi (Klienti) ka të drejtë të zgjasë për të paktën 5 (pesë) vjet kushtet e garancisë për të gjitha punimet, të cilat varen prej punimeve të riparuar.

## 1.9 Llogaritja e Kostos

### Të Përgjithshme

Punimet e zbatuara në përputhje me këto rregulla teknike duhet të llogariten sipas çmimit njësi të kontratës.

Çmimi njësi i kontratës duhet të përfshijë të gjitha shërbimet e nevojshme për përfundimin e punimeve. Kontraktori nuk ka të drejtë të kërkojë ndonjë pagesë shtesë.

### Zbritjet në Kosto për Shkak të Cilësisë së dobët

#### *Cilësia e materialeve*

Si pasojë e kushtit të vendosur, gjatë llogaritjeve nuk lejohet të ketë zbritje në kosto në lidhje me cilësinë e materialeve përkatës për BEA.

Nëse Kontraktori vendos në BEA një material, i cili nuk përputhet me kërkesat e këtyre kushteve teknike, atëherë metoda e përlllogaritjes së koston do të përcaktohet nga Inxhinjeri Mbikqyrës; Inxhinjeri Mbikqyrës mund gjithashtu të refuzojë në tërësi punimet e kryera.

#### *Cilësia e Zbatimit*

Të dhënat bazë për vlerësimin e cilësisë së zbatimit dhe për llogaritjen e zbritjeve (në kosto)

për arsye të cilësisë së dobët (të punimeve) janë:

-për gjerësitë shtesë (të karrexhatës), bordurat dhe barrierat (shinat) mbrojtëse në Tabelën 4.11;

-për bordurat e parafabrikuara dhe ato prej guri në Tabelën 5.5;

-për bordurat prej asfaltbetoni në Tabelën 3.15.

Në rast se Kontraktori nuk është në gjendje të sigurojë cilësinë e kërkuar të ndërtimit të BEA sipas këtyre kushteve teknike, atëherë metoda e përlllogaritjes së tyre duhet të përcaktohet nga Inxhinjeri Mbikqyrës.

## STRUKTURAT PERJ CELIKU

### 1.1 Pershkrimi

Kjo punë konsiston në ndërtimin e strukturave të çelikut dhe pjesëve të strukturës së çelikut të strukturave të përbëra. Përfshihet furnizimi, fabrikimi, ngritja e çelikut strukturor dhe ndërtimi metalik i rastësishëm.

### 1.2 Vizatimet dhe Diagramat

**(a) Vizatimet e fabrikimit.** Te tregohen dimensionet e detajuara te plota dhe madhësitë e pjesëve përbërëse të strukturës dhe detajet e pjesëve të ndryshme.

Te tregohet drejtimi i rrotullimit të pllakave aty ku kërkohet orientimi specifik i pllakave. Te tregohen flanaxhat e pllakes se traut mbajtes dhe rrjetat e prera nga pllakat kështu që dimensionin i gjatë i pllakës përputhet me drejtimin e rrotullimit.

Te identifikohet lloji dhe klasa e secilës pjese që do të bëhet prej çeliku përveç çelikut AASHTO M 270, klasa 250.

Te tregohen shenjat e montimit që janë të ndërlidhura me pjesët origjinale të çelikut të uzines dhe raportet e tyre të certifikuara të testit të uzines.

**(b) Vizatimet e ngritjes.** Te ilustron plotësisht metoda e propozuar e ngritjes. Te tregohen detajet e kapriatave te struktures se perkohshme, mbajtesve, guys, dead-men, pajisjet e heqjes, dhe kapjet e elementeve te ures. Te tregohet sekuenca e ngritjes, vendndodhjet e vinçit dhe te maunes, kapacitetet e vinçave, vendet e pikave te ngritjes dhe masat e elementeve të urës. Te tregohen detajet e plota për fazat e parashikuara dhe kushtet e ngritjes. Nëse kërkohet nga Inxhinier gjatë rishikimit të vizatimit, te sigurohen llogaritjet që tregojnë se nderjet e lejuara nuk tejkalohe dhe se kapacitetet e elementeve dhe gjeometria përfundimtare janë të sakta. Te shikohet Seksioni 562 për kërkesat shtesë.

**(c) Vizatimet e transportit.** Te tregohen pikat e mbështetjes, litaret, lidhjet e ngurta te perkohshme ose traret dhe detaje të tjera të nevojshme për të mbështetur dhe per te shtrenguar elementin. Te sigurohen llogaritjet e shtresave që tregojnë peshen vetjake plus nderjet e lejuara te ngarkesës dinamike të shkaktuara nga procedura e ngarkimit dhe transportimit. Te perdoren nderjet e lejuara te ngarkeses dinamike të paktën 100% të nderjes se ngarkesës pasive. Te mos lejohet qe nderjet e sforcimit të tejkalojne kufirin e amplitudës së vazhdueshme te sforcimit për kategoritë e duhura. Te verifikohen nderjet e traut mbajtes te llogaritur qe plotësojnë Specifikimet e Projektimit te urave AASHTO LRFS.

Te trasnportohen dhe magazinohen elementet në të njëjtin drejtim si struktura e përfunduar, përveç nëse miratohet ndryshe nga Inxhinier.

### 1.3 Njoftimi i fabrikimit

Te jepet nje njoftim me shkrim të paktën 21 ditë para fillimit të punës së fabrikimit. Te mos prodhohen materiale para njoftimit dhe perpara se te aprovohen vizatimet.

#### **Kontrollimi.**

Çeliku strukturor mund te kontrollohet ne vendndodhjen e fabrikimit.

Te kontrollohen flanaxhat e traut mbajtes perpara fabrikimit sipas ASTM A578 dhe si me poshte:

- (a) Te kontrollohet pasi flanaxhat jane hequr nga pllaka kryesore;
- (b) Te perdoren kerkesat plotesuese S2.1 per standartet e pranimit; dhe
- (c) Te kontrollohen flanaxhat ne fabriken ose magazine ku ata jane hequr.

Te perfshihen në raportet e certifikuara te testimi të uzines, analizat kimike dhe rezultatet e testimi fizik për çdo nxehtësi të çelikut të përdorur në veper dhe për çeliquet me vlerat e ndikimit të specifikuara, përfshirë rezultatet Charpy V- te provave te shkalles se ndikimit . Te konfirmohet në raportin e provave se materiali është prodhuar në mënyrë të tillë kur është specifikuar praktika imtesikokrrize.

Te sigurohen çertifikatat e prodhimit në vend të raporteve të testimi të uzines për materialin që nuk eshte siguruar normalisht me raportet e testimi të unzines dhe për elementet si mbushjet, pllakat e vogla perforcuese dhe materialet e ngjashme kur sasia është e vogël dhe materiali është marrë nga magazina.

### 1.4 Magazinimi i materialit

Te magazinohen materialet strukturore mbi tokë në platforma, trungje, ose mbështetje të tjera. Te mbahen materialet pa papasterti, graso dhe pa lëndë të tjera të jashtme. Te mbrohen nga korrozioni dhe rryma elektrike.

### 1.5 Fabrikimi

Te prodhohet çeliku strukturor në një uzine fabrikimi që është certifikuar sipas AISC Programit të Certifikimit të Cilësisë. Te pajisen dhe te fabrikohen elementet e thyerjes kritike sipas AASHTO LRFD Specifikimet e Projektimit të Urërave dhe Pika 12 e AASHTO / AWS Kodi i Saldimit të Urës D1.5 (D1.5M).

Te hiqet smerçi i uzines dhe materiali i huaj nga sipërfaqet e jashtme të trareve të jashtem të çelikut të pa-ngjyrosur me anë të pastrimit të shpërthimit sipas SSPC-SP6, Pastrimi i Shpërthimeve Tregtare. Pastaj te thahet sipërfaqja dhe te aplikohen të paktën tre aplikime uniforme të mjegulles se ujit në intervale 24 orëshe për të siguruar gerryerjen uniforme.

Te mos ngrohen traret prej çeliku te lakuar.

Te mos shpohen, priten ose saldohen pjeset e elementeve strukturor, përveç nëse tregohet në skica ose nëse aprovohet me shkrim.

- (a) **Identifikimi i çelikut.** Te perdoret një sistem i shenjave të montimit të pjesëve të veçanta dhe i udhëzimeve të prerjes (në përgjithësi me referenca kryq të shenjave të montimit të paraqitura në vizatimet me elementet përkatës të mbuluar në porosinë e vleres së uzines). Te sigurohen informacione në dyqan që mbajnë identitetin e pjese origjinale.

Te identifikohet materiali i furnizuar nga stoku me numrin e nxehtësisë dhe raportin e testit të uzines.

Gjatë fabrikimit dhe para se të montohen elementet, te tregohen specifikimet e seciles pjesë të çelikut (përveç çelikut të klasës 250). Te vuloset çeliku duke përdorur vulosjen e çelikut te shuar ose vendosmerisht duke bashkangjitur një etikete te dukshme për çdo pjesë të çelikut të cilat do të jenë subjekt i operacioneve te fabrikimit të cilat mund të prishin shenjen e bojës duke u montuar tek elementet. Këto operacione fabrikimi përfshijnë pastrimin me shperthim, galvanizimin, ngrohjen për formimin ose per bojen.

Te perdoren vulat e çelikut te tipit me tension te ulet. Te shmangen gjurmet pranë skajeve të elementeve të pllakave të tensionuara. Te mos perdoren vulat në elementet me thyerje kritike. Te pajiset një deklaratë që vërteton identifikimin e çelikut qe është ruajtur gjatë gjithë procesit të fabrikimit.

## 1.6 Pllakat.

- (1) **Drejtimi i rrotullimit.** Te priten dhe te prodhohen pllakat prej çeliku për elementet kryesore dhe pllakat e bashkimit për fllanxhat dhe elementet kryesore te tensionit, në mënyrë që drejtimi kryesor i rrotullimit të jetë paralel me drejtimin e tensioneve kryesore dhe me nderjet shtypese.

- (2) **Skajet e prerjes së pllakes.**

(a) *Planifikimi i skajeve.* Te hiqen skajet e prera në pllaka më të trasha se 15 milimetra në një thellësi prej 6 milimetra përtej skajit origjinal te prere ose përtej çdo shkurtimi rihyrës të prodhuar nga prerja. Te priten ne rripa shkurtimet rihyrese perpara prerjes.

(1) *Prerja me oksigjen.* Te kryhet prerja me oksigjen sipas AASHTO/AWS Kodi i Saldimit te Ures D1.5 (D1.5M).

(b) *Inspektimi vizual dhe riparimi i skajeve të prerjes së pllakave.* Vizualisht te inspektohen dhe riparohen skajet e prerjes së pllakave. Te pershtaten sipas AASHTO / AWS Kodi i Saldimit te Ures D1.5 (D1.5M).

(c) *Pllakat me fllanxhe.* Te pajisen pllakat me fllanxhe me skajet e prera me oksigjen qe kane skaje ne terren te hapura te pakten 1.6 milimetra, ose te pajisen pllakat universale te uzines.

(d) *Pllaka e lidhjes.* Te perdoret prerja me oksigjen për të siguruar pjerrtësinë e përshtatur në pllakat e lidhjes së trarëve ekuilibruar dhe trareve horizontal të ndërtuar, trareve

ne forme kutie dhe harqeve te kutise. Te priten mjaftueshem pjerresite shtesë në lidhje për tu siguruar per humbjet e pjerresive per shkak te saldimit dhe prerjes.

- (e) *Elementet e kapriates.* Te pergatiten skajet gjatësore të pllakave në seksionet e salduara të lidhjes se kapriates dhe te elementeve te brezit nga prerja me oksigjen. Te perdoret mprehja për të prere skajet e qosheve të pllakave të paktën 1.6 milimetra kur pllakat nuk janë bashkuar me saldim.
- (f) *Pllakat e ngurtësimit dhe te lidhjes.* Skajet e prera mund të përdoren në trashësine e pllakes deri në 19 mm për pllakat e ngurtësimit dhe pllakat e lidhjes te salduara në mënyrë të tërthortë drejt lidhjeve dhe flanaxheve. Pllaka universale te uzines mund të përdoren për trashesine e pllakes deri në 25 mm. Te pajisen pllaka te tjera të ngurtësimit dhe te lidhjes me skajet e prerjes me oksigjen.
- (g) *Pllakat me fortese anesore.* Pllakave me fortese anesore te shtrenguara me bulona mund të pajisen me skaj të prerë me kusht që trashësia të jetë më e vogël ose e barabartë me 19 mm. Prerja e oksigjenit, paralel me drejtimet e nderjes, pllakat me fortese dhe lidhjet e tjera te salduara paralelisht me drejtimet e nderjes në elementet e tensionit ku trashësia e pllakës tejkalon 10 milimetra.

## STRUKTURAT E ÇELIKUT (CORTEN)

### 1.1 Përshkrimi

Te furnizohen dhe te montohen ne toke blloqe te strukturave te vetme metalike per urat e karakterizuara nga trare gjatesore te dyfishta T ne çelikun Corten S355 dhe diafragma perkulese te dyfishta T ne çelikun Corten S355, duke përfshire furnizimin dhe montimin e blloqeve te vetme, shtrimin, saldimit dhe shtrengimin me bulona.

### 1.2 Materiali

Sipas kerkesave te EN10025, te pranohet perdorimi i çelikut me vetite metalike jo me pak se ato te çelikut te tipit CORTEN S355.

Te gjitha materialet per inkorporim duhet te jene te kualifikuara dhe te shenjuara CE ne perputhje me direktivat 89/106/EEC. Shenja CE duhet te jete e lexueshme dhe te mundesohet nga fabrikanti nje certificate inspektimi ne kohen e dergimit me nje deklarate qe produkti eshte konform.

Kontraktori, perpara berjes se porosise, te paraqese per aprovimin e inxhinierit dokumentet e meposhtme te synuara per dergesen e furnitorit:

Specifikimet teknike te zbatueshme per Projektin;

Inspektimet dhe certifikimet ne lidhje me materialin;

Perputhshmeria e tolerances se trashesise se lastrave sipas kerkesave te UNI EN 10029 (TIPI A).

Perpara dergeses kontraktori duhet te paraqese:

Konfirmimin e porosise se fabrikuesit;

Pranimin e fabrikuesit per specifikimet teknike;

Caktimin e kohes se dergeses.

Ne veçanti per punetorine, duhet te respektohen parametrat ne vijim:

- 1 – Lastra dhe elemente S355J0W** per trashesi me pak se 20mm;
- 2 – Lastra dhe elemente S355J2W** per trashesi >20mm dhe <40mm;
- 3 – Lastra dhe elemente S355K2W** per trashesi >40mm
- 4 – Bulona**
- 5 - Vida te llojit 10.9** ne perputhje me kerkesat e UNI EN 20898 pjesa e I
- 6 - Vidha te llojit 8G** ne perputhje me kerkesat e EN 20898 pjesa e II
- 7 - Rondele çeliku C50** ne perputhje me kerkesat e EN 10083 (HRc32-40)
- 8 - Gozhda S235J2G3+C450** ne perputhje me kerkesat e UNIENISO 13918

### 1.3 Konstruksioni

#### a) Furnizimi, identifikimi dhe gjurmueshmeria e materialit.

Materialet e perdorura per kontruksionin e strukturave duhet te plotesojne kerkesat e mbajtura ne keto specifikime teknike dhe ne cdo rast ne perputhje me DM 14/01/2008.

Metoda e identifikimit dhe gjurmueshmerise se materialit duhet ne zbatohet per secilen pjese te vetme te struktures.

Plani i shenimit duhet te mundesohet automatikisht nga softueri kur te krijohet skemat llogaritese ne perputhje me skemat e propozuara.

Shenimi do te kryhet sipas planit te miratuar te prerjes nen udhezimet e procedurave te fabrikimit dhe si rrjedhoje i verifikuar para prerjes.

Perpara shenimit, materiali duhet te kontrollohet per identifikimin dhe difektet e tij.

Pikat e nevojshme duhet te shenjohet me kujdes dhe saktesi ne perputhje me skemat e miratuara llogaritese.

### 1.4 Prerja, shpimi dhe montimi.

Prerja e materialit duhet te kryhet nga makineria prerese CNC Plasma, linja prerese e profilit CNC.

Vrimat ne lastrat dhe ne profile duhet te shpohen nga linja shpuese CNC, toleranca e kryerjes se linjes se shpimit duhet te jete sipas EN1090-2.

Kendet e te gjitha lastrave do te jene persosmerisht te drejta dhe uniforme kudo. Kendet e prera duhet te kqyren vizualisht per petezimet dhe shtimet.

Kendet e te gjitha profileve duhet te lakohen nga makineria automatike e lakimit/fshirjes se kendeve, lastrat e ngurta rrjete do te pershtaten pa problem ne forme katrore te pjerret nga makineria e prerjes me pjerrje rrjete per kendin e lastres me kend jo me pak se 55o.

Perpara saldimit, diametrat e rrethave duhet te inspektohen nese ato jane ne perputhje me mosperputhjen e lejueshme EN 1011, EN 1090-2.

Procesi i perqendrimin te shiritit ne kend dhe pas-deformimi i kendit duhet te behet automatikisht.

Perqendrimi/ bashkerendimi dhe mberthimi me thumba duhen te realizohen nga nje hydraulic vice magnete shtrengues.

Procesi i montimit do te kryhet pa nevojen e mberthimit me thumba.

### 1.5 Saldimi dhe shtrengimi me bulona.

Per sa i perket llojeve te ndryshme te lidhjeve, duhet te perputhen kerkesat ne vijim:



**i) - Saldimi**

Specifikimet per procedurat e saldimit duhet te organizohen dhe paraqiten per miratim nga nje grup i kualifikuar.

Po ashtu, grupi i certifikuar duhet te kontrolloje llojet dhe nje sere kontrollesh duhet te performohen.

Numri i saldatoreve te certifikuar duhet te mos jete me pak se dhjete, certifikimi duhet te jete ne perputhje me EN ISO 9606-1.

Te gjithë operatorët e makinerive te saldimit duhet te jete te certifikuar sipas ISO 14732.

Kompania kontraktore duhet te jete e certifikuar sipas: EN ISO 3834-2 and EN ISO 1090-2.

Numri i punetoreve i kontraktorit per tre vitet e fundit duhet te mos jete me pak se 120 te punesuar.

**ii) – Shtrengimi me bulona**

Bashkimi vrime-bulone duhet te behet me perpikmeri te larte.

Perputhja maksimale e pergjithshme midis vrimes dhe diametrit te bulones duhet te jete e barabarte me 0.3 mm, per bulonat qe kane nje diameter maksimumi 20 mm, dhe 0.5 mm per bulonat qe kane nje diameter me te madh se 20 mm.

Shtrengimi i bulonave duhet te kryhet ne perputhje me vlerat e ciftit rrotullues si ne Tabelen IV-4 of CNR 10011/05.

Forca terheqese (NS) ne boshtin e vides duhet te jete e barabarte me:

- $N_s = 0.8 \text{ fkn Ares}$
- $N_s = 0.7 \text{ fkn Ares}$

Ku Ares eshte zona e pjeses rezistuese e vides, fkn (forca e terheqjes) jep stress ne nje tester. Bulonat duhet te montohen ne ane me nje vide te vendosur poshte kokes se vidhes dhe nje vide tjeter e vendosur nen vide.

Perdorni çelesat me çift rrotullues te dores ose çelesat pneumatik, te dyja pajisjet duhet te posedojne nje mekanizem per te kufizuar perdredhjen ne shtrengimin e bulonave.

Keto mekanizma duhet te sigurojne nje saktesi me te larte se  $\pm 5\%$ .

Ne menyre qe te perforcohet lidhja dhe te lejoje korrespondencen e persosur te vrimave, nyjet duhet te montohen ne pozicionin e tyre perfundimtar.

Vazhdoni shtrengimin e bulonave ne nje fund te nje elementi qe duhet te lidhet me nje çift rrotullues te barabarte me rreth 60% te asaj qe eshte pershkruar. Shtrengimi do te duhet te filloje nga mesi i nyjes dhe te perparoje gradualisht drejt pjeses se jashtme.

Me pas te shtrengohet fundi tjeter i elementit ne te njejten menyre me ato me siper. Me pas, si perfundim te shtrengohen te gjitha bulonat me nje çeles dore te barabarte me 100%.

Te kushtohet kujdesi maksimal per te siguruar qe strukturat nuk jane te deformuara apo te mbingarkuara gjate ngarkeses, transportit, shkarkimit dhe ruajtjes se blloqeve te vetme.

#### **Shtrimi.**

Instalimi ne vend i te gjitha strukturave te celikut do te duhet te behet ne perputhje me raportin e llogaritjeve dhe me planin e montimit. Perpara se te filloje puna, kompania duhet te paraqese nje dokument me pergjegjesine e plote dhe ekskluzive te Kompanise.

Te kushtohet kujdesi maksimal per te siguruar qe strukturat nuk jane te deformuara apo te mbingarkuara gjate ngarkeses, transportit, shkarkimit dhe ruajtjes.

Te gjitha pjeset ne kontakt me litaret, zinxhoret ose pajisje te tjera ngritese duhet te mbrohen siç duhet. Instalimi do te kryhet ne menyre qe te arrije konfigurimin gjeometrik si ne project. Ne veçanti, ne lidhje me shufrat horizontale, kontraktori do te duhet te kontrolloje shufrat dhe qe vendosja ne pajisjet mbajtese perputhet me udhezimet e projektit, sipas linjave toleruese.

Qendrueshmeria e strukturave duhet te sigurohet gjate te gjitha fazave te konstruktimit dhe heqja e lidhjeve te perkohshme dhe te gjitha mjeteve te tjera ndihmese duhet te behet vetem kur ato behen te panevojshme.

Ne lidhje me bulonat, po te jete e nevojshme, kontraktori mund te vazhdoje me shpimin e vrimave (ne menyre absolute ndalohet perdorimi i zjarrit) qe nuk jane te perqendruara dhe ku bulonat e dizenuara nuk hyjne lehtesisht.

Nese diametri i vrimes se shpuar eshte me i madh se diametri fillestar i bulones me tolerancen e mundesuar, atehere te vazhdohet me zevendesimin e bulones me nje tjetere me diameter me te madh.

Ne bulonat me force te larte te ferkimit, kerkohet fryrja mecurril rere ndaj metalit te bardhe (siperfaqet e kontaktit) jo me shume se dy ore perpara se bashkimi te funksionoje.

Kompanise i kerkohet te punoje ne perputhje me rregullat dhe kerkesat e ngarkuara nga autoritetet, zyrat dhe personat e pergjegjshem per zonen e prekur relativisht per dizenjimin dhe zhvillimin e pajisjes per instalim.

### **16.1 Testi i pranimit**

Pozicioni nga ku vizatohet mostra, pergatitja e mostres dhe procedurat e testimit per percaktimin e vetive mekanike dhe te komponenteve, duhet te plotesoj kerkesat UNI EN ISO 377:1999 dhe UNI 552 : 1986, EN 10002-1:2004 EN 10045-1:1992.

Vlerat e referuara jane si ne vijim:

- $E=210.000 \text{ N/mm}^2$
- $G=E/[2(1+\nu)] \text{ N/mm}^2$
- $\nu=0,3$

- Koeficienti i zgjerimit linear termik  $\alpha=12 \times 10^{-6}$  for  $^{\circ}\text{C}^{-1}$
- $\rho=7850\text{kg}/\text{mc}$

Per me teper, nje ekzaminim visual per saldimet ne lidhje me tehet ne menyre qe te hiqen nderprerjet (ne kete rast te perdoret nje ekzaminim me pjese magnetike). Inspektimi visual do te kryhet ne perputhje me procedurat e pershkruara ne UNI EN 1290.

Me pas saldimet duhet te testohen nga Kontraktori sipas procedurave te duhura dhe duhet te mos kete difekte te tilla si mungesa e penetrimit, rezerva te skorjeve, plasaritje, mungese lidhjeje. Ne veçanti, ekzaminimi me pjesen magnetike duhet te kryhet ne perputhje me procedurat e pershkruara ne UNI EN 1290. Ekzaminimi me ultrasound do te adaptohet ne te gjitha saldimet me penetrim te plote dhe do te zbatohet sipas metodave qe perputhen me klasen 1 te UNI EN 1714.

Nyjete me bulona do te kontrollohen nga procedurat e duhura ne menyre qe te kontrollohet shtrengimi i celesave rrotullues.

#### **Certifikimi.**

Kontraktori duhet te jete i certifikuar sipas:

EN ISO 9001

EN ISO 14001

EN ISO 18001

EN ISO 1090-1

## **16.2 Matjet**

Matjet e "Strukturave te çelikut S355 (CORTEN)" do te bazohet ne numrin teorik te toneve te plotesuar ne vend sic tregohet ne planet e miratuara.

Po ashtu, metoda e matjes, sasia e telit do te llogaritet si 1.5% e peshes se tere struktures. Lastrat shtrenguese, rreshqitese e lidhese dhe profilet, binaret, pajisjet shpejtesuese do te bazohen ne numrin teorik te toneve te plotesuar ne vend sipas dokumentave te tenderuara.

## NDRICIMI RRUGOR DHE PUNIMET ELEKTRIKE

### 1.1 Qellimi

Ky seksion mbulon dhenien e te gjitha specifikimeve per punimet elektrike qe perfshihen ne raport. Cdo lloj ndryshimi i kerkuar nga Kontraktori ne lidhje me keto punime do te duhet te paraqitet per miratim tek Supervizori duke prezantuar te gjitha materialin e nevojshem si vizatime, specifikime etj. Publikimet e listuara me poshte formojne nje pjese te ketij specifikimi ne formatin e zgjatur te referencave. Publikimet jane referuar ne tekst vetem si perkufizime.

### 1.2 Standartet dhe Normat Europiane:

IEC 60364	Zhvillimi i instalimeve ne tension te ulet
EN 14281	Sistemet e tubacioneve plastike per kanalet nentokesore (PVCu)
EN 61000	Perputhshmeria elektromagnetike (EMC)
EN 61238	Kompresimi dhe lidhjet mekanike per kabllot e fuqise

Keto jane Norma dhe ligje te aplikueshme edhe ne Shqiperi

**KERKESAT E PERGJITHSHME:** normat ne reference do te zbatohen per kete seksion me shtesat dhe ndryshimet e specifikuara ketu.

*Verifikimi i diemioneve:* Kontraktori do te behet i njohur me detaje mbi punen, verifikon dimensionet ne fushe dhe do te keshilloje mbikeqyresit apo perfaqesuesin e tij te ndonje mosperputhjeje para se te kryeje çdo pune.

### 1.3 Miratimet

Zerat ne listat e meposhtme do te miratohen nga Mbikeqyresi ose perfaqesuesi i tij.

*Katalogu i te dhenave te prodhuesit:*

- a. Kanalet e kablllove ne polietilen
- b. Shirit izolues
- c. Xhuntot e kablllove ne tension te larte
- d. Shirit rezistent ndaj zjarrit
- e. Strukturat elektrike

- f. Kornizat e pusetave dhe kapaket
- g. Lubrifikante kabllosh
- h. Kabllo te tensionit te ulet
- i. Kuti me bashkues per tension te ulet
- j. Kuti me kapikorda per tension te ulet
- k. Pllake tokezimi

*Raportet e testeve:*

- a Testi i rezistences se izolimit per kabllo te tensionit te larte dhe tension te ulet
- b Testi i vazhdueshmerise
- c Testi i potencialit i larte

*Certifikatat:*

*Materialet dhe pajisjet:* Sigurimi i nje deklarate te prodhuesit qe verteton se produkti i furnizuar permbush ose tejkalon kerkesat e kontrates.

*Kompetencat e punetorit:* Per te kryer punen elektrike ne vend duhet te jete nje punetor profesional.

## 1.4 Produktet

Miratimi i nje produkti te ofruar jepet nga Mbikeqyresi ose perfaqesuesi i tij pas paraqitjes se nje mostre te pranueshme te secilit lloj.

### MATERIALET DHE PAJISJET:

Materialet dhe pajisjet duhet te perputhen me specifikimet dhe standardet perkatese dhe te specifikimeve ketu. Te dhenat elektrike duhet te jene sic tregohet ne etiketen bashkangjitur. Materialet dhe pajisjet do te jene nje produkt standard i nje prodhuesi te angazhuar rregullisht ne prodhimin e e artikullit dhe ne thelb do te kopjoje artikuj qe kane qene ne perdorim te kenaqshem per te pakten 2 vitet e meparshme para hapjes se tenderit.

*Tubat:* Madhesia e tubave e treguar ne vizatim tregon diametrin e brendshem te tubit. Duhet te perputhen me sa vijon me poshte:

Tubat plastike dhe aksesoret duhet te jene polietilen dhe te permbushin standartet DIN ose CEI.

*Kabllo:*

*Madhesia e kablllove percjelles:* Madhesia e kablllove percaktohet nga seksioni i tyre nominal dhe diametri i jashtem, i dhene ne mm<sup>2</sup>. Madhesite e tyre jane te dhena per percues bakri.

STUDIM - PROJEKTIM  
LAGJIA E ARTISTEVE  
PROJEKT ZBATIM  
"ARABEL - STUDIO" SH.P.K  
"TRANSPORT HIGHWAY CONSULTING"  
"DRICONS"

*Sonda elektrike:* Duhet te jete plastike dhe nje force terheqese minimumi 90 kg.

Sistemi i shperndarjes se kablllove ne tension te ulet do te jete ne perputhje me normat CEI. Percjellesit per instalime ne tuba polietileni duhet te kene izolim me gome ne perputhje me normat e aplikuara. Lloji i izolimit duhet te jete kunder lageshtires dhe nxehtesise, i afte te duroje nje temperature 90 grade celsius gjate punes.

Kodi i ngjyrave: Sigurimi i kodit te ngjyrave per te gjitha kabllot e tensionit te ulet si ne vijim:

Faza 1	- e zeze
Faza 2	- e zeze
Faza 3	- ngjyre kafe
Neutri N	- blu e lehte
PE Mbrojtes(Toka)	- te verdhe / te gjelber

*Kabllot e tokezimit:* Kabllot e izoluar duhet te jene te veshur me perberes elektrometrik me termoplastik poshte veshjes, verdhe/jeshil dhe do te izolohej per ti ngjare percjellesve te fazes, pervec mese kabllot vleresohen jo me shume se 750 volt. Alumini nuk eshte i pranueshem.

Bashkimet dhe kapikordat e kablllove sekondare 600 volt duhet te sigurohen mekanikisht. Bashkimet do te mbulohen. Te vidhosen ose te kompresohen me aliazh metalik sipas miratimeve per perdorimin e percuesit te bakrit..

*Bashkimet:* Te behen bashkime kabllosh ne vende qe jane te aksesueshme me vone. Ne cdo vend tjeter nuk lejohet.

*Elektrodat e tokes:* Shufra eshte tip kryq e galvanizuar dhe ka nje prifil 50x50x5mm dhe nje gjatesi 1,5m.

*Etiketa kabllosh ne puseta:* Te vendosen etiketa kabllosh per te identifikuar tensioni ne qark, burimin dhe rrugen.

## 1.5 Zbatimi

INSTALIMI:

*Demi i kontraktorit:* Kontraktuesi do riparoje menjehere te gjitha linjat e sherbimeve (elektrike, kabllot telefoni, tuba uji, tuba kanalizim etj) ose sisteme te demtuara nga veprimet e tij. Demtimet e linjave apo sistemeve nuk te patreguara, te cilat jane te shkaktuara nga operacionet e tij do te riparohen me shpenzimet e tij.

*Tubat e kablllove:*

Tubat do jene polietileni dhe te drejte

*Lidhjet ne puseta:* Gropa e inspektimit do te kete 3 vrime rrethore ne muret anesore te parashikuara per futjen e fundit te kanalit kabllor.

*Mbishkrimi i punimeve te fshehura dhe shiriti identifikues:* Siguroni nje kasete alumini te detektueshme me shirit mbeshtetes plastik ose kasete plastike magnetike te detektueshme te prodhuar posacerisht per punimet e fshehura. Siguroni shirita rrumbullake, me gjeresi 5 cm, me ngjyre te dallueshme per te gene me te dobishme.

*Terheqja e kablllove:* Kabllot do te terhiqen avash avash per ne piken e furnizimit ne pusete ose struktura te nje niveli me larte. Do te perdoren kablllo fleksibel per ti fututr ne vrimat e pusetes dhe ne rruget e kablllove.

Kabllot do te jete ne nje dell pa bashkime midis lidhjeve me perjashtim ku distanca kalon gjatesise ne te cilat kablllo eshte i lirshem.

Kthesat e kablllove duhet te jene jo me pak se ato te specifikuara nga prodhuesi per llojin e kabllit te specifikuar.

Aty ku kablli eshte nxjerre te lihet nje shtese e konsiderueshme per te bere nje lidhje te mevonshme.

*Lubrifikantet:* Per te ndihmuar ne terheqjen e kablllove te veshur prej gome duhet te perdoren keto lubrifikante nga prodhuesi i kablllove.

Tensioni i kablllove te terhequr nuk duhet te kaloje maksimumin e percaktuar nga fabrika.

*Instalimi i kabllot ne pusetave:* Kabllot nuk do te instalohen duke shfrytezuar rrugen me te shkurter, por duhet te kalojne ne keto mure per te siguruar rrugen me te gjate dhe te gjatesine rezereve maksimale te kablllove. Çdo kabell duhet te identifikohet nga tabela metalike rezistente ndaj gerryerjes dhe e bashkangjitur ne secilen strukture nentokesore te miratuar nga mbikeqyresi ose perfaqesuesi i tij.

*Pusetat:*

*Te pergjithshme:* Pusetat do te jene te llojit te treguar vizatime dhe ne perputhje me detajet e aplikuar sic tregohet. Ne zonat e pashtruara, pjesa e siperme e kapakut te pusetes do te jete ne nje hapësire te caktuar me larte klasen e perfunduar (ne varesi te lartesisë se siperfaqes).

*Kapikordat e kablllove:* Mbroni kapikordat e percjellesace te kablllove te fuqise se izoluar nga kontaktet aksidentale, perkeqesimi i mbuleses, dhe lageshtira. Vendorsni kapikorda duke perdorur materialet dhe metodat e treguara ose specifikuara ketu apo siç percaktohet me udhezim me shkrim te prodhuesit te kablllove dhe prodhuesit te kapikordave.

*Tokezimi:* Pjeset metalike se bashku me te gjitha pjeset elektrike duhet te tokezohen.

Tokezimi i shtyllave te ndricimit: Bazat e shtyllave te ndricimit duhet te lidhen te nje pjese metalike me seksion 16 mm<sup>2</sup>.

## 1.6 Testet

Si perjashtim nga kerkesat, qe mund te jene deklaruar diku tjeter ne kontrate, mbikeqyresi ose perfaqesuesi i tij do tu jepen me 5 dite kohe te pune paraprake per çdo test. Kontraktori duhet te siguroje te gjithë punen, pajisjet dhe materialet e kerkuara per testet.

*Shufrat e tokezimit:* Testoni shufrat e tokezimit per vleren e rezistences nese jane te aplikueshme para se ndonje tel te jete i lidhur. Matjet e rezistences se tokezimit do te behet ne mot zakonisht te thate, jo me pak se 48 ore pas reshjeve.

*Raporti i testeve:* Elektrodat e tokezimit: Identifikimi i elektrodave per çdo prove, si dhe rezistencen dhe kushtet e tokes ne kohen qe matjet jane bere.

## 1.7 Shperndarja e brendshme dhe instalimi i fuqise

### Te pergjithshme

#### REFERENCAT:

Publikimet e listuara me poshte formojne nje pjese te ketij specifikimi ne formatin e zgjatur te referencave. Publikimet jane referuar ne tekst vetem si perkufizime.

Normat dhe ligjet e aplikueshme ne Shqiperi

Standartet dhe Normat Europiane:

IEC 60364	Zhvillimi i instalimeve ne tension te ulet
EN 50085	Sistemi i kanalit te kablllove dhe sistemi i kanalineve te kablllove per instalimet elektrike
EN 50086	Sistemi i tubave per menaxhimin e kablllove
EN 50102	Shkallet e mbrojtjes te dhena nga mbylljet per pajisjet elektrike kunder ndikimit te jashtem mekanik
EN 50298	Mbyllja e rrethimeve per automatet e tensionit te ulet dhe te kontrollit te shpejtesise
EN 50310	Aplikimi i lidhjes ekuipotenciale dhe tokezimit ne ndertesa me pajisje te teknologjise se informacionit
EN 50334	Shenim me mbishkrim per identifikimin e berthamave te kablllove
EN 60309	Tapa, priza dhe kapake per qellime industriale
EN 60.423	Tuba per qellime elektrike
EN 60529	Shkallet e mbrojtjes nga rrethimet (kodi IP)
EN 60.669	Celesat per perdorim te brendshem dhe instalimeve elektrike te ngjashme fikse
EN 60865	Llogaritja e efekteve te rrymes ne qark te shkurter
EN 60947	Automatet e tensionit te ulet dhe kontrolli i shpejtesise
EN 61537	Sistemet e kanalineve te kablllove dhe sistemet e kanalineve lider per menaxhimin e kablllove



EN 61543 Pajisja mbrojtëse e rrymes vepruese te mbetur (RCD)

EN 61000 Perputhshmeria elektromagnetike (EMC)

## Produktet

### Karakteristikat teknike

Tela dhe kablllo duhet te plotesojne kerkesat e aplikueshme per llojin e izolimit, veshjes, dhe specifikat e perçuesve ose te shenuara. Telat dhe kabllot prodhuar me shume se 12 muaj para dates te dorezimit ne vend nuk duhet te perdoren.

Perçuesit: Perçuesit duhet te jene solid ose komponimi sipas seksionit kryq. Te gjithë perçuesit do te jene prej bakri. Nese nuk tregohet ne menyre specifike ose te jete kerkuar nga prodhuesit e pajisjeve. Madhesia minimale e percjellesit : Madhesia minimale per qarqe te deges do te jete 1,5mm<sup>2</sup> per ndricim dhe 2,5 mm<sup>2</sup> per qarqet e tjera te tensionit te ulet dhe 0,8 mm<sup>2</sup> per telekomunikacion.

Kodi i ngjyres: Sigurimi per sherbimin, ushqyes, dege dhe percjellesit e telekomunikacionit. Ngjyra per kabllot e tensionit te ulet do te jete:

Faza 1 - zeze

Faza 2 - zeze

Faza 3 - kafe

Neutri N - blu e lehte

PE mbrojtes - verdhe / gjelber

### Izolimi

Neqoftese nuk specifikohet ose te shenohet perndryshe kabllot e fuqise ndhe ndricimit do te jene 1/0,6kV perveç qarqeve te sinjaleve dhe elektronike.

### Bashkuesit dhe kapikordat

Bashkuesit per kablllo me seksion 6mm<sup>2</sup> dhe me te vegjel do te izoloohen, te tipit te presuar ne perputhje me kthesat lidhese te gershetimit.

### Kapaket

Te behet sigurimi i nje-cope pajisjeje kapak per deget qe i pershtaten nje pajisjeje te instaluar. Per kutite-priza metalike, kapaket ne mure te paperfunduara do te jene flete prej çeliku te veshura me zink apo metali te hedhura qe kane pjerresi te rrumbullaket. Per kuti jo-metalike dhe pajisje, kapake te tjera te pershtatshme mund te ofrohen. Vida do te jete te tipit makine me kokat qe ne ngjyre te perputhen me ate te kapakut. Kapaket e pajisjeve te tipit seksional nuk do te lejohen. Kapaket e instaluar ne vende me lageshti, do te jene te kene rondele dhe do te shenohen per "vende me lageshti."

## 1.8 Ndricimi i Jashtem

## Te pergjithshme

### REFERENCAT:

Publikimet e listuara me poshte formojne nje pjese te ketij specifikimi ne formatin e zgjatur te referencave. Publikimet jane referuar ne tekst vetem si perkufizime.

Normat dhe ligjet e aplikueshme ne Shqiperi

Standartet dhe Normat Europiane:

IEC 60364	Zhvillimi i instalimeve ne tension te ulet
EN 12464	Drita dhe Ndricimi ne hapësira pune
EN 12665	Light an lighting-basic terms and criteria for specifying lighting requirements
EN 60598	Ndriculesit
EN 61000	Perputhshmeria elektromagnetike (EMC)
DIN VDE 0710	Ndriculesit me tension pune me poshte se 1000 V
Siguria EU: EN 60598-1, EN 60598-2-1, IEC/EN 60825-1	
EU EMC: EN 55103-1, EN 55103-2, EN 61000-3-2, EN 61000-3-3	
Siguria US (Modeli US): UL 1598	
Siguria Kanadeze (Modeli US): CAN/CSA C.22.2 No. 250	

KERKESAT E PERGJITHSHME: normat ne reference te zbatohen per kete seksion, me shtesat dhe ndryshimet e specifikuara ketu.

### MIRATIMET:

Te dhenat, vizatimet dhe raportet do te punesojne terminologjine, klasifikimet, dhe metodat e pershkruara nga normat CEI si te zbatueshme, per sistemin e ndricimit te specifikuar.

*Katalogu i te dhenave te Prodhuesit:* Kur te dhenat qe pershkruajne me shume se nje lloj, madhesi, model apo ze jane miratuar, shenoni se cili lloj, madhesi , model apo ze eshte ofruar.

Te dhenat do te jene te mjaftueshme per te treguar konformitetin me kerkesat e specifikuara.

- a. Ndriculesit
- b. Shtyllat

### Vizatimet:

- a. *Ndriculesit:* Perfshirja e dimensioneve, pajisjeve, dhe detajet e ndertimit te instalimeve. Vizatimet do te shoqerohen me te dhenat fotometrike, duke perfshire te dhenat ne Lumen per cdo zone, raporti mesatar dhe minimal, duke perfshire diagrama dhe te dhena te shperndarjes te kompjuerizuara.
- b. *Shtyllat:* Perfshirja e dimensioneve, devijimi i shtylles nga era, klasa e shtylles dhe informacione te tjera.

*Raporti i testeve:*

a. Ndriculesit:

- (1) Niveli i ndricimit horizontal i kompjuterizuar in luxne nivelin e tokes, i percaktuar cdo 15m. Duke perfshire dhe nivelin mesatar te ruajtur te raportin maksimal/minimal.
- (2) Te dhenat ne shperndarje sipas klasifikimi CEI

*Raporti i Testeve:* Miratoni rezultatet e testeve sic thuhet ne paragrafin e titulluar "TESTET".

---

**Produktet**

Miratimi i nje produkti te ofruar jepet nga mbikeqyresi ose perfaqesuesi i tij pas paraqitjes se nje mostre te pranueshme te secilit lloj.

TELAT DHE KABLLLOT: Telat dhe kabllot do te plotesojne kerkesat e aplikueshme per llojin e izolimit, veshjes, dhe percjellshmerine e specifikuar ose treguar. Telat dhe kabllot e prodhuar me shume se 12 muaj para dates se dorezimit te saj ne vend nuk do te perdoren.

*Kodi i ngjyrave:* Sigurimi i kodit te ngjyrave per te gjitha kabllot e tensionit te ulet si ne vijim:

Faza 1	- e zeze
Faza 2	- e zeze
Faza 3	- kafe
Neutral N	- blu e lehte
PE mbrojtes(Toak)	- te verdhe / te gjelber

**BASHKIMET DHE KAPIKORDAT E KOMPONENTEVE:**

Bashkuesit per kabllot me seksion 6mm<sup>2</sup> dhe me te vegjel do te izoloohen, te tipit te presuar ne perputhje me kthesat lidhese te gershetimit. Te gjitha terminalet e percuesve do te pajisen me kapikorda.

*Celesat me shkeputje:* Te sigurohen celesa deviat dhe inverter aty ku duhet. Celesat e siguresave duhet te perdorin mbajttese siguresash te pershtathme, vetem neqoftese tregohet ndryshe.

**PANELET:**

Panelet perdoren per te shkeputur tensionin ne pajisje. Panelet do te jene te pajisur me automate pervec nese tregohet ndonje menyre tjeter. Dizajni duhet te jete i tille qe automatet individuale mund te hiqen pa shqetesuar njesite ngjitur ose pa humbur ose hequr izolimin shtese furnizues si mjet per te marre aprovimet siç kerkohet nga UL. "Vendosja specifike e automateve" ne panele eshte e nevojshme per ta krahasuar me vizatimin dhe per te gjetur secilen zone qe ai i perket. Perdorimi te "automateve ushqyes" nuk eshte i pranueshem nese nuk tregohet ndryshe ne menyre specifike. Çelesi kryesor do te jete "me vete" i montuar mbi ose nen automatet e tjere. Panet do te mbyllen me celesa. Ne skema mund te shikohet ngarkesa per cdo zone. Gjithashtu aty mund te shikohet edhe sesi shperndahet ngarkesa nga paneli. Keto skema duhet te jene afer kuadrit i cili duhet te kete kapak transparent. Automatet do te jene te gjithë te etiketuar dhe te shenuar.

Llambat sinjalizuese: Do te perdoren llamba LED per sinjalizim ne panel

---

## Zbatimi

**INSTALIMI:** Instalimet elektrike ne kerkesat e specifikuara ketu.

*Sherbimi nentokesor:* Perçuesit e sherbimit nentokesor dhe tubat do te jene te vazhdueshem nga pajisjet hyrese te pajisjet e sistemit te energjise.

*Vendet e rrezikshme:* Puna ne vende te rrezikshme, do te kryhen ne pajtim te plote me "Klasen", "Divizionin", dhe "Grupin" e vendeve te rrezikshme te perfshira.

*Identifikimi i sherbimit te hyrjes:* Pajisjet e shkeputjes se sherbimit hyres, celesat,dhe rrethimet do te etiketohen te identifikohen si te tille.

*Etiketat:* Kudo ku ka me shume se nje pajisje shkeputese ne rrethime te ndryshme, secila mbyllje, e re dhe ekzistuese, do te etiketohet si nje nga disa rrethimet qe permbajne sherbimin e pajisjeve qe shkeputin hyrjet. Etiketa , minimumi, duhet te tregojë numrin e pajisjeve shkeputese te sherbimeve te strehuara me mbyllje dhe do te tregojë numrin e pergjithshem te rrethimit qe permbajne pajisje shkeputje te sherbimit.

*Tubat e instaluar ne pllaka betoni:* Gjenerali menyren qe te mos ndikojë negativisht ne fuqine strukturore te pllakave. Instaloni tuba brenda mesit te nje te tretes se pllakes se betonit. Hapesira e tubave horizontalisht jo me afer se 3mm, pervecse se ne panelet. Pjeset e lakuara nuk do te jene te dukshme siper pllakave.

*Kutite shperndarese:* Te ndertohen minimalisht ne madhesine e kerkuar, pervecse aty kur kutite jane metalike dhe ka kerkese te vecante ne funksion te vendit ku instalohen. Mbulesa e ketyre kutive te fiksohet me vida. Kur disa linja kalojne ne te njejten kuti ato duhet te jene te etiketuara me numrin e qarkut perkates, karakteristikat elektrike dhe panelin ku shkon.

*Identifikimi i percjellesave:* Siguroni identifikim e percjellesave kudo ku eshte bere bashkim ose eshte vene kapikorde. Per percjellesat do te perdoret kodi i ngjyres se fabrikes, neqoftese nuk

eshte me ngjyre do te kete veshje plastike,shenim bashkangjitur,ngjyre najloni dhe me pllake. Identifikimi i fundit te kabllove.

*Bashkimet:* Beni bashkime ne vende te aksesueshme. Bejini ato me metodat e duhura dhe izolojini me materialet e duhura.

*Nderhyrjet elektrike:* Nderhyrjet elektrike ne zonat e instalimeve qe jane te mbrojtura kunder zjarrit sic jane nderhyrjet ne dysHEME, tavane do te behen me material qe ndalojne kalimin e zjarrit nga njeri vend ne tjetrin sipas zones ku aplikohet.

*Tokezimi dhe lidhjet e tokezimit:* Duhet te tokezen te gjithe suportet metalike qe mbajne kanalinat metalike, panelet, cdo pjese metalike, sistemi telefonik si dhe sistemi i tokezimit te rrjetit elektrik. Kur kemi veprim te mbrojtjes elektrike, duhet te sigurohemi qe lidhja e tokes dhe neutrit nuk eshte shkeputur, por vazhdon te jete ne gjendje pune.

*Pajisjet lidhese:* Siguroni instalime elektrike per lidhjen e pajisjeve te kontrollit sipas standarteve.

## 1.9 Produktet e Ndricimit

Ndriculesit e perdorur:

Tipi 3\_Ndricules rrugor LED

- Ndricules i montuar ne shtylle (8.8 m) qe mund te aplikohet ne rruge urbane dhe rezidenciale, ne rruge bicikletash dhe kembesoresh, ne rruge te vogla te ndryshme

- Instalim i lehte

- Kosto te ulet fillestare

- LED

- Shkalle mbrojtje IP 67 IK08

- 3000K

- 100000 h

- Fuqia 71W

- 220-240 V / 50-60 Hz

☑ Rezistent ndaj rrezeve UV

☑☑Shtylla e perdorur per montimin e ndricuesve shtyllore.

Shtylle celiku 100, ne ngjyre argjendi. Me dritare inspektimi alumini (191x55mm), e pajisur me 2 mbajtese siguresash mbrojtese, 2 siguresa, 16A, bllok terminal e levizshem 4 polar. Me vrimet per kalimin e kabllit furnizues. Pershtates kablli Ø60 mm. Per versionin me baze, 4 prizhoniera te gjate te ngulen ne toke, duhet te blihen bulona dhe kapake ose ne rastin e fiksimit te saj ne beton duhet te parapergatitet bazamenti dhe hyrja e kabllove ne shtylle.

Shenim: Para se te zgjidhni shtyllen e pershtatshme, do behen te gjitha testet e rezistences nga era, bazuar ne ligjet dhe rregullat e vendit ku do te instalohet shtylla ne baze edhe te standarteve EN 40-03-1. Nje mbrojtje ose izolim sa me i pershtatshem dhe sa me i sakte te sipërfaqes se perfshire eshte e rekomanduar per te shmangur cdo kontakt direkt me ndertimet e

reja ose betonet e vjetra. Lartesia e shtylles 4.5m.

*Aksesoret e montuar ne shtylle:*

- Kasa mbrojtese: 6 mm. Lesh xhami i perforcuar me poliester.
- Suporti : Alumin i derdhur me pole lidhese te perbera gjithashtu nga alumin i derdhur.
- Shtylla e dizenuar per ndricues te jashtem: Celik Ø100 me ngjyre argjendi. I kompletuar me dritare inspektimi me shirit fundor te levizshem. Versioni me baze vjen i kompletuar me plinta, e shtiza tokezimi per tu groposur, dado bulona dhe kapese.
- Pllake ndricimi qe montohet direkt ne mur.

---

## Zbatimi

**INSTALIMI:** Duhet te permbush kerkesat e specifikimeve. Shtyllat e celikut: Siguroni beton per perforcuar ne bazen e shtylles. Beton per bazen, tuba polietileni, dhe shufra tokezimi duhet te jene sipas specifikimit me seksion "PUNET ELEKTRIKE NENTOKE".

**TOKEZIMI:** Te tokezohen te gjitha pajisjet metalike sic permendet ne seksionin e "PUNET ELEKTRIKE NENTOKE" aty ku percjellesi i tokes eshte lidhur me nje metal tjetër pëveç bakrit, te sigurohet nje lidhje e pershtatshme e trajtuar vetem per kete qellim.

**TESTET:** Kontraktori duhet te siguroje energjine e nevojshme qe te behen testet.

*Testet ne pune:* Pasi te mbaroje instalimi, vendosni pajisjet ne pune per te treguar qe pajisjet punojne ne perputhje me standartet.

*Testi i izolimit te rezistences:* Te behet si ne specifikimet e "PUNET ELEKTRIKE NENTOKE" , ne te dyja rastet edhe para edhe pas lidhjes dhe fiksimit te pajisjeve.

## SINJALISTIKA RRUGORE DHE ELEMENTET E SIGURISE SE TRAFIKUT

Zhvillimet bashkekohore ne rrjetin rrugor urban dhe interurban si dhe fenomenet e dukshme qe jane konstatuar, e bejne te domosdoshem realizimin e nje manuali per aplikimin konkret te sinjalizimit rrugor ne tere gamen e tij.

Hartimi i manualit te sinjalizimit rrugor, eshte mbeshtetur ne legjislacionin ne fuqi :

Ligjin Nr. 8378, date 22.07.1998, “Kodi Rrugor i Republikes se Shqiperise”

Vendimin Nr. 153, date 07.04.2000 te Keshillit te Ministrave, “Rregullore per Zbatimin e Kodit Rrugor”

Konventa “Mbi shenjat dhe sinjalet e rruges” e dates 8 Nentor 1968.

Manuali i Sinjalizimit Rrugor do te sherbeje :

Si akt normativ i detyrueshem per te gjithë entet pronare te rruges si dhe per subjektet projektuese e zbatuese te sinjalizimit rrugor.

Per studimin dhe hartimin e projekteve te sinjalizimit rrugor si dhe per mireadministrimin e sinjaleve rrugore;

Per zbatimin ne praktike te kerkesave te sinjalizimit rrugor;

Duke ju referuar numrit te madh te aksidenteve te cilat kane ardhur si rezultat i mos respektimit te rregullave te sinjalizimit rrugor te perkohshem gjate punimeve ne rruge apo dhe mos vendosja e ketij sinjalizimi ne rastin e aksidenteve rrugore ne rruget urbane dhe interurbane edhe per shkakun e mosnjohjes se ketij sinjalizimi rrugor si dhe skemave shoqeruese per miremenaxhimin e trafikut rrugor gjate punimeve ne rruge, u konsiderua e nevojshme perfshirja ne kete manual dhe i rregullave te sinjalizimit te perkohshem rrugor, per te ndihmuar entet pronare te rruges te menaxhojne integralisht trafikun rrugor duke shmangur aksidentet rrugore gjate punimeve ne rruge si dhe efektivat e policise rrugore ne vendndodhjen e aksidentit.

### 1.1 Sinjalizimi vertikal

#### Te pergjithshme

Sinjalet vertikale, si ato te rrezikut, urdheruese ose treguese duhet te kene ne pjesen e perparme te dallueshme nga perdoruesit e rruges, formen, permasat, ngjyren dhe karakteristikat, ne perputje me normat e rregullores se zbatimit te Kodit Rrugor dhe sipas figurave e tabelave qe jane pjese plotesuese e saj.

---

## **Materialet bazë**

### *-Themelet*

Themelet për pajisjet inxhinierike të trafiku që vendosen në anë të rrugës dhe mbi të duhet të jenë prej betoni. Ato mund të jenë plotësisht të parafabrikuara (p.sh. elementet e parafabrikuara me shtylla të përshtatshme betoni me seksion të rrumbullakët që shërbejnë si kallëpe të jashtëm), ose ato mund të derdhen në vend

### *-Strukturat Mbjtëse*

Strukturat mbajtëse për pajisje inxhinierike të trafikut që vendosen në anë të rrugës dhe mbi të përfshijnë:

- mbajtëset;
- shtyllat;
- skeletet mbajtës;
- strukturat e portaleve dhe të gjysëm portaleve;
- stenda (për shenjat e përkohëshme të trafikut rrugor).

Në parim, strukturat mbajtëse duhet të prodhohen nga materiale të qëndrueshme si hekuri, alumini, betoni i armuar dhe i pa-armuar ose nga materialet plastike.

---

## **Sinjalet e Trafikut Rrugor**

Në përputhje me qëllimin e përdorimit të tyre, shenjat e trafikut rrugor klasifikohen si vijon:

- sinjalet e rrezikut,
- sinjalet urdheruese, – sinjalet e perparsise; sinjalet e ndalimit; sinjalet detyruese;
- sinjalet treguese,
- sinjalet e ndricueshme (semaforët etj.);
- sinjalet plotesuese,

Aksesorët që përdoren për montimin e sinjalistikës së trafikut rrugor duhet të konsiderohen si pjesë përbërëse e këtyre shenjave. Forma dhe madhësia e tabelave/sinjaleve të trafikut janë përcaktuar në mënyrë të hollësishme nga rregullorja në zbatim të Kodit Rrugor.

Madhësia e sinjaleve të paralajmërimit të rrezikut dhe sinjaleve urdheruese, varet nga lloji i rrugës dhe është specifikuar në Tabelën meposhte.



Tipi i shenjës	Njësia matëse	Tipi i rrugës		
		Autostrada	Rrugë kryesore	Rrugë tjetër
Sinjalet e paralajmërimit të rrezikut (gjatësia e brinjës)	mm	1200	900	900
Sinjalet detyruese (diametri.)	mm	900	600	600

Madhësia/gjerësia e sinjaleve shtesë (tabela) tek sinjalet e trafikut, duhet t’i përshtatet madhësisë së shenjave që ato plotësojnë.

#### Pjesa e Pasmë e Sinjaleve të Trafikut.

Pjesa e prapme e sinjalistikës vertikale/ tabelave të trafikut dhe pjesa e brendshme e ndriçuar e tyre duhet të jetë e punuar nga:

- poliesteri i përforcuar nga fijet e qelqit;
- pllaka metalike (çelik ose alumin).

Pamja ballore e sinjaleve të trafikut, të ndriçuara nga brenda, duhet të prodhohet nga material transparent, ose plastik translucënt (akrilik, xham etj.). Pjesa e prapme e shenjave të trafikut duhet të prodhohet nga material reflektues. Çdo material tjetër që përdoret duhet të aprovet nga inxhinieri mbikqyrës.

#### Simbolet dhe mesazhet me fjalë.

Simbolet dhe Mesazhet me Fjalë në sinjalistikën e trafikut rrugor mund të jenë:

- **jo reflektuese:** të ngjyrosura ose fletë metalike jo reflektuese;
- **reflektuese:** fletë metalike reflektuese;
- **të ndriçuara:** të ndriçuara nga jashtë ose nga brenda (nga burim i brendshëm drite).

Sipërfaqja e pjesës së brendshme të ndriçuar të sinjaleve të trafikut rrugor që përmban simbolet dhe fjalët duhet të karakterizohet nga aftësia për të transmetuar dritën.

Forma, madhësia dhe lloji i përbërjes së ndritshme dhe elementëve të ndritshëm duhet t’i përshtatet sinjaleve të trafikut rrugor. Në parim, duhet të përdoren si me poshtë:

- për sinjalet e trafikut rrugor me dritë: llampa halogjene dhe të zakonshme;
- për sinjalet e ndriçuara:
  - o të ndriçuara nga jashtë: llamba të sodiumit ose të zhivës me presion shumë të lartë;
  - o të ndriçuara nga brenda: llamba fluoreshente dhe neoni.

### Aksesorët që përdoren për Montimin e Sinjaleve të Trafikut Rrugor.

Në parim, aksesorët që përdoren për sinjalet e trafikut rrugor (kapesët, bullonat, dadot dhe rondelat) duhet të jenë prej çeliku.

### Cilësia e Materialeve.

#### *Themelet*

Specifikimet e cilësisë së betonit të përdorur për themelet e pajisjeve inxhinierike të trafikut që vendosen në anë të rrugës dhe mbi të detajohen në këto kushte teknike. Nëse nuk është përcaktuar ndryshe në projekt ose nuk është vendosur ndryshe nga inxhinieri mbikqyrës, për themelet e pajisjeve inxhinierike të trafikut që vendosen në anë të rrugës dhe mbi të, duhet të përdoret beton i tipit C8/10 ose i tipit C12/15. Për themelet e strukturave të portaleve dhe gjysëmportaleve, betoni duhet të jetë i armuar.

Meqënëse tubat me seksion rrethor prej betoni shërbejnë kryesisht si armatura për themelet e parafabrikuara, cilësia e tyre duhet të jetë në përputhje me cilësinë e betonit të specifikuar për themelet.

### Strukturat Mbajtëse

#### *Mbajtëset*

Mbajtëset e shenjave të trafikut në parim duhet të prodhohen nga tuba çeliku me □ 60 mm, me trashësi të mureve jo më pak se 2 mm dhe të mbrojtura brenda e jashtë me galvanizim në të nxehtë ose me ndonjë metodë tjetër të përshtatshme. Mbajtëset e sinjaleve të trafikut duhet të kenë edhe një kanal me qëllim që të pengojë rrotullimin e tyre nga palët e treta.

#### *- Shtyllat*

Cilësia e materialit për shtyllat vertikale dhe mbajtëset e harkuara që kryesisht përdoren për sinjalet me drita të kontrollit të trafikut, duhet të jenë në përputhje me specifikimet e dhëna në projekt.

#### *- Skeleti mbajtës*

Skeleti mbajtës, për sinjalet e përhershme të informimit (përdorimi i korsisë, panelet e konfirmimit të drejtimit etj. para udhëkryqeve), duhet që në parim, të prodhohet nga tuba prej çeliku me prerje rrethore të përshtatshme.

#### *- Portalet dhe gjysëm portalet*

Portalet dhe gjysëm portalet duhet në parim të prodhohen prej çeliku.

Kategoria e çelikut duhet të jetë në përputhje me kushtet e përcaktuara në projekt e të zbatohet për çdo material tjetër që mund të përdoret për ndërtimin e portaleve dhe gjysëm-portaleve.

#### *- Stendat*

Stendat për pajisjet e përkohshme inxhinierike të trafikut që vendosen në anë të rrugës dhe mbi të, duhet të prodhohen nga materiale të tilla si çeliku, hekuri ose alumini.

#### *- Sinjalet e trafikut*

Gjatë periudhës së caktuar për përdorimin e sinjaleve të trafikut, forma dhe ngjyra e tyre nuk duhet të ndryshojë apo të humbasë duke siguruar kështu informacion të saktë dhe drejtimet e duhura të lëvizjes, për pjesëmarrësit në trafik. Materialet e ndryshme të cilat mund të kombinohen në një

sinjal trafiku duhet të mbeten të pandryshueshme në të gjitha temperaturat dhe kushtet klimatike duke siguruar qëndrueshmërinë e tyre.

Materialet e përdorura për sinjalet e trafikut duhet të jenë të qëndrueshme:

- ndaj kushteve klimaterike dhe ujit (hidrofobike);

- ndryshimit të cilësive kimike;

- vjetërimit nga veprimi klimaterik ose koha;

- ndaj zjarrit dhe rreziqeve të ngjashme.

*Pllaka mbështetëse e sinjalit*

Pllaka mbështetëse e sinjalit duhet të jetë në gjendje që, brenda kufijve të elasticitetit të materialit të mbajë:

- fortësinë e erës prej 10 MN/m<sup>2</sup>;

- ndryshimet e temperaturës midis -35 °C dhe 70 °C.

Deformimet elastike nuk duhet të ulin qëndrueshmërinë e shenjave të trafikut.

Trashësia e pllakës mbështetëse të shenjës së trafikut duhet të varet nga:

- madhësia e caktuar e sinjalit të trafikut;

-lloji i materialit;

- metoda e profilimit dhe përforcimit të saj.

Llamarina e pllakës mbështetëse në rastin e materialit prej çeliku duhet të jetë 10/10 mm dhe 25/10 mm në rastin e aluminit.

## 1.2 Reflektimi i tabelave te sinjalistikës rrugore

### Të përgjithshme.

Kjo pjesë shpjegon kërkesat e reflektimit, që duhet të zbatohen nga përdoruesi. Të gjitha tabelat e sinjalizimit rrugor duhet të shihen si gjatë ditës edhe gjatë natës, me ose pa ndriçimin e tyre.

Me përjashtim të tabelave që ndriçohen gjatë gjithë orëve të errësirës, tabelat rrugore duhet të jenë reflektuese.

### Zbatimet standarte për lloje të ndryshme tabelash

Kërkesat bazë të shumicës së tabelave reflektuese, plotësohen duke përdorur materiale reflektuese që kanë një performancë fotometrike dhe që me se miri përmbushin kërkesat e dhëna në tabelën 4.3

Çdo tabelë për të cilën synohet një vlerë më e madhe dhe/ose çdo tabelë me një mjedis të gjelbër, ose blu që ka nevojë për një distancë më të madhe shikimi mund të ndriçohet me materiale me performancë fotometrike të pranueshme dhe që përputhen me tabelën 4.3.

Reflektiviteti lidhet me tipin e materialit të përdorur nga prodhuesit. Ekzistojnë dy tipe materialesh veshës me karakteristika të ndryshme reflektimi si më poshtë:

- klasa 1 – Reflektim normal;
- klasa 2 – Reflektim i lartë.

Materiali i klasës së dytë duhet të përdoret detyrimisht për tabelat e mëposhtme

- tabelat “STOP” dhe “Jepi përparësi”;
- tabelat ndalim parakalimi;
- tabelat portal;
- tabelat paralajmëruese;
- tabelat informuese.

Tabelat rregulluese që përjashtohen nga tabelat e sipërpërmendura për klasën 2, mundet që me zgjedhjen e projektuesit të kenë klasën 1 të reflektimit.

Col	Koordinata në katër pika të cilat përcaktojnë sipërfaqet e lejuara të diagramës kolometrike				Faktori i ndriçimit minimal të filmit	
	1	2	3	4	Klasi 1	Klasi 2
B X	0.350	0.300	0.285	0.335	0.35	0.27
Y	0.360	0.310	0.325	0.375		
G X	0.545	0.487	0.427	0.465	0.27	0.16
Y	0.454	0.423	0.493	0.534		
R X	0.690	0.595	0.569	0.655	0.05	0.03
Y	0.310	0.315	0.341	0.345		
V X	0.007	0.248	0.177	0.026	0.04	0.03
Y	0.703	0.409	0.362	0.399		
B1 X	0.078	0.150	0.210	0.137	0.01	0.01
Y	0.171	1.220	0.160	0.038		
Ar X	0.610	0.535	0.506	0.507	0.15	0.14
Y	0.390	0.375	0.404	0.429		
M X	0.430	0.430	0.494	0.540	0.04	0.03
Y	0.340	0.390	0.420	0.370		

DIV.	Këndi	Vlerat minimale të koeficientit të reflektivitetit (cd – lux x m)						
		III	E bardhë	E verdhë	E kuqe	Jeshile	Blu	Portokalli
20°	50	50	35	10	7	2	20	0.6
	300	24	16	4	3	1	4.5	0.2
	400	9	6	1.8	1.2	0.4	2.2	–
2°	50	5	3	0.8	0.6	0.2	1.2	0.02
	300	2.5	1.5	0.4	0.3	0.1	0.6	0.02
	400	1.5	1.0	0.3	0.2	0.06	0.4	–

Këndi		Vlerat minimale të koeficientit të reflektivitetit (cd – lux x m)						
DIV.	III	E bardhë	E verdhë	E kuqe	Jeshile	Blu	Portokalli	Kafe
20°	50	180	122	25	21	14	65	8.5
	300	100	67	14	11	7	40	5
	400	95	64	13	11	7	20	–
2°	50	5	3	0.8	0.6	0.2	1.5	0.2
	300	2.5	1.5	0.4	0.3	0.1	0.9	0.1
	400	1.5	1.0	0.3	0.2	0.06	0.8	–

Një tabelë konsiderohet e paefektshme, kur nuk mund të shihet ose të lexohet lehtësisht ditën dhe natën nga një mjet që udhëton me shpejtësi mesatare qarkullimi në rrugën në të cilën është vendosur tabela ose kur ndriçimi është 70% i vlerave minimale. e paefektshme duhet të zëvendësohen.

Sipërfaqet e tabelave lokale të drejtimit të lëvizjes dhe shigjetave nuk është e nevojshme të ndriçohen kur nuk janë më larg se 50 m nga një dritë rruge që bën pjesë në një sistem ndriçimi sepse ato janë mjaftueshëm të ndriçuara. Këto janë:

- materiale retroreflektive;
- të vendndodhura në mënyrë të tillë që të marrin maksimumin e ndriçimit nga dritat e rrugës;
- të pozicionuara korrektësisht, duke patur kujdes drejtimin e tyre në mënyrë që të evitohet rreziku i pasqyrimin të materialit reflektues.

Shënim: Nëse një tabelë e caktuar nuk ka reflektim të mjaftueshem, atëhere ajo mund të ndriçohet drejtpërsëdrejti.

## Rregullimi

Ndalohet përdorimi i sinjaleve të ndryshme nga ata që përcakton rregullorja, me përjashtim të rasteve të autorizuar nga Ministria që mbulon Transportin, Drejtoria e Qarkullimit dhe Sigurisë Rrugore.

Mund të mbeten në përdorim sinjale të vendosur që paraqesin vetëm shmangie të vogla nga ato të parashikuara, me kusht që të garantohet dukshmeria (si ditën e natën) dhe instalimi i pershtatshëm (neni 75/5).

Çdo zëvendësim duhet, sigurisht, të kryhet në sinjale krejt të rregullt

Në anën e mbrapme të sinjalit, me ngjyre të mbyllur duhet, në mënyrë të qartë, të tregohet:

Enti ose administrata pronare e rruges;

Marka e firmes që ka prodhuar sinjalin;

Viti i prodhimit;

Numri i autorizimit të Ministrisë që mbulon Transportin, për prodhuesin e sinjaleve rrugore.

Keto te dhena nuk duhet te zene me shume se 200 cm<sup>2</sup>.

Per sinjalet e perhershme duhet shenuar edhe ekstremet e renditjes gjate vendosjes

---

### Vendosja

Sinjalet vertikale vendosen, si rregull ne anen e djathte te rruges

Gjithashtu mund te vendosen edhe

ne ishujt trafikndares;

siper karrexhates;

te perseritura ne anen e majte te rruges;

Per motive te sigurise ose ne rast se eshte parashikuar ne menyre te veçante nga rregullat per sinjalin.

Sinjalet, qe vendosen ne buze te rruges (sinjalet anesore) distancen midis buzes vertikale nga ana e rruges dhe buzes se trotuarit ose anes se jashtme te bankines, duhet t'a kene :

Minimumi 30 cm;

Maksimumi 100 cm.

Pranohen distanca me te vogla, kur kjo kushtezohet nga hapsirat, me kusht qe sinjali te mos dale mbi karrexhate

Mbajteset e sinjaleve duhet te fiksohen ne distance jo me te vogel se 50 cm nga buza e trotuarit ose nga ana e jashtme e bankines

Ne prani te barrierave metalike, mbajteset mund te vendosen tek ato, me kusht qe sinjali te mos dale me shume se vete barrierat

Lartesia nga toka, duke kuptuar lartesine e fundit te sinjalit ose panelit plotesues me te ulet duhet te jete, me perjashtim te sinjaleve te levizshem :

minimumi 60 cm;

maksimumi 220 cm.

Ne rruget urbane, per kushte ambienti te veçanta, sinjalet mund te vendosen edhe ne lartesi me te medha, sidoqofte jo me shume se 450 cm

Ne rruget urbane, ne trotuare ose rruge te rezervuara per kembesore, duhet te kene nje lartesi min.220cm, me perjashtim te paneleve semaforike

Ne pjese uniforme te rruges sinjalet duhet te vendosen, sa te jete e mundur, ne lartesi te njejte

Vendosja ne variantin e levizshem ose me karakter te perkohshem, mund te lejohet ne rast te :- motiveve te vertetuara te punimeve;

situatave emergjente te ambientit;  
situatave te veçanta te trafikut;  
kantjereve rrugore;  
paisjeve te punimit, fikse ose te levizshme.

### 1.3 BARRIERAT MBROJTESE METALIKE (GUARDRAILS)

#### Barrierat e Celikut

##### Përshkrimi i punës

Barriere Metalike është një pajisje e sigurisë teknike qëllimi i së cilës është të parandalojë rrëshqitjen nga automjetet nga rruga, dmth. Mbajtjen e automjeteve që rezikojne te dalin nga rruga.

Puna përfshin furnizimin, transportin, montimin e barrierës së trafikut sipas projektit dhe sipas klasifikimit të autorizuar.

Puna duhet të kryhet në përputhje me projektin, rregulloret e duhura, Kontrollin e Cilësisë dhe Programin e Sigurimit të Cilësisë (QCQAP), kërkesat e Inxhinierit Mbikëqyrës dhe këto SPECIFIKIME.

#### Prodhimi

Barriera Metalike duhet të jetë e një konstruksioni të tillë që një automjet të mos mund ta thyejë atë ose ta kalojë atë. Pas përplasjes në pengesën e trafikut, automjeti duhet të kthehet në korsinë e trafikut. Zhvendosja tërthore e barrierës së trafikut duhet të jetë sa më e madhe, në varësi të hapësirës së lirë midis kangjellave dhe zonës së rrezikut. Dëmtimi i automjetit gjatë përplasjes në pengesën e trafikut duhet të jetë minimal. Struktura e barrierës së trafikut duhet të jetë e tillë që elementët e saj të mund të zëvendësohen shpejt dhe lehtë pas dëmtimit.

Barriere Metalike sipas llojit mund të jetë:

- *Barriere e vetme (SGR)*
- *Barriere e dyfishtë (DGR)*
- *Barriere me hapësirë të vetme (SSGR)*
- *Barriere me hapësirë të dyfishtë (DSGR)*
- *Barriere e vetme me hapësirë në strukturë (SSGRS)*
- *Barriere me hapësirë të dyfishtë në strukturë (DSGRS)*

Fletet e barrierave të çelikut janë fiksuar drejtpërdrejt në shtyllat me vida, ose me anë të elementeve ndarës.

Shtyllat futen në tokë deri në thellësinë e nevojshme ose vidhosen në ankerat e betonuara tashmë me një pllakë themeli, dmth mbërthehen në beton me vida dhe bulona vidhosëse.

Mburojat janë instaluar në një mënyrë të tillë që, duke parë në drejtim të trafikut, fundi i mburojës së mëparshme mbulohet nga fillimi i mburojës vijuese.

Kur pengesa e çelikut kalon strukturën, instalimi i shtyllave dhe mburojave fillon nga qendra e strukturës përpara dhe prapa, në mënyrë që të shmangët prerja e skajet e barrieres dhe vrimat e reja në barriere, dmth. në mënyrë që të mbani distancën e përcaktuar midis shtyllave.

Nëse nuk ka hapësirë të mjaftueshme për instalimin e shtyllave, ndarësi fiksohet në muret vertikale në ankerat e vendosura tashmë me anë të bulonave.

Pjesët e skajeve diagonale të cilat duhet të vendosen në tokë - janë të veshura nga veshja adekuate e izolimit të bitumit.

Pjesët e pengesës duhet të transportohen në një mënyrë të tillë që të shmang dëmtimin e veshjes anti-korrozive.

---

#### **Kontrolli i Cilësisë**

Materialet për barrierat dhe pjesët përbërëse të tij përcaktohen nga standardet, dhe prodhuesi, me shpenzimet e tij, duhet të sigurojë certifikata të cilësisë për të gjitha materialet. Certifikatat origjinale të cilësisë i dorëzohen inxhinierit mbikëqyrës.

Kontrolli i cilësisë së materialit dhe mbrojtja kundër korrozionit (galvanizimit) të elementeve të çelikut të strukturës duhet të jetë në përputhje me dispozitat përkatëse.

---

#### **Llogaritja e Volumeve**

Instalimi i barrierave do të llogaritet sipas llojit dhe gjatësisë (m), plotësisht të përfunduara dhe sipas çmimit të kontraktuar, të gjitha punimet, furnizimi, gërmimi, betonimi dhe materiali tjetër i përfshirë, si dhe të gjitha punët e tjera që lidhen me instalimin e pengesat.

---

#### **Guardrails (barrierat metalike)**

Te gjitha materialet e perdorura per guardrail (barriera metalike) duhet te gezojne karakteristikat e projektura mekanike ose karakteristikat sipas vizatimeve perkatese.

Gjithashtu nese Kontraktori propozon materiale apo tipe te tjera Guard Raili keto mund te vihen ne zbatim vecse pas paraqitjes prane Supervizionit te te gjitha materialeve te nevojshme dhe pas marrjes se aprovimit te tij.

#### *Cilesia e materialeve*



Per te gjithë materialet duhet te kryhet mbrojtja e duhur kunder korrozionit.  
Aksesoret per fiksimin e shinave mbrojtese duhet te permbushin me perpikmeri funksionin e tyre sipas projektit gjate gjithë periudhes se perdorimit duke bere te mundur edhe zevendesim ekonomik te tyre.

#### Materialet baze

Guardrail (barrierat metalike) konsistojne si me poshte

- shinat dhe pjeset skajore;
- shtyllat mbajtese dhe distancatoret;
- aksesoret per montim (Shufrat, dadot, rondelat, pllakezat lidhese)

Per binaret dhe pjeset skajore kryesisht perdoret llamarina metalike te profiluara.

Ne parim mbajtesit dhe ruajtesit e distancave duhet te prodhohen sipas nje profili te caktuar metalike(I, U, C).

Aksesoret per fiksim duhet te realizohen nga materiale te tilla te cilet jane ne pajtueshmeri me te dy materialet qe bashkohen.

Ne varesi te rrethanave, guard rails (shinat mbrojtese) mund te jene:

- shina njeaneshe (ne njerin ane te shtylles mbajtese);
- shina te dyaneshe (ne te dy anet e shtylles mbajtese).

Shinat mund te montohen ne:

- direkt tek shtyllat mbajtese;
- indirekt nepermjet distancatoreve.

Shinat mund te jene te vetem ose ne raste te veçante te dyfishte (njeri mbi tjetrin ne te njejtin mbajtes).

#### Metoda e realizimit te punimeve

Shinat mbrojtese duhet te vendosen ne menyre qe:

- skaji i siperm i shines te jete 0.75 m mbi nivelin e trasese se rruges;
- pjesa ballore e shines duhet larguar nga skaji i trasese se rruges jo me pak se 0.5 m;
- hapësira midis mbajtesve eshte:
- jo me pak se 4 m ne nje prerje te hapur;
- jo me pak se 2 m ne nje strukture

### **Kërkesat e ndërtimit**

Furnizoni sistemet e barrierave dhe fundoret që janë rezistente ndaj perplasjeve. Kur kërkohet terminali i ballor ose tangent, dorëzoni vizatime nga prodhuesi për terminalin konform specifikimeve.

Instaloni shtyllat në vendndodhjen, ndarjen dhe lartësinë e specifikuar, ose sipas udhëzimit të Inxhinierit.

Kur sipërfaqja e shtresave është brenda 900 milimetrave të fytyrës së mbrojtësit, instaloni shtyllat përpara se të vendosni shtresat. Mbroni shtyllat nga trafiku duke bashkangjitur shina ose me një metodë të miratuar nga Inxhinieri.

Shtyllat e barrierave mund të instalohen me anë të shpimit ose makinës. Sigurohuni që postat e instaluara me shpime kanë vrima të mjaftueshme për të lejuar kompaktimin e plotë të materialit të mbushjes pas pikës. Mbushja në shtresa të ngjeshura jo më shumë se 300 milimetra. Zevendesoni pjeset e demtuara dëmtuar gjatë aksidenteve.

Kur një shtylle gurdraili nuk mund të vendoset për arsye se është e pa mundur shpimi, të kalohet në detajet për kapje në gur ose në beton, sipas metodave të percaktuara ose të miratuara nga inxhinieri. Të ruhet standarti I gjatësisë së elementeve dhe mos të ndyshohet nga ai I specifikimeve

Kur nuk është e mundur të mbahen një distancë minimale prej 600 mm në mes shtylles dhe pjesës së sipërme të guardrailit tip 1V: 2H ose pjerrësisë më të madhe, rriteni gjatësinë standarde shtylles me 300 milimetra

Most e modifikohen diametrat ose dimensionet.

Te merren barriera të lakuara me një rreze prej 45 metrash ose më pak.

Instaloni elementët e barrierave në një vijë të vazhdueshme në drejtim të qarkullimit të trafikut. Përdorni bulona që shtrihen të paktën 6 milimetra, por jo më shumë se 25 milimetra përtej dadove. Përdorni bojë në sipërfaqet e galvanizuar që ekspozojnë metalin bazë me 2 shtresa bojë zinku-oksid.

### **Seksionet fundore.**

Most të ankorohen guardrailet në beton me të ri se 7 dite. Kavot kur ankorohen nuk duhet të ken xhoko.

### **Lidhjet me strukturat**

Instaloni shtyllat, kangjella, aksesore dhe ankorimi i nevojshëm për të ndërtuar llojin e lidhjes me strukturën e specifikuar.

### **Instalimi I Guardraileve në Trafik.**

Kur një rrugë është e hapur për trafikun gjatë ndërtimit, instalimet e barrieres duhet të përfundojnë brenda 5 ditëve pune nga dita kur struktura, shtresat, shpatulla, ose cilado që është pika kontrolluese e punës, është e kompletuar mjaftueshëm për të lejuar instalimin e barrieres. Në zonat ku ndërtimi i barrieres nuk është i kufizuar nga ndërtime të tjera, heqja e çdo pengese ekzistuese dhe ndërtimi i parrakut të ri duhet të përfundojë me 48 orë punë fillestare.

Në fund të çdo dite, mbyllni me kujdes një seksion fundor të rrumbullakosur në fund të ekspozuar pjese te se montuar.

Vendosni instalimin e barrieres në mënyrë që puna të përfundojë para pezullimit të punës ose periudhave të tjera të zgjatura kohore

#### **Heqja dhe rivendosja e Guardraileve**

Hiqni dhe ruani elementet ekzistuese te barrierave, shtyllat dhe pajimet. Hiqni dhe rusani shtyllat e vendosura në beton. Zevendesoni shtyllat, guardrailet dhe detajet e demtuar gjatë heqjes, ruajtjes, ose rivendosjes. Mbushja e vrimave që krijohen nga heqja e shtyllave dhe te ankorave te behet me material të miratuar nga Inxhinier. Ruani materialin që nuk është përdorur.

#### **Ngritja e gudadrileve (rimontimi)**

Hiqni elementet ekzistuese te brrierave dhe pajimet. Zevendesoni dhe rivendosni posts sipas nevojës. Zëvendësoni elementet gjatespr, shtyllat dhe detajet e demtuar gjatë heqjes dhe ngritjes. Hidhni materialin e demtuar.

#### **Matja.**

##### **Matni artikujt të listuara në dokumentin e ofertës dhe më poshtë si të aplikueshme:**

Rakordimet nga nje klase me e larte barriere ne nje klase me te ulet te matein si per klasen me te larte.

Te maten heqja dhe ringritja e guardraileve dhe vendosja e fundoreve.

Te numerohen montimet e shtyllave te reja ose te demtuara. Mos te numerohen ne rastet qe shtyllat jane demtuar nga proceset e punes.

#### **Pagesa.**

Sasitë e pranuar do të paguhet me çmimin e kontratës për njësi matëse për artikujt të listuara në dokumentin e ofertës. Pagesa do të jetë kompensim i plotë për punën e përshkruar në këtë Seksion

## 1.4 Dukshmeria e sinjaleve

Per nje dukshmeri sa me te mire te sinjaleve duhet te garantohet hapesire pa pengesa midis drejtuesit dhe sinjalit.

Proçesi logjik qe kalon drejtuesi, duhet te jete :

perceptimi i pranise se nje sinjali;

lidhja logjike me sinjalizimin rrugor;

njohja e formes dhe e ngjyres;

leximi;

zbatimi i sjelljes se kerkuar ose te zgjedhur.

Ne rastet kur nuk eshte e mundur te garantohet dukshmeria e kerkuar ne kapitujt respektive (sinjale rreziku, urdheruese ose treguese), distancat mund te ndryshojne, me kusht qe sinjali te paraprihet nga nje sinjal i ngjashem, i plotesuar me panel plotesues model II 1

Dukshmeria, e per pasoje pamja e sinjalit (forma, ngjyra dhe simbolet), duhet te jene te njejta, si ditën ashtu edhe natën. Naten dukshmeria mund te sigurohet me ndriçim ose reflektim

Shenim: Ne te njejten mbajtese nuk mund te vendosen sinjale me karakteristika ndriçimi ose reflektimi te ndryshme midis tyre.

## 1.5 Publiciteti

Ndalohet nderthurja ose bashkevendosja me çdo lloj publiciteti

Gjithsesi enti pronar i rruges mund te lejoje publicitetin e sherbimeve kryesore, se bashku me sinjalet rrugore ne rastet e parashikuara nga rregullorja

## 1.6 Permasat e tabelave sinjalizuese

Permasat e sakta te tabelave jepen ne Rregulloren e Kodir Rrugor te Shqiperise .

Kontraktori duhet te zbatoje permasat e pershkruara hollesisht ne projekt.

Pergjithesisht lejohen tre lloje te ndryshme permasash per çdo shenje.

Kjo mund te permblihet si me poshte:

Forma e tabelës	Gjerësia e tabelës (cm)		
	E vogël	E mesëm	E madhë
Octagonale	60	90	120
Trekëndore	60	90	120
Rrethore	40	60	90

Tabelat e mesme perdoren zakonisht kur tabelat e anes se majte perseritin ato qe jane vendosur ne anen e djathte.

#### Shikueshmeria e qarte e tabelave

Tabelat duhet te jene qartesisht te dukshme ne perputhje me nivelin e kerkuar te dukshmerise.

Distanca duhet te jete e qarte per te gjitha pjeset e fasades se shenjes, kur shikohet nga qendra e korsise ne anen e afert. Per tabelat e montuara jashte rruges, distanca e dukshmerise duhet te matet nga qendra e korsise me te afert ne drejtimin e shikimit. Pemeve qe erresojne tabelat duhet tu priten majat dhe bimet e tjera qe mund te erresojne shenjen duhet te hiqen me rrenje.

Prerja e majave te bimeve ne prona private duhet te behet pas keshillimit me pronarin e tokes ku ndodhet bimesia.

### 1.7 Sinjalet e rrezikut

#### Te pergjithshme

Sinjalet e rrezikut duhet te vendosen kur egziston nje situatë reale rreziku ne rruge, qe nuk perceptohet shpejt nga nje drejtues mjeti ne kushte normale dhe qe zbaton rregullat e qarkullimit

Keto sinjale kane forme trekendeshi barabrinjes me kulm te drejtuar lart

#### Vendosja

Sinjalet e rrezikut duhet te vendosen ne anen e djathte te rruges. Ne rruget me dy ose me shume korsi per çdo sens levizje, duhet te merren masa, ne lidhje me kushtet vendore, me qellim qe sinjalet te

dallohen edhe nga drejtuesit e mjeteve qe kalojne ne korsite e brendeshme. Kjo behet duke i perseritur ne anen e majte ose siper karrexhates

Ne kete rast, ne qoftese tregimi i rrezikut vlen per te gjithë karrexhaten, sinjali vendoset me qender ne perputhje me aksin e saj. Neqoftese i referohet vetem nje korsie, duhet te vendoset mbi aksin e asaj korsie dhe te plotesohet nga nje shigjete te vendosur nen te (modeli II 6/n), me majen e drejtuar poshte.

---

### **Kombinime**

Ne rast vendosje ne te njejten mbajtese te nje sinjali rreziku dhe nje sinjali urdherues, sinjali i rrezikut duhet te jete gjithmone me lart atij urdherues.

## **1.8 Sinjalet pershkruese**

---

### **Te pergjithshme**

Sinjalet qe japin pershkrime te vendosura nga autoritetet kompetente te rruges per perdoruesit e saj, ndahen ne tre lloje:

sinjale perpresie;

sinjale ndalimi;

sinjale detyruese

Sinjalet pershkruese duhet te vendosen ne piken ku fillon detyrimi ose sa me afer tij

Te pajisur me panelin plotesues model II 1 mund te jepen me perpara me qellim paralajmerimi

Gjate pjeses se rruges te sinjalizuar me sinjal pershkrues sinjalet duhet te perdoren pas çdo kryqezimi Perseritja mund te behet duke perdorur sinjale me format te reduktuar, te plotesuar me panele plotesues model II 5/a2 ose II 5/b2. Termi pershkrues tregohet duke perdorur te njejtin sinjal te pajisur me panel model II 5/a3 ose II 5/b3 , me perjashtim te rasteve kur eshte parashikuar nje sinjal i veçante i fundit te pershkrimit (detyrimin).

Sinjalet e FUNDIT (mbarimit) te detyrimin ose ndalimit, duhet te vendosen sa me afer te jete e mundur, ose pikerisht ne piken ku perfundon ndalimi ose detyrimi.

---

### **Vendosja**

Sinjalet pershkruese vendosen ne anen e djathte te rruges.

Ne rruget me dy ose me shume korsi per çdo drejtim levizje, duhet te merren masa, ne lidhje me kushtet vendore, me qellim qe sinjalet te dallohen edhe nga drejtuesit e mjeteve qe kalojne ne korsite

e brendeshme. Kjo behet duke i perseritur ne anen e majte ose siper karrexhates. Ne kete rast, ne qoftese urdheri vlen per te gjithë karrexhaten, sinjali vendoset ne qender ne perputhje me aksin e saj; Neqoftese i referohet vetem nje korsie, duhet te vendoset mbi aksin e asaj korsie dhe duhet te plotesohet nga nje shigjete e vendosur poshte (modeli II 6/n), me majen te drejtuar poshte.

## 1.9 Sinjalet e ndalimit

### Te pergjithshme

Sinjalet e ndalimit ju ndalojne pedoruesve te rruges qarkullimin ose drejtime tçanta te levizjes, nje manover te veçante, ose vendosin kufizime.

Sinjalet e ndalimit ndahen ne te pergjithshem dhe te veçante:

quhen te pergjithshem ato qe u drejtohen te gjitha mjeteve;

quhen te veçante ato qe u drejtohen vetem nje kategorie mjetesh ose kategorie te veçante pendoruesish .

Sinjalet e ndalimit kane forme rrethore.

Tek sinjalet e ndalimit perdoren kryesisht ngjyrat: e bardhe, blu, e kuqe, dhe e zeze perveç rasteve te parashikuara ndryshe.

## 1.10 Sinjalet e detyrimit

### Te pergjithshme

Sinjalet e detyrimit vendosin per pendoruesit nje sjellje te veçante, ose nje kusht te veçante qarkullimi i cili duhet te respektohet. Ndahen ne te pergjithshme dhe te veçanta.

Sinjalet e detyrimit jane ne forme rrethore.

## 1.11 Sinjalet treguese

### Te pergjithshme

U japin pendoruesve te rruges informacionin e nevojshem per:

- te qarkulluar me rregullsi dhe te sigurte;

- te thjeshtuar dallimin e:

itinerareve;  
qendrave administrative;  
sherbimet dhe impiantet rrugore te nevojshme

---

### Vendosja

Sinjalet e paralajmerimit dhe te drejtimit mund te vendoset mbi karrexhate, dhe ne veçanti mund te marrin karakteristikat e sinjaleve se korsise, kur ekzistojne nje ose me shume nga kushtet e meposhteme:

dy ose me shume korsi per çdo sens te levizjes;  
kryqezime te kanalizuar ose planimetrisht komplekse;  
vellim i madh trafiku me perqindje te larte te makinave me lartesi gabarite te madhe;  
mbizoterim i shpejtesise se larte;  
itinerare autostradale (Tipi A), unaza (Tipi A dhe B), drejtime kryesore te vendkalimeve ose itinerare te hyrjes ose daljes nga qendrat urbane;  
pamundesi e realizimit te nje sinjalizimi anesor efikas.

Per instalim te sinjaleve, vlejne normat e pergjithshme te dhena ne kapitullin Sinjalet Vertikale; mund te perdoren ura, mbikalime ose vendndodhje te tjera dhe pozicione te pershtatshme.

Ne lidhje me piken e vendosjes qe i perket kryqezimit te cilit i referohet, sinjalet e korsise marrin funksionet e meposhtme:

shume me perpara	: paralajmeruse
me perpara	: perzgjedhje
prag kryqezimi	: drejtim
fillim i korsive te ngadalesimit	: drejtim
korsi te ktheses	: drejtim
te perpjeta, etj.,	: drejtim
paskryqezime	: konfirmim
pas hyrjeve	: konfirmim

Forma dhe permasat e sinjaleve te korsise jane pershkruar ne Skemen 20. Permbajtja e secilit panel duhet t'i referohet korsise perkatese, mbi te cilen ajo eshte pozicionuar.

---

### Simbolet

Lidhen me llojin e rruges te ciles i referohet tregimi, sipas perkatesise se meposhteme, te vlefshme ne pergjithesi :

sfond i bardhe : simbole te zeza;



sfond i bardhe :	simbole blu;
sfond i bardhe :	simbole gri;
sfond jeshil :	simbole te bardha;
sfond blu :	simbole te bardha;
sfond kaf :	simbole te bardha;
sfond i zi :	simbole te verdha;
sfond portokalli :	simbole te zeza;
sfond kuq :	simbole te bardha;
sfond i verdhe :	simbole te zeza.

## 1.12 Sinjalizimi horizontal

### Te pergjithshme

Sinjalet horizontale, te shenuara ne rruge, sherbejne per te rregulluar qarkullimin, per te drejtuar perdoruesit dhe per te dhene udhezime dhe tregues te dobishem per sjellje te veçanta per t'u mbajtur. Vijezi ne rruge konsiston ne aplikimin e vijezi me rrugore ne siperfaqen e asfaltuar dhe te pastruar paraprakisht nga papastertite dhe pluhurat, ne perputhje me vendndodhjen dhe dimensionet e paraqitura ne vizatim ose nen drejtimin e inxhinierit te ngarkuar.

#### ➤ Materialet

- a) Lenda e pare qe do te perdoret ne vijezi ne rruge duhet te jete posaçerisht per te, te kete sasine e nevojshme te reflektivitetit dhe qendrueshmeri te gjitha karakteristikat e mesiperme te jene ne perputhje me Standardin Evropian. Furnitura e bojes se vijezi duhet te kete Certifikate aprovimi, ne te cilen te jene testet e laboratorike.
- b) Bojerat reflektuese te tipit me sferiza xhami te perzier paraprakisht me boje normale, jo reflektive duhet te kene permbajtje te bioksidit te titanit per bojen e bardhe dhe te verdhe.
- c) Lengu perberes duhet te jete me baze rreshire sintetike.
- d) Sferezat e xhamit ne permbajtje te bojes duhet te jene pa ngjyre dhe te kene nje diameter nga 0.006 mm e deri ne 0.30 mm kurse sasia perberese e peshes se tyre ne boje duhet te jete jo me pak se 33%.
- e) Kontraktori duhet te dorezoje nje sasi prej 1 kg boje nga e cila do te perdore se bashku me specifikimet teknike te fabrikes.
- f) Punedhenesi rezervon te drejten per te provuar nje kampion nga partia e bojes qe eshte ne perdorim ne çdo moment.

### **Materialet Bazë**

Vijëzimi rrugor duke patur parasysh inxhinierinë e trafikut dhe kërkesat e cilësisë duhet të realizohet me materiale që për nga cilësia e tyre të sigurojnë dukshmërinë e mirë të vijëzimeve gjatë drejtimit të automjetit si ditën ashtu edhe natën, fërkimin e duhur dhe qëndrueshmërinë e kërkuar për jetëgjatësinë brenda periudhës së projektuar për përdorim.

Materialet bazë që përdoren për vijëzimin e rrugës janë:

- bojrat normale;
- fletët e gatshme;
- përbërjet plastike.

Materialet për vijëzimin e rrugës duhet të jenë:

- të aplikuara në sipërfaqen e rrugës; ose
- të vendosura në pjesë të posaçme të hapura në shtresën veshëse të rrugës.

Në rastet e aplikimit të vijëzimit të sipërfaqes së karrexhatës, materiali i përdorur mund të jetë prej:

- tipi të hollë (trashësia e shtresës së thatë është jo më shumë se 800  $\mu\text{m}$ ); ose
- tipi të trashë (trashësia e shtresës së thatë është midis 800  $\mu\text{m}$  dhe 3000  $\mu\text{m}$ ).

Në përputhje me përbërjen dhe metodën e aplikimit dhe ngurtësimit, vijëzimet e holla në rrugë mund të realizohen duke përdorur:

- bojra me një përbërës;
- bojra me shumë përbërës
- bojra të përziera më parë me grimca reflektuese qelqi (ngjyra të parapërziera); ose
- bojra të aplikuara në të nxehtë (spërkatja kryhen në 60–100°C).

Me bojra standarde, pasqyrimi i duhur i vijëzimit në rrugë mund të arrihet duke shtuar grimca reflektuese qelqi.

Vijëzimet e trasha të rrugës mund të realizohen duke përdorur:

- fletë (të ngjitura); ose
- përzierje plastike (të shtruara ose të spërkatura në të nxehta ose në të ftohtë).

Përzierjet plastike duhet të vendosen në pjesën e futur të shtresës veshëse të rrugës.

Materialet e vijëzimeve të rrugës përbëhen nga lidhësi, agjentët ngjyrosës, mbushësi,, tretësit, tharësit, materiale për zbutje dhe shtesa për të mundësuar reflektimin dhe rritjen e fërkimit. Për materialet me shumë përbërës është e nevojshme futja e agjentëve shtesë për ngurtësimin e tyre. Materialet shtesë për vijëzimin janë ato që përdoren për lyerjet fillestare, për spërkatjen e mëtejshme (grimcat reflektuese prej qelqi), rritjen e ashpërsisë për efekt fërkimi, materialet për hollim dhe materiale të tjera që mund të kërkohen nga prodhuesi i materialeve për vijëzimet e rrugës.

Shenjat reflektuese të trafikut (kolonetat reflektuese përgjatë rrugëve etj.) duhet të prodhohen nga materiale të përshtatshme plastike. Trupi mund të prodhohet nga metali apo materiale qeramike. Drita që reflektohet prej tyre duhet të jetë e bardhë ose e verdhë.

---

### Cilësia e Materialeve

Karakteristikat dhe cilësia e materialeve të vijëzimeve rrugore duhet të jetë në përputhje me ngarkesën e projektuar të trafikut. Materialet për vijëzimet rrugore nuk duhet të kenë efekt të kundërt me materialet e përdorura në shtresën përfundimtare pasi mund të shkaktojnë dëmtimin e saj (p.sh. plasaritje).

Para përdorimit të ndonjë materiali për vijëzimet e holla të rrugës, kontraktori në kohën e duhur duhet t'i parashtrijë inxhinierit mbikëqyrës:

- një raport mbi cilësinë e materialeve që do të përdoren për vijëzimin e rrugës, raport i cili duhet të pasqyrojë si vijon:

o llojet dhe përbërjen e të gjithë elementeve (lidhës, agentë ngjyrosës, mbushës etj.);

o dendësinë;

o viskozitetin e ngjyrës para hollimit;

o përbërjen e lëndës për tharje;

o pikën e ndezjes;

o spektrin e rrezeve infra të kuqe të binderit;

o gazin kromografik apo të përbërësve të avullueshëm të gazit; dhe

o analizat fluoeshente të rrezeve X (përbërja e materies së ngurtë);

- një raport për vetitë e holluesit që duhet të tregojë si vijon:

o llojin;

o pikën e ndezjes;

o përbërjen toksike;

- një raport mbi karakteristikat e grimcave reflektuese të qelqit duhet të tregojë si vijon:

o përbërjen kimike të qelqit;

o koeficientin e refraktimit (të përthyerjes);

o peshën vëllimore të grimcave të shpërndara;

o peshën vëllimore të vetë qelqit;

o përbërjen e lagështisë;

o përbërjen granulometrike; dhe

o përqindja e pranuar e grimcave të qelqit.

Dokumentet me të dhënat e kërkuara që tregojnë për cilësinë e materialeve që përdoren për vijëzimet e holla të rrugës duhet të përcaktohen nga inxhinieri mbikëqyrës konform kërkesave që aplikohen për shenjat rrugore me shtresa të holla si dhe në marrëveshje me prodhuesin.

Para përdorimit të çdo materiali për vijëzimin e rrugës, kontraktori duhet t'i paraqesë inxhinierit mbikëqyrës informacionin e duhur lidhur me kushtet e aplikimit të materialeve të tilla si:

- afatin e ruajtjes;

- kohën e tharjes dhe të ngurtësimit; dhe

- trashësinë e shtresës së sapohedhur (të njomë) dhe të thatë (të ngurtësuar) të materialit të përdorur për vijëzim.

Gjithashtu kontraktori duhet t'i paraqesë inxhinierit mbikëqyrës raportet e testeve për materialet e përdorura me karakteristika të njëjta me ato të materialeve që përdoren sipas projektit, raporte të cilat do të ndihmojnë për të treguar që gjatë periudhës së përdorimit të rrugës së vijëzuar të arrihen karakteristikat e duhura të këtyre vijëzimeve. Për të plotësuar cilësinë e materialeve të tilla, raportet duhet të përfshijnë:

- adezivitetin;

- elasticitetin;

- rezistencën ndaj kimikateve;

- rezistencën ndaj rrezatimit ultraviolet; dhe

- rezistenca ndaj konsumimit.

Një raport mbi karakteristikat e vijëzimeve në rrugë sipas inxhinierisë së trafikut, tregon:

-qëndrueshmërinë ndaj ngarkesave të trafikut, tipin dhe zonën ku vendosen vijëzimet e trafikut;

- rezistencën ndaj fërkimit;

- dukshmërinë gjatë ditës, ndryshimet ditore të nuancës së ngjyrave; dhe

- dukshmërinë gjatë natës.

Kontraktori mund të përdorë një material për vijëzime vetëm nëse të dhënat e materialit janë të njëjta me ato të kërkuara në raportin mbi cilësinë e materialeve. Nëse kjo nuk arrihet, kontraktori duhet ta përjashtojë atë (materialin) duke e shënuar në mënyrë të veçantë, ose duke e hequr plotësisht nga kantieri kur kjo kërkohet nga inxhinieri mbikëqyrës. Për disa vijëzime të holla rrugore të veçanta, kontraktori mund të përdorë edhe materiale të tjera nëse përpara përdorimit të tyre, nga Instituti i i Standarteve dhe Teknologjisë në Ndërtimet (ISTC) është konstatuar që ato gëzojnë cilësitë e duhura me kërkesat dhe nëse përdorimi i materialeve të tilla është aprovuar nga inxhinieri mbikëqyrës.

## Metoda e Realizimit të Vijëzimit të Rrugës

Vijëzimi i rrugës duhet të realizohet sipas udhëzimeve të prodhuesit të materialeve të përdorura për punime të tilla.

Në parim, vijëzimet gjatësore në rrugë duhet të realizohen me makineri të përshtatshme. Vijëzimi me dore (në raste të veçanta) duhet të aprovohet nga inxhinieri mbikqyrës.

Në parim, tek vijëzimet e holla të rrugës duhet të kihet parasysh si vijon:

- viskoziteti punues gjatë kohës së përdorimit;
- shkalla e hollimit;
- trashësia e kërkuar e shtresës së sapohedhur (e njomë) dhe e thatë;
- sasia mesatare e bojës së përdorur për 1 m<sup>2</sup> të shenjës rrugore;
- koha e ngurtësimit deri në momentin kur rruga është e gatshme për përdorim;
- kushtet e veçanta atmosferike gjatë zbatimit të punimeve;
- metoda dhe kushtet për përgatitjen e sipërfaqes së trasesë së rrugës para fillimit të vendosjes së shenjave rrugore;
- procedura dhe pajisjet e përdorura gjatë zbatimit të punimeve;
- kërkesat për sigurinë në punë;
- kushtet për depozitimin e materialeve; dhe
- kërkesat për mbrojtjen nga zjarri.

Tipi, forma, madhësia dhe zona e vijëzimit të rrugës si dhe metoda e realizimit të tyre janë të pasqyruara në rregulloret e përdorura për këtë qëllim. Vijëzimet rrugore (me përjashtim të vijëzimeve reflektuese të trafikut) nuk duhet të jenë mbi sipërfaqen e xhadesë më tepër se 3 mm, me qëllim që të mos bëhet pengesë për drenazhimin e ujit. Kjo e fundit përcakton kufirin e trashësisë së vijëzimeve të rrugës (fletëve metalike dhe përzierjeve plastike).

Vijëzimi i rrugëve duhet të kryhet:

- në temperaturën e ajrit prej 10–30°C;
- me temperaturë të sipërfaqes së trasesë së rrugës prej 5–45°C;
- në kohë të thatë; dhe
- me lagështi relative jo më shumë se 85%.

Në rastin e temperaturave më të larta, karakteristikat e materialit për vijëzimin e rrugës duhet t'i përgjigjen kushteve që shfaqen gjatë zbatimit të punimeve. Sidoqoftë, për ndryshime të tilla duhet të merret aprovimi paraprak i inxhinierit mbikqyrës.

Përpara aplikimit të një materiali që përdoret për vijëzimin e rrugës, sipërfaqja e karrexhatës së rrugës duhet të jetë e thatë dhe e pastruar në mënyrë që të largohet pluhuri, kripa e mbetur dhe njollat e vajit.

Para aplikimit të materialit, sipërfaqet me ashpërsi të konsiderueshme duhet të pastrohen me furcë, me ajër nën presion dhe të lahen ndërsa sipërfaqet shumë të lëmuara të trasesë, në anën tjetër, duhet të ashpërsohen në mënyrë të përshtatshme.

Në rastet zonave të reja të trafikut të sapo ndërtuara (asfalti në veçanti), vetëm vijëzimi i përkohshëm i rrugës mund të kryhet; vijëzimi i përhershëm i trasesë së rrugës duhet të kryhet vetëm pasi sipërfaqja e karrexhatës së rrugës të jetë lëmuar pas largimit të lidhësit bituminoz, thepave të betonit apo të llaçit të tepërt. Në rastin e prishjes së vijëzimit ekzistues, përpara vijëzimit të ri duhet të hiqet vijëzimi më i hershëm me qëllim që të evitohet konfuzioni tek përdoruesi i rrugës.

Në rastin e vijëzimit të rrugës mbi pjesën e trasesë së dëmtuar të saj (si p.sh. mbi plasaritjet gjatësore në qendër të trasesë së rrugës, nëse nuk është e mbyllur si duhet), mund të bëhet një zhvendosje paralele dhe të kryhet vijëzimi i rrugës menjëherë pas zonës së dëmtuar. Metoda e vijëzimit të rrugës nuk duhet të paraqesë ndonjë rrezik për përdoruesit e rrugës dhe/ose për personat të cilët realizojnë vijëzimin e rrugës. Grimcat reflektuese të qelqit duhet të spërkaten mbi sipërfaqe duke përdorur makineri të përshtatshme për spërkatje. Sipërfaqja e shtresës së aplikuar me bojë duhet gjithashtu të mbulohet me grimca reflektuese qelqi.

Në varësi të vetive të përzierjeve plastike dhe karakteristikave të kërkuara të vijëzimeve të rrugës, përzierësit plastikë të projektuar për tu vendosur në pjesët e hapura për këtë qëllim, të shtresës veshëse/ sipërfaqes së rrugëve mund të vendosen në:

- thellësi 3-8 mm;

- thellësi 8-15 mm;

- thellësi më shumë se 15 mm.

Fletët e vijëzimeve për sinjale trafiku të rrugës duhet të ngjiten në mënyrë të përshtatshme me sipërfaqen e trasesë së rrugës ose me pjesët e hapura për këtë qëllim, të shtresës konsumuese. Vijëzimet reflektuese të trafikut mund të trupëzohen në sipërfaqen e shtresës përfundimtare (në parim, të përkohëshme) ose me pjesët e hapura për këtë qëllim (të përherëshme). Ato duhet të jenë të ngjitura në mënyrën e duhur me shtresën nën atë konsumuese. Ato nuk duhet të dalin mbi nivelin e karrexhatës së rrugës për më tepër se 15 mm.

Në parim, vijëzimi i rrugës bëhet me ngjyrë të bardhë, me përjashtim të:

- vijëzimeve në zonat kur parkingu nuk lejohet;

- vijëzimeve skajore;

- vijëzimeve në zonën e autobusëve dhe të taksive;

- vijëzimeve në zonat për përdorim të veçantë (p.sh. vend ndalimet e autobusëve, vendeve të rezervuara për taksí, etj);

- zonave të mbushura me vijëzime.

Gjatë vijëzimit të rrugës, duhet të mbahet evidencë për sa vijon:

- llojin dhe sasinë e materialeve të përdorura (për njësi matëse);

STUDIM - PROJEKTIM  
LAGJIA E ARTISTEVE  
PROJEKT ZBATIM  
"ARABEL - STUDIO" SH.P.K  
"TRANSPORT HIGHWAY CONSULTING"  
"DRICONS"

- trashësia e shtresave të sapohedhura (të njoma dhe të thata) të vijëzimeve të rrugës;
- kushtet atmosferike (temperatura, lagështia relative).

#### **4.6 Cilësia e Realizimit të Punimeve**

Vijëzimi i rrugës duhet të kryhet në mënyrë uniforme në formë të përshtatshme dhe duhet të plotësojë këto cilësi:

- qëndrueshmëri;
- rezistencë ndaj fërkimit;
- dukshmërinë gjatë ditës;
- dukshmërinë gjatë natës;
- kohën e tharjes;
- trashësinë e shtresës së tharë të materialit.

Cilësia e materialit të përdorur për vijëzimin e rrugës duhet të jetë në përputhje me këto kërkesa:

- toleranca e lejuar e dendësisë së materialit në lidhje me vlerën e caktuar duhet të jetë  $\pm 5\%$ ;
- materiali për vijëzimet e holla të rrugës nuk duhet të përmbajë përbërës të patretshëm, kokrriza, ose cipa të koaguluara sipërfaqësore;
- ngjyra (e bardhë, e verdhë) duhet të jetë sipas specifikimeve, që të mund të verifikohet nëpërmjet diagramës së përdorur të ngjyrave, përbërja e lëndës së tharë në materialin e përdorur për vijëzim nuk duhet të jetë më pak se 60 % (m/m);
- jetëgjatësia nuk duhet të jetë më e vogël se një vit.

Cilësia e grimcave reflektuese të qelqit duhet t'i përshtatet kërkesave të treguara në tabelen mëposhte :

Karakteristikat e grimcave reflektuese të qelqit	Njësia matëse	Vlera e kërkuar
Koefiçienti i reflektimit	–	1.50–1.53
Pesha vëllimore e grimcave	g/cm <sup>2</sup>	2.4–2.6
Përbërja granulometrike		
– deri 100 µm	% (m/m)	Deri në 5
– deri 200 µm	% (m/m)	3–25
– deri 315 µm	% (m/m)	25–65
– deri 500 µm	% (m/m)	80–100
– deri 800 µm	% (m/m)	100
Përqindja e pranueshme e grimcave reflektuese, jo më e vogël se	% (m/m)	80

Vlerat kufi të karakteristikave të kërkuara të inxhinierisë së trafikut të vijëzimeve të rrugës janë të treguara në Tabelën mëposhte:

Karakteristika	Njësia matëse	Vlera e kërkuar
Qëndrueshmëria ndaj konsumit deri 50% i:		
– vijëzimeve gjatësore	Muaj	12
– vijëzimeve tërthore	Muaj	10
Rezistenca ndaj rëshqitjes mbi vijëzimet e trasesë:		
– trafiku i pandërprerë	SRT	45
– trafiku me ndërprerje	SRT	35
Dukshmëria gjatë ditës; shkalla e ndryshimit të ngjyrës	–	4–8
Dukshmëria gjatë natës; retro refleksioni	–	për tu caktuar

Në kushte normale, koha e tharjes së materialit të përdorur për vijëzimet e rrugës nuk duhet të jetë më shumë se 20 minuta.



Trashësia minimale e vijëzimeve të holla të rrugës është specifikuar në Tabelën mëposhte:

Lloji i vizës	Njësia matëse	Trashësia minimale e shtresës së tharë me ngarkesë të trafikut:	
		< 4000 mjete/ditë	< 4000 mjete/ditë
Gjatësore	µm	300	400
Tërthore, me vijëzime	µm	400	500

Në raste të justifikueshme, inxhinieri mbikëqyrës mund të lejojë që trashësia e shtresës së tharë të vijëzimeve të holla rrugore të jetë më e vogël se ajo e treguar në Tabelën 4.3, sidoqoftë jo për më shumë se 100 µm

Nëse trashësia e shtresës së tharë të materialit që përdoret për vijëzimin e rrugës është më e vogël se kufiri i kërkuar i trashësisë në më tepër se 10% të sipërfaqes, kontraktori duhet ta përsërisë vijëzimin pa kërkuar pagesë shtesë.

Sasia minimale e grimcave reflektuese prej qelqi të spërkatur mbi vijëzimet e rrugës në rastin e rrugëve të reja duhet të jetë 0.20 kg/m<sup>2</sup>, ndërsa për rrugët ekzistuese kjo sasi duhet të caktohet nga inxhinieri mbikëqyrës.

### Kontrolli i Cilësisë

Kufiri minimal i testeve rutinë për vijëzimin e rrugës që kryhet nga kontraktori, dhe numri i testeve kontrolluese, duhet të caktohet nga inxhinieri mbikëqyrës, në bazë të projektit të vijëzimit të rrugës dhe ecurisë së punimeve. Gjatë zbatimit të punimeve inxhinieri mbikëqyrës mund ta ndryshojë numrin e testeve rutinë që duhen kryer.

Nëse nuk është përcaktuar ndryshe nga inxhinieri mbikëqyrës, trashësia e shtresave të njoma e të thata të vijëzimeve, në rastin e rrugëve të reja duhet të verifikohet çdo 1000 ml të karrexhatës së vijëzuar dhe çdo 2000 ml për rastin e vijëzimit të rrugëve ekzistuese.

Në parim, për çdo vijëzim që i bëhet rrugës, duhet mbajtur një raport në përputhje me kërkesat e këtyre kushteve teknike.

### Matja dhe Marrja në Dorëzim e Punimeve

Kushtet e përgjithshme lidhur me matjet dhe pranimin e vijëzimit të rrugës janë përcaktuar në këto kushte teknike. Këto kushte mund të ndryshojnë në mënyrën që sugjerohet nga inxhinieri mbikëqyrës.

### Llogaritja e Kostos

Llogaritja e kostos pas përfundimit të vijëzimit të rrugës duhet të kryhet sipas këtyre kushteve teknike.

## Reflektiviteti i sinjalistikës

Pjesëza të vogla xhami janë të përfshira në përbërjen e materialit të vijëzimit rrugor, duke bërë kështu të mundur reflektimin e dritave të pasme të mjetit përballë drejtuesit të mjetit levizës. Kjo e bën vijëzimin e këtij lloji shumë më të ndritshëm natën, në krahasim me vijëzimet që nuk kanë në përbërjen e tyre material reflektues. Kodi Europian mbi vijëzimet rrugore (EN 1436:2007) përcakton disa lloje të ndryshme kategorish për reflektimin gjatë natës. Vijëzimet më të ndritshme janë të dukshme në distanca më të mëdha dhe mund të sigurojnë për një kohë më të gjatë një nivel cilësie të pranueshëm, përpara se zëvendësimi i tyre të bëhet i nevojshëm .

Mund të specifikohen gjithashtu dhe llojet e vijëzimeve që ruajnë funksionin e tyre gjatë natës, edhe kur ato janë të lagura. Kjo zakonisht arrihet me anën e përdorimit të materialeve me grimca reflektuese me dimensione më të mëdha, por performanca e vijëzimeve rrugore në kohë me lagështi, mund të përmirësohet edhe me anën e përdorimit të profileve të ngritura.

## Bojerat e vijëzimit

Boja e vijëzimit reflektare që aplikohet me sprucim duhet të ketë karakteristikat e mëposhtme:

**Karakteristika të përgjithshme** - Boja reflektuese duhet të jetë e tipit të paraperzier d.m.th. të përmbajë sferat e xhami të perziera qysh në fabrikim, të jetë homogjene. Sferizat e xhamit duhet të jenë reflektuese ndaj fenereve të automjeteve

**Ngjyra** - Duhet të jetë ngjyre e bardhe (ose e verdhe) puro. Ngjyra pas aplikimit duhet të rezistojë kohës.

**Pigmenti** - Për bojën e bardhe pigmenti duhet të jetë i formuar nga bioksidi i titanit. Kurse për bojën e verdhe pigmenti duhet të jetë formuar nga kromati i plumbit.

**Stabiliteti dhe peshat specifike** - Boja e përdorur nuk duhet të absorbojë graso, vajra, njolla të asnjë tipi dhe të ketë një përzierje kimike të përshtatshme që edhe në periudhën e

mepasme nuk duhet të ketë shenja të depertimit të substancave bituminoze të shtresave asfaltike të rrugës. Peshat specifike nuk duhet të jetë më pak se 1.50 kg për liter në 25°C.

**Koha e tharjes** - Koha e tharjes nuk duhet të jetë më e vogël se 30 min në kushtet e një temperature 30°C, në kushtet e një lagështie relative 65% për një spesor 200 mikron. Vijëzimi gjatë kohës së tharjes nuk duhet të shkelet nga automjetet.

**Viskoziteti** duhet të jetë i përfshirë në kufijtë nga 70 deri 90 krebs.

**Perberësit avullues** nuk duhet të jenë më shumë se 65% deri 75% të peshës.

**Sferizat e xhamit** - Duhet të jenë transparente e për rreth 90% me forme sferike të rregullt dhe jo ovale si dhe nuk duhet të jenë të ngjitura me njëra tjetren. Treguesi reflektiv nuk duhet të jetë më pak

se 1.5 provuar me metoden e emetimit me llambe tungsteni. Nuk duhet te kete permbajtje te elementeve acide me ph 5 deri ne 5.3 dhe elemente normale te klorurit te kalciumit dhe te sodes.

**Ashpersia e siperfaqes** - Koeficienti i ashpersise (sipas R. R. R Anglez) nuk duhet te jete me pak se 60% e siperfaqes se pa vijeuar.

Drejtuasi i punimeve rezervon te drejten te beje ne menyre fakultative prova te lendes se pare ne institute te specializuara per qellim zbulimin e komponenteve perberes se saj, kualitetin rezistencen e materialeve etj. Shpenzimet e provave i ngarkohen firmes zbatuese te punimeve.

#### Karakteristikat fiziko-kimike

Masa volumetrike	kg/l	1,7
Elementet jo fluturues	75%	te peshes
Viskoziteti	89/90	KU
Permbajtja e pigmentit	35%	te peshes
Permbajtja e bioksidit te titanit	16%	te peshes
Koha e tharjes	minimumi	30min
Permbajtja e sferave	20%	te peshes
Norma e harxhimit	1,3 m <sup>2</sup>	per kg
Reshqitshmeria	S. R. T.	44

*Tabela 5- Karakteristikat fiziko-kimike*

- a) Procedura
- Pjesa e rruges ku do te behet vijezi duhet te pastrohet nga papastertite.

Menyra e pastrimit percaktohet ne bashkepunim me inxhinierin e ngarkuar.

- Gjeresia e vijezi horizontal te behet 12-15 cm
- Te respektohet menyra e vijezi sipas vizatimit kombinuar kjo edhe me tabelat paralajmeruese te rrezikut dhe te ndalimit te parakalimit. Per çdo rast te bashkepunohet me

Inxhinierin e ngarkuar.

- Gjeresia e pjeses se vijeziar te jete:

Per ndarjen e korsive ku lejohet parakalimi Rruga 3 meter-Intervali 4.5 meter ne pjesen e nderprerjeve te rruges kryesore me hyrje anesore Rruga 1 meter-Intervali 1 meter.

b) Aplikimi

Aplikimi duhet te behet me nje makine vijeziar e cila aprovohet nga Inxhinieri. Makina duhet te jete e pajisur me dy sprucatore te cilet sprucojne boje te lengshme perzier me ajer te ngjeshur. Sprucatoret te jene te pajisur me nje mekanizem komandimi per leshimin dhe nderprerjen e sprucimit sipas kerkesave.

Boja perpara perdorimit duhet te perzihet mire dhe kushtet atmosferike te jene ne nje temperature mbi 5<sup>o</sup> C. Minimumi i normatives se bojes se perdorur per vijeziar duhet te jete 0.5 liter per çdo meter katror te vijeziar. Trashesia e vijeziarit duhet te jete rreth 0.5 mm (trashesi boje e thare).

---

#### **Ndarja e sinjaleve horizontale**

Sinjalet horizontale ndahen ne :

shirita gjatesore;

shirita terthore;

vendkalime kembesorese ose biçikletash;

shigjeta drejtuese;

shkrime dhe simbole;

shirita kufizuese te vendeve te qendrimit ose per vendqendrimet e rezervuara;

ishuj trafiku ose sinjalizimi paraprak per pengesa brenda karexhates;

shirita kufizuese te stacioneve te qendrimit te mjeteve te transportit publik te linjes;

sinjale retroreflektuese integrative te sinjalizimit horizontal;

sinjale te tjera te parashikuara nga aktet ne zbatim;

sinjale horizontale te ndaluar.

#### **Nuk lejohet:**

Ndalimi ne rruget, anet e te ciles dallohen nga nje shirit i vazhduar ;

qarkullimi mbi shiritat gjatesore, perveçse kur nderrohet korsia;

qarkullimi i mjeteve te paautorizuara ne korsite e rezervuara.

Ne vendkalimet e kembesoreve drejtuesit e mjeteve duhet t'u japin perparesi kembesoreve qe kane filluar kalimin. Vendkalimet e kembesoreve duhet te jene gjithmone te kalueshme dhe per karrocet me rrota te invalideve .

---

### **Materialet**

Te gjitha sinjalet horizontale duhet te realizohen me materiale te tilla qe te jene te dukshme si ditën edhe natën , si kur bie shi edhe kur shtrati i rruges eshte i lagur.

Perdorimi i nje boje te cilesise se larte garanton jetegjatesine e sinjalit dhe siguron mjetin ne cdo moment te dites.Ne kete projekt duhet te perdoret boje bikomponente me gjeresi 15 cm.

Sinjalet horizontale duhet te jene te realizuara me materiale te pa thermueshme dhe nuk duhet te dalin me shume se 3 mm mbi siperfaqen e shtruar te rruges.

---

### **Kalimet per kembesoret ose per biçikletat**

Sinjalet horizontale te VENDKALIMEVE PER KEMBESORET jane dhene ne kapitullin Vendkalime kembesoresh ne “Situata te veçanta”, ndersa sinjalet horizontale te vendkalimeve te biçikletave jane dhene ne kapitullin Zona te biçikletave ne “Situata te veçanta”.

## SPECIFIKIME TEKNIKE PER PUNIME GJELBERIMI

### 1.1 Prerje sistemim pemesh

Ne keto zera pune eshte parashikuar te kryhen punimet e meposhtme:

Ne kete ze pune eshte parashikuar prerja e degeve anesore e kryesore, trupezimi i trungut,shkuljen e sistemit rrenjesor, grumbullimin dhe trasportin mbi 5 km nga objekti.

Matja do te jete ne cope.

### 1.2 F.V Fidane dekorativ

Bazuar ne analizen An 164, Manuali 3 botuar ne fletoren zyrtare.

#### MBJELLJA E DRUREVE DEKORATIVE

Proceset e punes jane parashikuar ne zera dhe do te kryhen punimet e meposhteme:

-Piketim,hapje grope 1x1x1 m,blerje fidani,furnizim dhe vendosje fidani,mbushje me pleh organik dhe me dhe biollogjik si dhe vendosja e drurit mbeshtetes ne lartesine h=2 m.

- Distanca e mbjelljes do te jete sipas parashikimeve te percaktuara ne projekt. Matja do te jete ne cope.

Karakteristikat e drurit dekorativ te llojeve: Te dhenat teknike qe duhet te zbatohen ne perzgjedhjen e llojeve.

- Panje e kuqe (Acer ).
- Lartesia e drurit 160-180 cm.
- Perimetri i trungut 14-16 cm.
- Amballazhi me kosha plastike.
- Certifikata e origjines dhe ajo fitosanitare.
- LLoji Kumbulla e kuqe (Prunus ),
- Lartesia e drurit 160-180 cm.
- Perimetri i trungut 14-16 cm.
- Amballazhi me kosha plastike.
- Certifikata e origjines dhe ajo fitosanitare.
- Amballazhi me kosha plastike.
- Certifikata e origjines dhe ajo fitosanitare.
- LLoji Plep (Populus ),
- Lartesia e drurit 160-180 cm.
- Perimetri i trungut 14-16 cm.
- Amballazhi me kosha plastike.
- Certifikata e origjines dhe ajo fitosanitare.
- LLoji Ulli (Olea europaea),47
- Lartesia e drurit 160-180 cm.
- Perimetri i trungut 14-16 cm.
- Amballazhi me kosha plastike.
- Certifikata e origjines dhe ajo fitosanitare.